

FGJH

REVISTË SHKENCORE E FAKULTETIT TË GJUHËVE TË HUAJA
UNIVERSITETI I TIRANËS



5/2022

Botohet për herë të parë në dhjetor 2019

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Universiteti i Tiranës

Adresa: Rruga e Elbasanit, Tiranë, Shqipëri

E-mail: redaksia_fgjh@unitir.edu.al

www.fgjh.edu.al

©Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Të gjitha të drejtat të rezervuara.

ISSN 2664-7346

BORDI EDITORIAL

Drejtor i Përgjithshëm

Prof. Dr. Saverina PASHO (Fakulteti i Gjuhëve të Huaja)

Kryeredaktore

Dr. Viola ADHAMI (Fakulteti i Gjuhëve të Huaja)

Redaktore shkencore

Prof. Asoc. Mirela PAPA (Fakulteti i Gjuhëve të Huaja)

BORDI SHKENCOR

Prof. Dr. Maks DAIU

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja Universiteti i Tiranës)

Prof. Dr. Esmeralda KROMIDHA

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja Universiteti i Tiranës)

Prof. Dr. Elida TABAKU

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja Universiteti i Tiranës)

Prof. Dr. Viktor RISTANI

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja Universiteti i Tiranës)

Prof. Asoc. Dr. Sofia DELIJORGJI

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja Universiteti i Tiranës)

Prof. Dr. Brikena KADZADEJ

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja Universiteti i Tiranës)

Prof. Asoc. Lindita SEJDIU-RUGOVA

(Fakulteti i Filologjisë, Universiteti i Prishtinës, Kosovë)

Prof. Enrico LUSSO

(Fakulteti i Gjuhëve dhe Letërsive të Huaja dhe Kulturave Moderne, Universiteti i Torinos, Itali)

Prof. Marco NOVARINO

(Fakulteti i Gjuhëve dhe Letërsive të Huaja dhe Kulturave Moderne, Universiteti i Torinos, Itali)

Prof. Dr. Ahmet GÜNŞEN

(Fakulteti i Letërsisë, Universiteti Trakya, Turqi)

Prof. Dr. Giorgos KENTROTIS

(Departamenti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti Ionian, Greqi)

Arti grafik: Elzana Agolli

Shtypi u realizua nga: "West Print" sh.p.k.

KONFERENCË SHKENCORE
NDËRKOMBËTARE

**SI TA BËJMË TRASHËGIMINË
TONË KULTURORE TË
FLASË? – KREATIVITET DHE
NDËRMJETËSIM NË NJOHJEN E
TRASHËGIMISË KULTURORE”**

8 -9 Dhjetor 2022

PËRMBAJTJA

9

Roli i Medias në Promovimin e Agroturizmit si
Biznes që po nxit Zhvillimin e Ekonomisë Rurale
në Shqipëri- (Rasti i Revistës Monitor)

Sabri Laçi

Esmeralda Laçi

26

The Contribution and Best Practices of the English
Department, Faculty of Foreign Languages,
Tirana University in Curriculum Development
and Implementation for the Undergraduate
and Graduate Programmes in Translation and
Conference Interpreting

Nejla Qafmolla

Sonila Alla

Viktor Ristani

38

Përcjellja e Trashëgimisë Kulturore përmes
Letërsisë dhe Letërsia si Trashëgimi Kulturore

Marsela Likaj

Argida Shijaku

46

Potenciali i hapësirës gjeografike shqiptare për
integrim në itineraret kulturore të Këshillit të

Evropës

Romeo Hanxhari

Sokol Axhemi

55

Ndërtimet e Fortifikuara të Luftës së Ftohtë -
Potencial i Peizazhit Historik
dhe Atraksion Turistik

Mimoza Puto

Edlira Çaushti

Silvana Nini

Anastasi Prodani

66

Shqipëria në Udhërrëfyesit Turistik hartuar në
Gjuhën Gjermane
Migena Sejдини

73

Nga Homeri te Virgjili, nga Bajroni
te Kadarea, Letërsia si Udhërrëfyes
i Itinerareve Gjeografike dhe Kulturore
Saverina Pasho

80

Gjuha si një e mirë Kulturore Themeltare
për Trashëgiminë
Elsa Skënderi
Anxhela Lepuri

95

Shkodra e Siminëve gjatë
Gjysmës së Dytë të Shekullit XIX
Alma Hafizi

107

Tourist Advertising as a Means of Promoting
aCountry's Cultural Heritage. From Travel Guides
to Pop-Culture Tourism
Alina Ganea

121

Trashëgimia Kulturore, Burim për Anglishten për
Qëllime Specifike në Fushën e Turizmit
Demir Kroj
Vasil Barka

131

Veshjet dhe Stolitë si Mbartëse të Erotizmit në
Këngët Popullore të Jugut
Drita Isufaj

140

Gjuha: Trashëgimi Kulturore
Jomateriale për t'u Mbrojtur.
Reflektime dhe Problematika
Eliana Laçeј
Lindita Kazazi

149

Promovimi i Shqipërisë dhe Vlerave të saj përmes
Itinerareve Kulturore të Këshillit të Evropës

Enela Fortuzi

Fjoralba Sharra

Xhuljeta Kasmollari

162

Ruajtja e Traditave Kulturore tek Grupet
Bilinguale – Rasti i Emigrantëve Shqiptarë në
Gjermani

Jonida Bushi (Gjuzi)

Ema Kristo

179

Trashëgimia Arkitekturore:
Kultura e Memories dhe Kultura e Identitetit:
Ruajtja dhe Mbrojtja e Peisazhit të Qytetit

Elida Miraj

192

Mediation and Culture
in French Language Textbooks

Marina Pappa

209

Mitologji Popullore Jugore

Martin Mato

221

Përfitimet që vijnë nga Promovimi i Burimeve
të Trashëgimisë Kulturore, si një nga Burimet e
Zhvillimit të Turizmit

Olta Kapllani

Dhonat Kote

Afroditi Ngjelo

233

Trashëgimia Kulturore, një Avantazh
i Portit të Sarandës si Port i Thirrjes
në Rajonin e Mesdheut

Rakela Thanò

Ornela Shalari

243

Interpretimi i Veprës së Kol Idromenos,
“Dy Rrugët” në Kontekstin e Muzeut

Etnografik

Silvana Nini

Anastasi Prodani

ROLI I MEDIAS NË PROMOVIMIN E AGROTURIZMIT SI BIZNES QË PO NXIT ZHVILLIMIN E EKONOMISË RURALE NË SHQIPËRI- (RASTI I REVISTËS MONITOR)

Prof. Dr. SABRI LAÇI

Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë

Universiteti i Tiranës

sabri.laci@unitir.edu.al

Dr. ESMERALDA LAÇI

Fakulteti i Shkencave Humane

Universiteti "I. Qemali"

ABSTRACT

The media plays an important role in informing the public, promoting and encouraging new businesses in the tourism sector. The Monitor magazine has the merit of informing, through its representative and critical publications, its readers and potential investors on the development of agrotourism in Albania. Agritourism aims to link agricultural, craft and cultural potential to tourism, thus establishing the necessary infrastructure to create a network of farms and inns that will welcome tourists and offer them agricultural, craft and also a traditional gastronomy which allows them to know the habits and customs and the local traditions. If we respect and protect our natural and cultural heritage, agrotourism can become a driving force for the sustainable development of our rural areas and our lands, but currently it does not manage to stimulate local development. Our study is based on the current situation of agrotourism which imposes analyzes and initiatives aimed at the development of this kind of tourism in full which adapt perfectly well to our rich and varied local resources.

Keywords: agritourism, territory and terroir, farm, local product, acriculture-breeding, crafts, cultural heritage, sustainable development.

Në leksikun e gjeografisë rurale janë futur koncepte të reja si “multifunksionaliteti i bujqësisë”, “punët dhe të ardhurat që lidhen ose jo me bujqësinë”, “territori si urë lidhëse mes analizës dhe veprimit”. Këto dhe konceptet më të hershme përbëjnë piketat e këtij punimi, i cili synon ta prezantojnë agroturizmin si alternativë për zhvillimin rural dhe gjallërimin e jetës social-kulturore në fshat. Agroturizmi u ofron vizitorëve mundësinë për të kuptuar dhe marrë pjesë në punët bujqësore tradicionale (kultivimi i bimëve, mbarështimi i kafshëve dhe shpendëve); praktikat artizanale; konsumimin e ushqimeve të përgatitura nga prodhimet e shtëpisë apo të fermave përreth; për t’u argëtuar në fermë dhe për të njohur kulturën lokale etj.

Agroturizmi ndikon në diversifikimi i veprimtarive ekonomike në hapësirën rurale, për t’u dhënë fermerëve mundësinë e përfitimeve më të mëdha e më të shumëllojshme (punësim, të ardhura, kontakte, informacion dhe aktivitete social-kulturore), si dhe për motivimin për të qëndruar në vendlindje dhe për t’u marrë me veprimtari bujqësore.

Që objektivat e agroturizmit të përmbushen, fermerët ta vlerësojnë më mirë tokën, produktet dhe shërbimet që ofrojnë, traditat dhe trashëgiminë, lipset që ai të planifikohet dhe kontrollohet, me qëllim që të japë rezultate të qëndrueshme, pa dëmtuar natyrën, historinë dhe kulturën e hapësirës ku do të zhvillohet.

Bashkësitë rurale që ende nuk e kanë përcaktuar rrugën zhvillimit, kërkohet t’i referohen modelit që lidh resurset bujqësore dhe artizanale me turizmin, si dhe të ndërtojnë apo përshtatin infrastrukturën për agroturizëm, me synimin që në territorin e RSH-së të krijohet një rrjet fermash e bujtinash, i destinuar për pritjen e vizitorëve e turistëve.

Ekzistojnë mundësitë që agroturizmi të shndërrohet në motorin e zhvillimi lokal të qëndrueshëm, pa cenuar rolin strategjik të resurseve tradicionale dhe identitetin e territoreve bujqësore¹.

Krahas resurseve natyrore dhe kulturore, agroturizmi lipset të garantojë zhvillimin e qëndrueshëm të burimeve njerëzore që përfshihen në veprimtaritë ekonomike lokale.

Paketat turistike, që u mundësojnë vizitorëve qëndrimin në ferma, për t’u çlodhur e kënaqur me produktet e fshatit, si dhe t’u përfshirë në jetën ekonomike dhe social-kulturore rurale në RSH, janë ende të pakta.

¹ Guaelerzi, 2003.

1. Qasje teorike dhe konceptuale

1.1 Koncepti mbi agroturizmin

Ekzistojnë disa përkufizime mbi konceptin “agroturizëm”. Studjuesit (Barbieri & Mshenga, 2008; Blacka et al., 2001; Che et al., 2005) e kanë përcaktuar agroturizmin si një grup shërbimesh (akomodimi, ushqimi dhe aktivitete rekreative), të ofruara për tërheqjen e vizitorëve në fermë. Maedold (2002) e argumenton agroturizmin si një sipërmarrje alternative që lidh prodhimin bujqësor me udhëtimin në fermë. Më i pranuari është përkufizimi i Gil et al. (2013), që e përcaktojnë agroturizmin si “realizimi i veprimtarive bujqësore në fermë ose në mjedise të tjera bujqësore për qëllime argëtimi ose edukimi” (fq. 45).

Tew dhe Barbieri (2012) kanë identifikuar tri kategori aktivitetesth për sipërmarrjet agroturistike:

- a. Prodhimi bujqësor. Drithërat (gruri, misri, thekra ...); të lashta (foragjeret ...); kulturat industriale (duhani, panxhari ...); blegtoria (gjedhët, derrat, kuajt, delet, dhitë, shpendët dhe kafshët e vogla; kafshët jo tradicionale (drerët, bizonët dhe kafshët e tjera ekzotike): peshkimi; produktet prej druri; produktet e tjera bujqësore (vezë, mjaltë, qumësht etj.).
- b. Akomodimi dhe shërbimi ushqimor: bed and breakfast, kabina fjetjeje, park rekreativ për automjete, dhoma degustimi, katering, hotele, restorante, hapësira për barbeques ose piknik, ushqime take-away.
- c. Shërbimet rekreative: shëtitjet në fermë, vjelja dhe korrja e prodhimeve, vëzhgimi i shpendëve dhe kafshëve të egra, muzetë bujqësorë, gjuetia, peshkimi, festat, festivalet, shfaqjet, ngjarjet, hiking ose biking, udhëtimet edukative, drejtimi i makinerive bujqësore, shëtitje në kalë etj.

Në artikullin “Sistemet Ushqimore dhe Zhvillimi i Komunitetit” (Gazeta e Bujqësisë, 2018), identifikohen katër kategori aktivitetesth agroturistike:

- mikpritja (qëndrimi ose fjetja në objektet akomoduese të fermës për një ose disa net);
- shitje të drejtpërdrejta te konsumatori, edukimi bujqësor (vizita të nxënësve në fermë);

- rekreacioni (gjuetia, peshkimi, kalërimi ...);
- argëtimi (dreka, darka festive).²

Shumica e agroturistëve e kalojnë kohën duke vizituar stendat e fermave, duke zgjedhur fruta e perime ose duke ushqyer kafshët; të tjerët dukeshëtur në labirintete misrit, vreshtave dhe pemëtoreve, duke admiruar peizazhin apo duke ndihmuar në punët bujqësore.³

1.2 Përmbajtja dhe rëndësia e agroturizmit

Rritja e konkurrencës në tregun global, ndërgegjësimi ndaj mjedisit, orientimi drejt sektorëve të shërbimeve dhe fokusi i politikës publike për transformimin e territoreve rurale në peizazhe atraktive, ka nxitur krijimin e një modeli të ri të zhvillimit rural. Ndërkohë, rritja e kostove monetare si rrjedhojë e shtimit të përdorimit të inputeve dhe teknologjisë jashtë sektorit bujqësor, rritja e kostove lidhur me kujdesin ndaj mjedisit, mirëqenies së kafshëve dhe sigurisë së ushqimit, kanë shtruar nevojën për tejkalimin e modelit mëparshëm të zhvillimit të bujqësisë, të njohur si produktivizëm.

Krahas funksionit primar të bujqësisë (prodhimi i ushqimit dhe fibrave), që mbetet mbizotërues, vlerat e tjera rurale si: peizazhi, mjedisi, siguria ushqimore, përpunimi, turizmi, aftësitë dhe njohuritë tradicionale dhe burimet kulturore, kanë krijuar një model të ri në zhvillimin bujqësor.

Në kuptimin si biznes, agroturizmi u shfaq Europë në 1982, kur Komisioni Ekonomik i OKB-së për Europën mbajti një simpozium të përbashkët me FAO-n⁴ për trajtimin e efekteve të turizmit në bujqësi dhe mundësinë e integritit të këtyre dy sektorëve, me shpresën se territoret rurale do të mund të përfitonin zhvillim kompleks dhe të qëndrueshëm.

Gjatë dekadës së fundit, agroturizmi është bërë shumë i preferuar në Amerikën Veriore dhe Jugore, në Azi, Afrikë dhe Oqeani, ndërkohë që në Itali ka më shumë se 12,1 milionë agroturistë në vit, të cilët vizitojnë rreth 25 mijë ferma agroturizmi.

² Chase, Lisa C. et al.(2018). "Agritourism: Toward a Conceptual Framework for Industry Analysis". Journal of Agriculture, Food Systems, and Community Development. 8 (1): 13–19.

³ Biuso, Emily. "Down on the farm with your Sleeves Rolled Up"

⁴ Organizata për Bujqësi dhe Ushqim e OKB-së.

Studimet argumentojnë se agroturizmi është një strategji për zhvillimin rural, e cila konsiston në diversifikimin e veprimtarive bujqësore, rritjen e punësimit (sidomos për përfshirjen e të rinjve dhe grave), mbrojtjen e peizazhit, frenimin e shpopullimin dhe të braktisjes së kulturave tradicionale, ofrimin e teknikave prodhuese më të qëndrueshme dhe me ndikime pozitive në biodiversitet dhe burimet natyrore. Agroturizmi shihet si promotor për zhvillimin lokal, sidomos për territoret e marginalizuara dhe fermat e vogla, përmes diversifikimit të aktiviteteve fitimprurëse dhe shtimit të pasurisë.

Kjo strategji zhvillimi, e njohur që nga fillimi i shek. XX, është konsideruar një metodë e plotësimit të të ardhurave bujqësore, përmes shfrytëzimit të burimeve në fermë dhe të shërbimeve shtesë, si: akomodimi dhe aktivitetet rekreative.

1.3 Qëllimi, synimet, fokusi i studimit

Studimi ka për qëllim evidentimin e rolit të medias në vlerësimin dhe promovimin e agroturizmit në ekonominë dhe jetën social-kulturore të fshatit shqiptar, në lidhje të ngushtë me veprimtaritë lokale bujqësore-artizanale dhe në përputhje me objektivat e zhvillimit rural të integruar e të qëndrueshëm.

Ai synon vlerësimin e specifikave vendore, nëpërmjet njohjes së vlerës së peizazhit bujqësor dhe cilësisë së prodhimeve bujqësore, që i japin territorit rural rol të privilegjuar, sa i përket funksioneve që bart, ku mjedisi rural dhe trashëgimia kulturore ndërthuren me prodhimtarinë bujqësore, duke krijuar identitetet lokale, që i nevojiten agroturizmit.

Fokusi është në subjektet që janë identifikuar nga media si pionieredhe modele të agroturizmit në Shqipëri. Ato kanë arritur të kenë një ndikim modest në zhvillim ekonomik lokal, në krahasim me territoret ku ende nuk ka investime të atij lloji.

1.4 Metodologjia dhe metodat e studimit

Metodologjia: analizë e zhvillimit lokal, bazuar në identifikimin, vlerësimin, valorizimin dhe përdorimin e resurseve bujqësore dhe kulturore endogjene, që formojnë identitetin e territorit. Në këtë lloj zhvillimi, territori trajtohet si arenë e ndërveprimit dhe bashkëpunimit të shumë veprimtarive, si hapësirë rregulluese dhe e kompromiseve

sociale, si një tërësi elementesh natyrore dhe antropogjene të ndërlidhura në sistemet sociale, ose vendtakimi mes forcave të tregut dhe formave të rregullimit ekonomik e social.

Metodat bazë kërkimore të përdorura në realizimin e këtij punimi janë:

- grumbullimi i informacionit teorik nga literatura vendëse dhe konsultimi i modeleve të ngjashme që ofron literatura e huaj;
- grumbullimi i informacioneve nëpërmjet punës në terren dhe bisedave me pjestarë të pushtetit vendore dhe komunitetit;
- analiza e detajuar e ofertës turistike të territoreve të zgjedhura për agroturizëm;
- analiza shkak-pasojë, me qëllim nxjerrjen në pah të faktorëve që ndikojnë në zhvillimin e agroturizmit dhe të ndikimit të tij në hapësirën, komunitetin dhe ekonominë rurale;
- evidentimin e mundësive që territoret rurale kanë për zhvillimin e agroturizmit;
- konsultimi i materialit hartografik dhe i fotografive ajrore për paraqitjen sa më të saktë të zhvillimeve hapësinore;
- konkretizimi i materialit teorik me fotografi, grafikë etj.
- evidentimi, përmes intervistave, i nevojës për përpilimin e një strategjie për zhvillimin e agroturizmit, në bazë të mundësive që ofron hapësira rurale e Shqipërisë;
- nxjerrja në pah e disa elementeve dhe hapësirave të veçanta, me qëllim propozimin e një itinerari agroturistik nëpër vendin tonë;
- paraqitja sintetike e përfundimeve dhe sugjerimeve

2. Potencialet e Shqipërisë për agroturizëm

Shqipëria ka potenciale natyrore, ekonomike, sociale dhe kulturore për zhvillimin e agroturizmit, të tilla si:

- relievi plot kontraste dhe peizazhet natyrore dhe bujqësore piktoreske;
- klima mesdhetare, e butë dhe e shëndetshme gjatë 12 muajve të vitit;

- pasuritë ujore të bollshme: dete, laguna, lumenj, liqene, ujëra nëntokësore të pastra e të pijshme, minerale, termale e termominerale;
- flora e egër, e pasur dhe e larmishme (shumë specie endemike dhe subendemike): pyje, shkurre, kullota; bimë mjekësore, aromatike, mjaltëse; boronica, manaferra, luleshtrydhe, kërpudha etj.;
- fauna e egër, tokësore dhe ujore: nga kafshët, shpendët, peshqit, zvarranikët, bletët, kërmijtë e midhjet, deri tek insektet dhe mikroorganizmat;
- kultura bujqësore të shumëllojshme: drithëra, foragjere, perime, zarzavate, bostane, fasule, patate, bimë industriale, pemët frutore, arrorë, vreshta, agrume, ullishta, bimë dekorative;
- praktika bujqësore tradicionale: mbjellje, përkujdesje, korrije/vjelje, seleksionimi dhe ruajtja e farës, kultivarët autoktonë;
- praktika e lashta, si shtegtimi i bagëtive, racat autoktone, mbarështimi i pyjeve dhe kullotave, peshkimi, gjuetia, bletaria;
- gatimet, zahiretë, pajisjet, orenditë dhe enët, teknikat dhe teknologjitë tradicionale të përgatitjes, konservimit dhe ruajtjes së ushqimeve për njerëzit dhe kafshët;
- tregjet, panairët dhe praktikët e shkëmbimit, shit-blerjes dhe qiradhënies në fshat;
- mënyrat dhe rregullat e mikpritjes e të shërbimit, ceremonitë festive lidhur me praktikët dhe prodhimet bujqësore / blegtorale;
- trashëgimia kulturore rurale/bujqësore, traditat, zakonet dhe doket, veshjet, veglat dhe instrumentet e bujqve, blegtorëve dhe artizanëve, legendat dhe proverbat, dollia, kanunet, besimet dhe besëtytnitë, jeta ekonomike social-kulturore dhe sportive në fshat;
- pozita gjeografike në udhëkryq të flukseve turistike ndërkombëtare, afër vendeve të industrializuara dhe urbanizuara të Evropës Perëndimore, SHBA-së etj.

3. Disa nga gjetjet e kërkimeve të deritanishme mbi agroturizmin në Shqipëri

Në publikimet e deritanishme mbi agroturizmin në Shqipëri, të konsultuara gjatë punës për realizimin e këtij punimi, del se:

- Mediat sociale publikojnë vazhdimisht persona me ndikim, që pozojnë në vreshtat ose tregjet e fermerëve. Shumë udhëtarë dëshirojnë të përsërisin përvoja të tilla dhe të marrin ndjesi të vërteta nga vendet që vizitojnë.
- Trendi global i slow food “nga ferma drejtpërdrejt në tavolinë”, si dhe lëvizjet për ushqime organike, tregti të drejtë, produkte të rritura ngadalë, prodhime të sezonit etj., kanë rritur ndërgjegjësimin e brezit të ri për ushqimet që konsumojnë.
- Përmes agroturizmit synohet mbajtja në punë e fermave që sigurojnë produktet lokale që u shërbejnë turistëve, si dhe përmirësimi i kushteve të jetesës së popullsisë rurale.
- Sipas MBZHR-së (2022), në RSH janë 22 “Subjekte të certifikuara për veprimtarinë e agroturizmit” dhe 17 “... me certifikatë provizore për veprimtarinë e agroturizmit”.

Nr	Subjekti	Emri tregtar	Telefoni	E-maili	Adresa	Dh
1.	Alfred Fiska P.F.	Bujtina Rroshnik	0682091617	alpetëinery@gmail.com	Rroshnik-Berat	8
2.	Albina Çuko P.F.	Bujtina Tomadhe	0692105543	albinacuko1@gmail.com	Shën Gjergj-Tiranë	6
3.	Qafshatamë sh.p.k.	Qafshatamë	0696060000	info@shkrelireort.al	Qafshatamë-Krujë	25
4.	Kol Marku P.F.	Bujtina Dini	0684652952	ari_al_85@hotmail.com	Katund i Vjetër-Mirditë	6
5.	Qemal Alushi P.F.	ENOL	0682036634	alushiolsi87@gmail.com	Prezë-Tiranë	6
6.	Shqipe Huqi P.F.	Agri Tourism HUQI	0684099909	agritourism.huqi@gmail.com	Radë-Durrës	6
7.	Libonike Nurellari P.F.	Kantina Nurellari	0695262940	fatosnurellari@yahoo.com	Peshtan-Poliçan	6
8.	Agro Gjepali sh.p.k.	Agro Gjepali	0684370437	fundimgjepali@gmail.com	Gjepalaj-Shijak	6
9.	Altin Prenga P.F.	Mrizi i Zanave	0696555252	altinprenga@hotmail.it	Fishtë-Lezhë	9
10.	Kodra e Kuajve sh.p.k.	Kodra e Kuajve	0696090081	kodra_kuajve@yahoo.com	Kodra e Dedejve-Durrës	18
11.	Gramozi BR sh.p.k.	Gramozi BR	0682297081	gramozibr@gmail.com	Poshnje-Berat	7
12.	Our Oën Expeditions sh.p.k	OurOënExpeditions	0676096010	nancytare@ouroënexpeditionns.com	Nivicë-Tepelenë	6
13.	Jeton Hida P.F.	Farma Sotira	0693054121	farmasotira@gmail.com	Ersekë-Korçë	7
14.	Vasillaq Xhufka P.F.	Bujtina&Taverna Xhufka	0692394269	piroxhufka8@gmail.com	Boboshticë-Korçë	17
15.	Luljeta Xhebro P.F.	Bujtina Xhebro	0694643704		Kurvelesh-Gjirokastrë	6
16.	Dashurie Zerja P.F.	Agroturizëm Zerja	0699377337	agro_zerja@yahoo.com	Melan-Dibër	8

SI TA BËJMË TRASHËGIMINË TONË KULTURORE TË FLASË? – KREATIVITET
DHE NDËRMJETËSIM NË NJOHJEN E TRASHËGIMISË KULTURORE”

17.	Fran Kaçorri P.F.	Kantina Arbri	0694433773	info@kantina-arberi.com	Rrëshen-Lezhë	6
18.	Nari-Lundra sh.p.k.	Nari-Lundra	0692036722	info@narilunder.al	Lundër-Tiranë	11
19.	Gonxha sh.p.k.	Nano Bio Food	0682022252	nano_resort@yahoo.com	Daias-Tiranë	13
20.	Pellumb Bilo P.F	Sofra Kolonjare	0693623108	edlibilo@gmail.com	Mollas-Ersekë	6
21.	SO - EL sh.p.k.	Kompleksi Agrotur. "Panorama"	0692385164	soelshpk@hotmail.com	Mengel-Elbasan	6

Pasqyra 1. Regjistri i subjekteve të certifikuar për agroturizëm, korrik 2022

- Në RSH, agroturizmi është biznes familjar, që menaxhohet kryesisht nga persona të rinj (rreth 35 vjeç). Fermat agroturistike zotërojnë mesatarisht 7,3 ha tokë.
- Në kuadër të Programit “100 fshatrat” fermerët dhe shoqatat e tyre, OJF-të dhe aktorët e tjerë që synojnë të investojnë në agroturizëm, mbështeten me grantefinanciare nga AZHBR-ja, UNDP-ja, Ceed Albania etj.
- Qeveria, në kuadër të politikave fiskale, ka reduktuar TVSH-në nga 20% në 6% dhe tatim-fitimin në 5%. Këto masa ndihmojnë në formalizimin e sektorit të bujqësisë, ku vetëm 12% e fermave kanë NIPT.
- Në terma jo ekonomikë, agroturizmi konsiderohet si veprimtari që plotëson dëshirat e vizitorëve për autenticitet dhe jetë të shëndetshme. Ai mbron dhe rivlerëson peizazhet rurale piktoreske, që janë tërheqëse dhe frymëzuese për turistët.
- Agroturizmi është mundësi për përfitime shoqërore dhe kulturore, si edukimi më i mirë publik lidhur me mjedisin, sigurinë ushqimore, shëndetin, bujqësinë, si degë me rëndësi për ekonominë dhe cilësinë e jetës në Shqipëri.
- Agroturizmi afron banorët e qyteteve me bujqësinë dhe jetën rurale, duke krijuar mundësi për njohje kohezion social, emancipim të popullsisë rurale, urbanizim të fshatrave, bashkëpunim ekonomik e kulturor midis bashkësive rurale dhe urbane.

4. Kontributi i Revistës Monitor në prezantimin dhe promovimin e agroturizmit

4.1 Publikimi dhe shpjegimi i akteve ligjore dhe nënligjore

Monitor ka publikuar, analizuar dhe komentuar VKM-në Nr. 22, datë 12.01.2018 “Për miratimin e kriterëve e të procedurave për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit dhe ndërtimin e strukturave / objekteve në funksion të tij”.

Sipas tij, për t’u certifikuar si “agroturizëm”, subjekt duhet të plotësojë këto kriterë:

- Toka: 1 ha në terren të hapur, 0,5 hektar serra ose 0,5 ha në zona të mbrojtura.
- Shërbimet: ushqim, akomodim, shërbime rekreative (të paktën një prej tyre).
- Kapacitetet e akomodimit: 6 - 30 dhoma.
- Arkitektura e ndërtesave: sipas VKM-së Nr. 711, datë 12.10.2016 dhe Nr. 730, datë 12.12.2018 për “Kushtet, kriteret dhe procedurat për klasifikimin e strukturave akomoduese”.
- Restorantet: 6 - 60 tavolina për shërbimin e ushqimit.
- Origjina e produkteve: të paktën 30% e ushqimeve dhe pijeve që ofrohen duhet të jenë prodhime të fermës, pjesa tjetër nga fermat përreth.

Agroturizmi mund të ofrohet edhe nga subjekte blegtorale, të peshkimit apo të përpunimit, me kusht që:

- Ferma blegtorale të mbarështojë të paktën 10 krerë gjedh ose 100 krerë dele/dhi apo 200 krerë shpendë. Te fermat blegtorale përfshihen edhe stanet.
- Ferma e peshkimit/akuakulturës, që krahas ushqimit (peshk, fruta deti, midhje, që rritet në gjendje të lirë apo të kultivuar në rezervate), që shërbehet sipas standardeve ligjore, ka edhe kapacitete akomodimi dhe shërbime rekreacioni.
- Njësia e përpunimit të produkteve bujqësore, blegtorale, të peshkimit e akuakulturës, që plotëson kriteret ligjore për agroturizëm.
- Sipas ligjit për turizmin, strukturat e akomodimit duhet të respektojnë kriteret urbanistike të ndërtimit, si dhe atotë përcaktuara në planet vendore.

- Ushqimi dhe pijetofrohen në mjedise që plotësojnë normat në fuqi për ushqimin dhe kushtet higjienike-sanitare. Restorantet duhet të ketë 6 - 60 tavolina.
- Subjektet agroturistike ofrojnë/mundësojnë për vizitorët vepri-mtari çlodhëse/argëtuese.
- Vlefshmëria e certifikatave është 5 vjet.

4.2 Përgjithësime mbi ecurinë e subjekteve agroturistike

Revista Monitor ka prezantuar disa prej subjekteve agroturistike që operojnë në Shqipëri, duke nxjerrë në pah veçoritë, ecurinë, problematikat me të cilat janë përballuar dhe planet që ato kanë për të ardhmen. Analiza e shkrimeve të derisotme mbi agroturizmin në Shqipëri na mundësoi të arrijmë në përgjithësime si vijon:


- Themeluesit e subjekteve agroturistike të suksesshëm janë kthyer nga emigracioni, ku kanë fituar përvojë, kulturë pune dhe para për t'i investuar për zhvillimin e biznesit.
- Subjektet kanë ndjekur të njëjtin rend për shndërrimin në agroturizëm: krijimi i fermës për sigurimin e prodhimeve vendore, ndërtimi i restorantit dhe i strukturës akomoduese, ndërtimi i kantinës për prodhimin, ruajtjen, degustimin dhe tregtimin e verës, krijimi i kushteve për vizita njohëse, çlodhje dhe argëtim.
- Strukturat akomoduese janë kryesisht ndërtesa të stilit mesdhetar, kombinime të elementeve tradicionale dhe moderne, ku ndërthuren bujtina për fjetje dhe restoranti. Kulla e Arnume e “Mrizit të Zanave”, e realizuar nga arkitektë të rinj shqiptarë, ka bërë xhiron e botës në rrjetet sociale (v. 2019).
- Disa nga subjektet kanë marrë mbështetje nga AZHBR-ja, USAID-i, CeedAlbania etj., ndërsa qeverisja lokale ka ndihmuar përmes lehtësirave për miratimin e dokumentacionit, sistemimin e rrugëve etj.
- Subjektet agroturistike janë shndërruar në gjenerator punësimi për komunitetet, drejtpërdrejt dhe tërthorazi: duke angazhuar punëtorë vendës dhe duke nxitur fermerët e trevës të prodhojnë më shumë.
- Stafin e rekrutojnë dhe trajnojnë vetë, duke tentuar ruajtjen e identitetit të trevës në komunikim dhe veshje, si dhe duke synuar

shërbim korret e cilësor. Subjektet kanë filluar të ndjejnë vështirësi për gjetjen e fuqisë punëtore me kontrata afatgjatë.

- Megjithëse numri i subjekteve rritet vazhdimisht, nuk ka shenja të mbingopjes së tregut agroturistik, pasi edhe numri i personave që zgjedhin të praktikojnë agroturizmin po rritet pandërprerë.
- Mbizotërojnë vizitorët familjarë, me ndërthurje të gjeneratave. Frekuentuesit kryesor të agroturizmit vijnë nga qyteteve të mëdha të Shqipërisë, vendet fqinje, Europa Perëndimore dhe Lindore, Kina, Izraeli etj. 7-8% e vizitorëve janë të huaj.
- Kompani mediatike të huaja (franceze, britanike, italiane, belge etj.), kanë realizuar dokumentare për kulinarinë tradicionale dhe stilin e jetesës në krahinat e RSH-së.
- Rezervimi përmes Booking-ut është bërë rregull në të gjitha subjektet agroturistike.
- Përmirësimi i rrugëve e ka lehtësuar mbërritjen tek subjektet agroturistike.
- Subjektet agroturistike janë prodhuese, promovuese dhe tregtuese të produkteve “Made in Albania”. Në restorantet e tyre nuk shërbehen ushqime dhe pije industriale. Vera shihet si një lokomotivë e fuqishme për agroturizmin.
- Vizitorët e huaj largohen me përshtypje të mira dhe e përcjellin pozitivisht përvojën e tyre në Shqipëri, përmes rrjeteve sociale, publikimeve në gazeta dhe revista, intervistave dhe reportazheve televizive.
- Turistët e huaj e shijojnë shumë ushqimin, pasi produktet në Shqipëri vijnë të jenë natyrale dhe më cilësore, krahasuar me ato të vendeve prej nga vijnë.
- Shumica e ushqimeve kanë si bazë drithërat dhe mishin, por shërbehet edhe peshk, djathë, byrek, petanik, lakror të pjekur në saç, kulaç apo bukë misri të gatuar sipas mënyrës tradicionale.
- Ka një tendencë të shtimit të gatimeve me produkte bimore, pasi dietat ushqimore të sotme po orientohen gjithnjë e më shumë drejt pjatave për vegetarianë.
- Përveç se të gatuar, prodhimet lokale u ofrohen vizitorëve të

eksponuar në stenda: verë dhe raki, ullinj dhe vaj ulliri, fruta, çaj, zahire, mjaltë, reçel, gliko etj.

- “Vizita në fermë” po shndërrohet në produkt turistik, përmes ofrimit të paketave që përfshijnë shëtitjet në natyrë (në këmbë, me kuaj, biçikletë), eksplorimin e fshatrave, piknik, kamping, peshkim, gjueti, kanotazh, vëzhgimin e zogjve, soditjen e peizazhit.
- Agroturizmi ka transformuar konceptin e qytetarëve për fundjavën. Ka një përqendrim të klientelës agroturistike në Shqipërinë e Mesme dhe në rrethinat e qyteteve të mëdha të vendit.
- Shqipëria ka bankën e farave dhe fidanëve autoktone më të pasurën në rajon, me rreth 4500 kultivarë. Agroturizmi dhe pasioni për bujqësinë organike po rrit interesin për përdorimin e farave dhe racave autoktone, me origjinë qindra vjeçare.
- Falë zgjerimit dhe konsolidimit të prodhimeve të fermës dhe reduktimit të fitimit, ofertat janë ruajtur të pandryshuara, megjithë rritjen e ndjeshme të çmimit të karburantit, energjisë, ushqimeve etj.



Përfundime dhe rekomandime

Agroturizmi po zhvillohet në RSH si nismë e personave me vizion dhe përvojë në biznes, të mbështetur nga AZHBR-ja, UNDP-ja, Ceed Albania dhe qeveria shqiptare, në kuadër të programeve të zhvillimit rural, si “100 fshatrat”.

Me resurset që zotëron hapësira bujqësore e vendit, agroturizmi mund të shndërrohet në promotor punësimi dhe të ardhurash alternative për banorët e fshatrave, duke ndikuar në rivitalizimin e jetës rurale, pas eksodit dhe rrënimit ekonomik gjatë periudhës së tranzicionit.

Ky lloj turizmi ka perspektivë, pasi u ofron vizitorëve realitete unike jetese, mentaliteti dhe sjelljesh; produkteve artizanale dhe gatimesh; veprimtarish pritëse, akomoduese, çlodhëse, argëtuese dhe komerciale; aktiviteteve tradicionale të lidhura me bujqësinë, blegtorinë, pylltarinë, peshkimin, gjuetinë.

Rikthimi në të shkuarën e afërt dhe të largët sjell për vizitorët ndjesi të paprovuara gjetkë. Duke qenë se gjithë kjo zhvillohet në mjedise me gjelbërim, ujëra dhe ajër të pastër, efekti i këtij turizmi në shëndetin e vizitorëve është evident dhe motiv i fortë për ta frekuentuar.

Agroturizmi po zë vendin e merituar në Planet Strategjike të Zhvillimit Ekonomik e Social të RSH-së të viteve të fundit. Që ai të zhvillohet sipas standardeve të BE-së, lipset që institucionet vendore dhe shtetëroretë angazhohen për:

- evidentimine ofertës agroturistike natyrore, historike, ekonomike dhe kulturore në mjediset bujqësore, blegtorale dhe pyjore të vendit;
- vlerësimin dhe valorizimine pasurive agroturistike në hapësirën rurale;
- nxitjen e investitorëve për hapjen e veprimtarive agroturistike në territorin e RSH-së;
- ndërgjegjësimine fermerëve mbi rëndësinë ekonomike dhe sociale të agroturizmit;
- promovimin e agroturizmit të qëndrueshëm, që respekton burimet natyrore dhe kulturore;
- informimin dhe mbështetjen subjekteve agroturistike;

- formimin, specializimin dhe motivimine punonjësve, që të mos emigrojnë;
- përmirësimine infrastrukturës rrugore, të furnizimit me ujë dhe energji elektrike;
- mbajtjen pastër të mjedisit, administrimine mbetjeve, përpunimine ujërave të përdorura;
- kurimine vazhdueshëm të peizazhit, për t'i dhënë atij vlera estetike-turistike;
- forcimin e rendit dhe të sigurisë për jetën;
- rritjen e kujdesit për ruajtjen e specieve dhe racave autoktone;
- përshtatjen e banesave rurale për turistët;
- miratimin e një ligji në përputhje me realitetin e RSH-së dhe nxitës për agroturizmin;
- hartimine politikave dhe strategjive lokale dhe kombëtare të zhvillimit të agroturizmit.

Itinerare rajonale dhe shtetërore të agroturizmit, do të ishin interesante për vizitorët vendës dhe të huaj, pasi do t'u mundësonin atyre diversitet përjetimesh në kohë të shkurtër.

Përvojat e vendeve të zhvilluara, sidomos të atyre mesdhetare, që i kanë identifikuar, vlerësuar dhe shfrytëzuar resurset turistike natyrore, bujqësore dhe kulturore, duke e shndërruar agroturizmin në burim punësimi dhe të ardhurash në fshat, garanton suksesin e këtij aktiviteti.

Për të pasur sukses dhe qëndrueshmëri, si dhe për të qenë konkurruese në tregun kombëtar dhe rajonal, është e nevojshme që subjektet agroturistike në Shqipëri të krijojnë profilin dhe identitetin e tyre.

BIBLIOGRAFIA

Referime artikujsh

BIUSO E. "Down on the farm with your Sleeves Rolled Up", The New York Times: New York, NY, USA, 2007

CERAMAC (2003), *Crises et mutations des agricultures de montagne*, Actes de Colloque International, Clermont-Ferrand (12-13.12.2002), Francë.

- CHASE, LISA C. et al. (2018-04-02), *Agritourism: Toward a Conceptual Framework for Industry Analysis*, në “Journal of Agriculture, Food Systems, and Community Development”, 8 (1): f. 13–19. ISSN 2152-0801.
- LAÇI S. (2015), *Prespa e Vogël: peizazhi dhe trashëgimia si premisa për zhvillimin e turizmit*, në Konferencën Shkencore të Departamentit të Arkeologjisë dhe TK-së, FHF, Tiranë.
- LAÇI S & KOLA E. (2009), *La valorisation du patrimoine rural en fonction du développement du tourisme en Albanie*, në European Spatial Planning & Landscape, No. 88, CE Publishing, Bruksel.
- PAPATHIMIU S & LAÇI S. (2008), *Turizmi dhe mjedisi në zonën Divjakë-Karavasta – marrëdhënie kontradiktore apo plotësuese*, në “Kërkime gjeografike”, nr. 14, Prishtinë.
- AUTORE të ndryshëm, publikime ndër vite në Revistën Monitor, Tiranë.

Referime librash

- DE PILATI M. (1989), *Geografia del turismo in Europa*, Zanichelli, Bolonja.
- GJERGJI A. (2002) *Mënyra e jetesës në shekujt XII-XX*, KOTTI, Korçë.
- KABO M. et al. (1990), *Gjeografia Fizike e Shqipërisë*, QSGJ, ASHRSH, Tiranë.
- KRASNIQI M. (2005), *Mikpritja në traditën shqiptare*, AASHK, në LVII, Libri 16, Prishtinë.
- SHKURTI S. (2002), *Tradita bujqësore e shqiptarëve*, ASHRSH, Tiranë.

Referime ligjesh dhe VKM-shë

- KM i RSH-së (2019), *Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2023*, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Tiranë.
- KM i RSH-së (2013), *Strategjia e Zhvillimit të Turizmi Rural*, Ministria e Turizmit dhe Zhvillimit Rural, Tiranë.
- KM i RSH-së (12.01.2018), VKM-së Nr. 22, datë “Për miratimin e kritereve e të procedurave për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit dhe ndërtimin e strukturave / objekteve në funksion të tij”, Tiranë.
- KM i RSH-së (12.10.2016 dhe 12.12.2018), VKM-së Nr. 711 dhe Nr. 730, për “Kushtet, kriteret dhe procedurat për klasifikimin e strukturave akomoduese”, Tiranë.

THE CONTRIBUTION AND BEST PRACTICES
OF THE ENGLISH DEPARTMENT,
FACULTY OF FOREIGN LANGUAGES,
TIRANA UNIVERSITY IN CURRICULUM
DEVELOPMENT AND IMPLEMENTATION FOR
THE UNDERGRADUATE AND GRADUATE
PROGRAMMES IN TRANSLATION AND
CONFERENCE INTERPRETING

Dr. NEJLA QAFMOLLA

Fakulteti i i Gjuhëve të Huaja
Universiteti i Tiranës
nejla.qafmolla@unitir.edu.al

Msc. SONILA ALLA

Fakulteti i i Gjuhëve të Huaja
Universiteti i Tiranës

Prof. Dr. VIKTOR RISTANI

Fakulteti i i Gjuhëve të Huaja
Universiteti i Tiranës
viktor.ristani@unitir.edu.al

Abstract

The presentation focuses on theoretical and practical aspects related to the implementation of the 1998 restructured four-year curricula, the 2005 new three-year curricula, the 2008 two-tier system of vocation-based translation and conference interpretation training curricula for undergraduate and graduate degree courses of translation and conference interpreting, in general, and the one-year vocation-based taught Master Program of Pragmatic Translation at the English Department, Faculty of Foreign Languages, Tirana University, especially emphasizing previous departmental experience, expertise and qualifications, the local and international labour market, as

well as the students’ needs, the course objectives, content, course duration, knowledge and competences characterizing the course of study, cultural and professional background of the students at the end of the programme, academic staff professional profile and skills, and the future action required in this respect.

Keywords: institutional experience, translation and conference interpreting curricula, two-tier system of vocation-based translation and conference interpretation training, English Department, local and international market, Master Program of Pragmatic Translation, future action

I. DEVELOPING THE TWO-TIER VOCATION-BASED TRANSLATION AND CONFERENCE INTERPRETER TRAINING AT THE ENGLISH DEPARTMENT, FACULTY OF FOREIGN LANGUAGES, THE TIRANA UNIVERSITY

The Department of English, Faculty of Foreign Languages at the University of Tirana, established in 1960, is the largest of this type in Albania. The undergraduate students are currently trained in three specialised tracks: linguistic and literary study, translation and conference interpreting, and cultural studies. In addition to acquiring more profound knowledge in English language, culture and civilisation, they are offered the chance to learn a second and/or third foreign language.

During the 1998-1999 academic year, the restructured four-year curricula envisaged two other tracks, respectively Translation and Conference Interpreting, as well as British and American Studies, in addition to further improving the existing traditional ELT (English Language Teaching) course of studies. A considerable number of translators and interpreters, graduates of English, Translation and Conference Interpreting Track, have been employed by the Albanian Government, International organisations, Tirana-based Embassies, NGO-s, translation agencies, etc.¹

In October 2005, the new three-year curricula were introduced and developed, in line with the requirements of the Bologna Process, finally giving way to the introduction of the two-tier system of vocation-based

¹ More detailed information is provided in the following sections and subsections.

translation and conference interpretation training, in October 2008.

In addition to teaching, in view of their proficiency of specialised language in various areas, predominantly in the specialised areas of legal English, Business English, English for Public Administration, English for International Marketing, English for International Affairs and Diplomacy, etc., as well as specialised proficiency in English language for specific purposes taught at the Department of English, and the long-term commitment to translation and conference interpreting, our Department staff have been and are providing translation and conference interpreting services to the various national and international agencies.²

As early as 2007, in line with the efforts underway to improve translation practices in Albania, the Ministry of Integration was expected to cooperate with the Department of English Language with a view to involving in this process a number of highly qualified department staff and possibly students, likewise signing a Protocol of Co-operation and a Memorandum of Understanding with the Department of English Language. According to this memorandum, the recruitment of students/department staff in the fields concerned would be envisaged, as well as redeveloping the curricula to better meet the students' needs and expectations for their vocation-based training.³

1.1. Bologna process curriculum

Following the implementation of the Bologna process requirements, the higher education system in the Republic of Albania has been regulated by the Laws "On Higher Education in the Republic of Albania", respectively No.9741, dated 21.05.2007 and No.80/2015, dated 22.07.2015. According to these laws the tertiary education system is organized based on three levels⁴, respectively.

² The Department of English constitutes the principal resource for practicing and officially recognised and certified translators and conference interpreters in Albania, in addition to the free-lance translators and conference interpreters.

³ RISTANI, V. (2009), "*Researching and assessing the translation and conference interpreting services and the training capacities in Albania*", presentation delivered at the International Conference "Across English language and culture", organized by the English Department, Faculty of Foreign Languages University of Tirana, 17 – 18 April, 2009. Published in the Conference Proceedings.

⁴ The information provided is based on "Law on Higher Education in the Republic of Albania" no.9741, dated 21.05.2007 and no.80/2015, dated 22.07.2015

a. *Bachelor Degree* is awarded upon completion of the first level programme of studies. It aims at providing graduates with common-core expertise on general and scientific methods and principles, as well as specialised and specific skills in a variety of professions and specializations. These programmes correspond to 180 credits (under the European Credit Transfer System, ECTS) and take a maximum of 3 years to complete. The first two years focus on common-core modules and electives. During the third year of undergraduate studies, the students of English are trained in three specialised tracks, respectively: *language study, translation and conference interpreting; British and American Studies*. The Bachelor's degree allows transition to the labour market, access to the civil service and the subsequent Master degree programmes.

b. *Master of Science/Art Degrees* stand/s for the degrees awarded upon completion of the second level programme of study. These programmes provide the postgraduate students with an advanced level of theoretical and/or practical education and training in translation and conference interpreting and/or specialised translation, respectively. The English Department at the Faculty of Foreign Languages offers two programs, one specialising in *Translation and Conference Interpreting*, envisaging 120 credits (under the European Credit Transfer System, ECTS) with a maximum of 2 years to complete, and another one specialising in *Pragmatic Translation*, envisaging 60 credits (under the European Credit Transfer System, ECTS) with a maximum of 1 year to complete.

c. *Doctoral Studies Programmes*.

1.2. *Institutional Experiences In Translator And Conference Interpreter Training*

During more than 30 years onwards, even prior to introducing the two-tier program of translation and conference interpreting, the Department of English, Faculty of Foreign Languages and its staff have been involved in the following academic, curriculum development, training and research activities:

- Participation in in-service training and vocational training courses introduced and funded by various International Agencies, Universities, and Embassies, as from 1988.

- Establishment and functioning of the Translation and Conference Interpreting Department for a few years until 1996.
- Participation in a TEMPUS-funded JEP (Joint European Project), focusing predominantly on Translation and Conference Interpreting with the participation of University of Westminster and Paris IV University, 2003-2006.
- Introducing and developing the curricula for the Translation and Conference Interpreting track prior to the implementation of the Bologna Process, four-year Undergraduate Diploma Degree, *a combined curriculum of two-year common-core subjects followed by two-year mixed curriculum of common-core and vocational training subjects in collaboration with the University of Westminster, UK* (1998-2008).
- Restructuring the curricula for the Bachelor's degree in Translation and Conference Interpreting following the implementation of the Bologna Process, three-year Undergraduate Diploma Degree, *a combined curriculum of one-year common-core modules followed by two-year mixed curriculum of common-core and vocational training modules in collaboration with the University of Westminster*, (2005- 2010).⁵
- Restructuring the curricula for the Bachelor's Degree in Translation and Conference Interpreting following the implementation of the Bologna Process, three-year Undergraduate Diploma Degree, *a combined curriculum of two-year common-core modules followed by one-year vocational training modules proper only*, (2008- onwards).⁶
- Introducing and developing the curricula for the *research-based Master's Degree and Doctoral Degree in Translation Studies*, 2003, which has substantially contributed to training the then junior staff of our faculty involved in teaching the vocation-based Translation and Conference Interpreting modules, and the then junior staff of the regional universities teaching translation for instructional purposes.

⁵ Basically, the common-core subjects under the four-year undergraduate diploma degree, prior to the implementation of the Bologna Process, were packed into the modules developed under the three-year undergraduate Bachelor's degree diploma introduced, following the implementation of the Bologna Process. The translation and conference interpreting modules were preserved intact and the modular model was originally introduced.

⁶ The common-core subjects under the three-year undergraduate Bachelor degree diploma, pursuant to the Bologna Process, are taught during the first two academic years to be followed by one year of vocation-based translation and conference interpreting modules proper.

- Introducing and developing the curricula for the *vocation-based Master’s Degree in Translation and Conference Interpreting*, within the context of the programme for the post-graduate second level diploma, 2008.
- Restructuring and further developing the curricula for the taught course of *Master’s Degree in Translation and Conference Interpreting*, within the context of the programme for the post-graduate diploma, in collaboration with Université de Strasbourg, ITIRI (Institut de Traducteurs, d’Interprètes et de Relations Internationales), 2016-onwards.
- Introducing, as from 2017, the *60 ECTS Specialised and vocation-based Translation Master Program*. Its scope and duration correspond to 60 credits, under the European Credit Transfer System (ECTS) and takes a maximum of 1 year to complete.
- Supporting and working jointly with the Greek Department, Faculty of Foreign Languages, Tirana University, in introducing and further developing the curricula for the taught course of *Bachelor Degree in Translation and Conference Interpreting, Greek-English-Albanian*, in collaboration with the Department of Foreign Languages, Translation and Interpreting (DFLTI), Ionian University, Corfu, Greece, 2021- onwards.

2. MSc. COURSE IN TRANSLATION AND CONFERENCE INTERPRETING

The accession of Albania to the Bologna process presupposed its integration to the European Higher Education Area. Among the several components of a successful transition, two of them, respectively reforming the structure and reforming the content of the vocation-based training for the translators and conference interpreters in Albania have been singled out. In view of the fact that the training of translators and conference interpreters has become a challenging pedagogical prospect, considering that “translation competence is most effectively developed at an academic institution”⁷, apart from switching to the two-tier

⁷ SCHÄFFNER, C. & ADAB, B. (Eds.). (2000), *Developing Translation Competence*, p.x, Amsterdam

system Bachelor-Master in vocational training proper for translators and conference interpreters, and developing sufficient educational programmes, which could meet the requirements of the contemporary Albanian and international market, one of the most painful steps, especially in the earlier stages of curriculum development for the undergraduate degree, as highlighted later by international experts in translator and conference interpreter training, was to make the institution management aware of the imperative need to introduce the translation and conference interpreting program at the undergraduate level, and the changing attitudes in translation and conference interpreter training with respect to combining educational and vocational ingredients in order better to meet real-life criteria⁸, hence gradually making possible for the clear-cut distinction between T&I institutions and programs, and modern language and philology faculties, as described by Snell-Hornby (1988:8), Klein-Braley (1996), Klein-Braley and Franklin (1998), and quoted by Ulrych (2005)⁹ to disappear.

Within the framework of the Bologna Process, in view of the practical and academic experience acquired, as well as the translation and conference interpreter training capacities available, as from October 2008, the Faculty of Foreign Languages introduced a second-level postgraduate diploma programme in Translation and Conference Interpreting. Further, in this context, we would like to share our experience in developing a Master's Degree Programme in Translation and Conference Interpreting at the Tirana University, Faculty of Foreign Languages, in tandem with all the other language departments, introduced in 2008, relying on the curricula developed and implemented in the other European Translation and Conference Interpretation Training Institutions.

Considering the Albanian market needs and the post-graduate students' needs, the Faculty of Foreign Languages introduced a joint course equally majoring in Translation and Conference Interpreting.

and Philadelphia: John Benjamins.

⁸ ULRYCH, M: *Training translators, programmes, curricula, practices*, published in "Training for the New Millennium Pedagogies for translation and interpreting Edited by MARTHA TENNENT, John Benjamins Publishing Company, 2005, Amsterdam/Philadelphia, 5.

⁹ ULRYCH, M: *Training translators, programmes, curricula, practices*, published in "Training for the New Millennium Pedagogies for translation and interpreting Edited by MARTHA TENNENT, John Benjamins Publishing Company, 2005, Amsterdam/Philadelphia, 5.

The scope and duration of the programme corresponds to 120 credits, under the European Credit Transfer System (ECTS) and takes a maximum of 2 years to complete. As envisaged in similar translation and conference interpretation training programmes, it focuses primarily on the translation and conference interpreting components of training, not on the language skills and language acquisition components, which have already been mastered in the other Bachelor’s Degree programs, hence introducing the two-tier system of translation and conference interpreter vocational training.

- a. *The main objective of the second cycle post-graduate programme in the Translation and Conference Interpreting two-year program, as stated in the relevant documentation and other programmes¹⁰, is associated with training qualified professional translators and interpreters mastering the entire range of the basic skills required of a professional translator, who are capable of carrying out demanding translation and translation-related tasks and of acting responsibly as members of their profession.*
- b. *Cultural and professional background of the students at the end of the programme.* The curricula leads the students to the range of personal and interpersonal competences that can be used freely in the field of exchange between countries and peoples, whose languages have been selected, between international organizations in the field of pragmatic, technical-scientific and literary translation.
- c. *Knowledge and competences characterizing the course of study include:*
 - high proficiency of English and Albanian, and mastery of a third foreign language at an advanced level;
 - in-depth knowledge of the principles and techniques of translation and interpreting, of the cultures and institutions that are related to the languages selected, as well as the basic disciplines of social, economic and legal sciences.
 - further upgraded expertise focusing specifically on the internal and external labour market-oriented issues.
 - computer literacy and ability in using audio-visual devices in the fields of specific competences;

¹⁰ European Commission, Directorate-General for Translation, The Director-General, *European Master’s in Translation (EMT)*, European Commission, Directorate-General for Interpretation, The Director-General, *European Master’s in Conference Interpreting (EMCI)*.

d. *Employment opportunities*

- Future graduates could be employed as translators and/or interpreters in the public and private institutions;
- Future graduates could be employed in international organizations, foreign and domestic associations as operators and mediators of the relations between our country and other countries. They could also serve in the public administration, various non-profit organizations, local entities etc;
- Future graduates could be employed by various print and electronic media, publishing houses, where they can be involved in translating works or essays having literary, publicity technical, socio-economic, informational, literary content etc;
- Future graduates could also be employed in the various organizations operating in the field of cultural cooperation through utilizing the background, abilities and their capacities as translators and/or interpreters;

Later, as from 2016, the curricula for the taught course of *Master's Degree in Translation and Conference Interpreting*, within the context of the programme for the post-graduate second level diploma, was restructured and further developed in collaboration with Université de Strasbourg, ITIRI (Institut de Traducteurs, d'Interprètes et de Relations Internationales), 2016- onwards.

3. INTRODUCING AND DEVELOPING THE 60 ECTS SPECIALISED AND VOCATION-BASED TRANSLATION MASTER PROGRAM (2017 – onwards)

Considering the labour market needs, the students' needs, and the experience already acquired, the Department of English, Faculty of Foreign Languages, introduced and has been offering, as from 2017, the *60 ECTS Specialised and vocation-based Translation Master Program*. Its scope and duration correspond to 60 credits, under the European Credit Transfer System (ECTS) and takes a maximum of 1 year to complete.

As envisaged in similar translation training programmes, it focuses primarily on the pragmatic and specialised translation component

of the training, not the language skills and language acquisition components, which have already been mastered in the other Bachelor’s Degree programs.

A. The main objective of the 60 ECTS Specialised Translation Master Program, as stated in the relevant documentation and other programmes, is associated with training qualified professional translators introduced to the entire range of skills required of a professional translator, capable of carrying out translation and translation-related tasks, trained as professional translators for specialised and pragmatic translation tasks.

B. Cultural and professional background of the students at the end of the programme. The curricula will lead the students to the range of personal and interpersonal competences that can be used adequately in the field of pragmatic and specialised translation.

C. Knowledge and competences characterizing the course of study include:

- proficiency of English and Albanian language and culture;
- in-depth knowledge of the principles and techniques of translation and interpreting, the cultures and institutions related to the languages selected;
- further upgraded expertise focusing specifically on the local, national and international labour market-oriented issues;
- computer literacy and ability;

D. Employment opportunities:

- Our graduates have been employed as translators in the public and private institutions;
- Future graduates could be employed in international organizations, foreign and domestic associations, as linguistic and cultural mediators;
- They could also serve in the public administration, various non-profit organizations, local entities etc;
- Future graduates could be employed by various print and electronic media, publishing houses, travel agencies, etc., possibly later starting their own business;
- Future graduates are employed in the various organizations operating in the field of cultural cooperation through utilizing the background, abilities and the their capacities as translators;

4. FUTURE ACTION

- Improving and consolidating vocation-based instructional performance of the undergraduate and graduate programmes in translation and conference interpreting.
- Providing more training opportunities for the undergraduate and graduate students of translation and conference interpreting.
- Further supporting research initiatives and projects in Translation and Interpreting Studies.
- Supporting the Ph. D. candidates of the English Department in their research initiatives and projects.
- Introducing the quality insurance and management schemes in translation and conference interpreting.
- Establishing the national and regional network of Translation and Interpretation Studies.
- Establishing the regional network of the translation and conference interpreter training higher education institutions.
- Initiating the publication of the Journal on Translation Studies.
- Further marketing the Specialized Translation and Vocation-based Master Program, eventually working jointly with the local academic and senior management staff to introduce it to the Sarande Affiliated Branch of Tirana University.

BIBLIOGRAPHY

BROWN, J. D. (1995), *"The elements of language curriculum: A systematic Approach to Program Development"*. Boston: Heinle and Heinle.

European Commission, Directorate-General for Interpretation, The Director-General, *European Master's in Conference Interpreting (EMCI)*.

European Commission, Directorate-General for Translation, The Director-General, *European Master's in Translation (EMT)*

European Commission, Directorate-General for Translation, *Translating for Multilingual Community*

Information Package for the Faculty of Foreign Languages, Tirana University, Tirana 2002, prepared by Z.TOPI, V.RISTANI, N.VARFI, K.DIBRA, M.MATO, M.MANÇE, B.TABAKU, translated by V.RISTANI.

SI TA BËJMË TRASHËGIMINË TONË KULTURORE TË FLASË? – KREATIVITET
DHE NDËRMJETËSIM NË NJOHJEN E TRASHËGIMISË KULTURORE”

Information Package for the Faculty of Foreign Languages, Tirana University, Tirana, Curricula according to the Bologna Process, Tirana 2005, prepared by K. DIBRA, N.VARFI, V.RISTANI, R.LILO, M.MATO, XH.ZYKAJ.

KLEIN-BRALEY, C. & FRANKLIN, P. (1998), *“The foreigner in the refrigerator’.* *Remarks about teaching translation to university students of foreign languages”.*

KLEIN-BRALEY, C. (1996), *“Teaching translation, a brief for the future”.* In P. SEWELL & J.HIGGINS (Eds.), *Teaching Translation in Universities: Present and Future Perspectives*, London: AFLS-CILT, 15–29.

“Law on Higher Education in the Republic of Albania” 8461, dated 25.02.1999

“Law on Higher Education in the Republic of Albania” no.9741, dated 21.05.2007.

“Law on Higher Education in the Republic of Albania” no.80/2015, dated 22.07.2015.

RISTANI, V. (2009), *“Researching and assessing the translation and conference interpreting services and the training capacities in Albania”*, presentation delivered at the International Conference “Across English language and culture”,

SCHÄFFNER, C. & ADAB, B. (Eds.). (2000), *Developing Translation Competence*, p.x Amsterdam and Philadelphia: John Benjamins.

Terms of Reference: Strengthening the Ministry of European Integration, Albania, EUROPEAID/123003/C/SER/AL, May 2007.

ULRYCH, M: *Training translators, programmes, curricula, practices*, published in *“Training for the New Millennium Pedagogies for translation and interpreting* Edited by Martha Tennent, John Benjamins Publishing Company, 2005, Amsterdam/Philadelphia, 5.

PËRCJELLJA E TRASHËGIMISË KULTURORE PËRMES LETËRSISË DHE LETËRSIA SI TRASHËGIMI KULTURORE

Dr. MARSELA LIKAJ

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Universiteti i Tiranës

marsela.likaj@unitir.edu.al

Msc. ARGIDA SHIJAKU

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Universiteti i Tiranës

argida.shijaku@unitir.edu.al

Abstract

This paper aims to address the interactive relationship between literature and cultural heritage. Literature is seen as a means of transmitting cultural heritage to other languages and cultures, but on the other hand, in its role as a “site of memory”, it provides evidence of everyday life and thus a glimpse into a certain social reality. Literature as a “site of memory” offers the possibility, as with a memorial, to return to a place and address a theme. Like a place of remembrance, literature can open up new perspectives and highlight details. Literature cannot replace a “site visit”, but it can bring places to life, make them come alive and, through its ability to create images, impress thoughts that are unforgettable. “Literature as a *site of memory*” is created in very different biographical backgrounds. “Chronicle in stone” (Kadare), “Confessions of Lost Places” (Besa Muftiu), “The Eternal Life of the Albanians” (Ornela Vorpsi) are used here as example texts, which from different perspectives, offer “site of memory”.

Keywords: cultural heritage, place of memory, literature.

Letërsia mund të shërbejë si një “vend kujtese”. Sipas Nora-s, “vend kujtese” është çdo entitet domethënës, qoftë ky i një natyre materiale apo jomateriale, i cili për shkak të vullnetit njerëzor ose kohës është bërë një element simbolik i trashëgimisë përkujtimore të një komuniteti¹. Në këtë këndvështrim, tekstet autobiografike letrare ofrojnë elemente, të cilat shërbejnë si dëshmi për jetën e përditshme në një periudhë të caktuar kohore në një realitet të caktuar shoqëror.

Kush i krijon “vendet e kujtesës”? Të mbijetuarit, historianët, artistët, shkrimtarët. Nëse i referohemi këtyre të fundit, në tekstet e tyre ata fokusohen në kohë, vende dhe njerëz të veçantë. Autori zgjedh motivet, njerëzit, gjuhën dhe formën e tekstit. Ai gjithashtu ofron një perspektivë të caktuar dhe ka një synim. Lexuesi, që nuk ka qenë më parë në një vend të caktuar, duhet ta përfytyrojë atë vend në mendjen e tij jonë planin konkret, por më tepër për të kuptuar atë që ndodh.

Letërsia, si një “vend kujtese”, ofron mundësinë që t’i rikthehesh një vendi, jo gjeografikisht por literalisht. Ashtu si një vend gjeografik, apo si një memorial, letërsia mund të hapë perspektiva të reja dhe të nxjerrë në pah detaje. Letërsia nuk mund të zëvendësojë një “vizitë në vend”, por ajo mund t’i mbushë vendet me jetë, t’i bëjë ato të gjallërohen. Për shkak të aftësisë së saj për të krijuar imazhe, ajo është në gjendje të ngulitë mendime apo të krijojë përfytyrime e përjetime që mbeten të paharrueshme.

Letërsia krijohet në sfone biografike shumë të ndryshme, kështu që edhe tekstet e marra në shqyrtim në këtë studim lexohen në kontekste të ndryshme. Le të marrim si pikënisje qytetin dhe shkrimin letrar për qytetin. Në mënyrë analoge me një koncept urban, mund të flasim për imazhin e një qyteti që përcjell letërsia artistike apo letërsia e udhëtimeve.

Për shembull “**Kronikë në gur**” e shkrimtarit Ismail Kadare vjen si një “monument letrar” për qytetin antik në jug të Shqipërisë, Gjirokastrën. Në këtë vepër ndërthuren mrekullisht historia botërore, mitet e vjetra dhe perceptimi femënor, të gjitha këto të vendosura së bashku në një qytet të caktuar dhe në një periudhë kohore të caktuar që përbëjnë edhe bazamentin real të veprës.

¹ Koncepti vjen nga Pierre Nora, “Between Memory and History: Les Lieux de Mémoire”, Spring 1989.

Imazhi i një qyteti krijohet përgjithësisht si rezultat i studimit afatgjatë të një morie elementësh dhe marrëdhënieve të tyre, mbi bazën e të cilave realizojmë një tablo komplekse të qytetit. Marrja parasysh e këtyre elementeve është e një rëndësie të madhe, veçanërisht për autorin, i cili përpiqet të krijojë një paraqitje vizuale sa më cilësore e gati ideale të vendbanimeve.

Me interes të veçantë për studimin tonë janë ato fragmente nga teksti letrar, të cilat, nëpërmjet përshkrimit të qytetit, kontribuojnë në një karakterizim të banorëve të qytetit dhe ndihmojnë në zbulimin e jetës së tyre vetjake në jetën komunitare. Duke 'ndërruar' perspektivën, përshkrimi i qytetit është në gjendje të identifikojë vëzhguesin dhe t'i bëjë ndjenjat dhe mendimet e tij të lexueshme në mënyrë figurative.

Megjithëse perceptimi i një qyteti përcaktohet nga një sërë faktorësh subjektivë, imazhi i krijuar dëshmon edhe një shkallë të caktuar objektiviteti. Autori harton për lexuesin një lloj katalogu dukurish, me informacion të detajuar për kushtet klimaterike, mënyrën e jetesës së popullsisë, karakterin e tyre, mënyrën se si e trajtojnë historinë etj. Forma narrative e lejon vëzhguesin të ndërveprojë me objektin e vëzhguar, në këtë rast me qytetin.

Qyteti në romanin "Kronikë në gur" është një qytet i vogël, i çuditshëm, i pjerrët, i gurtë, përrallor që nuk ngjan me asnjë tjetër. Ismail Kadare e përshkruan në këtë mënyrë:

"Ishte një qytet i çuditshëm që dukej sikur ishte shfaqur befas në luginë një natë dimri si një qenie e lashtë, dhe më pas, duke u përpjekur të ngjitej lart, u ngul në shpatin e malit. Gjithçka në këtë qytet ishte e vjetër dhe prej guri, rrugët dhe burimet si dhe çatitë e shtëpive të tij të fuqishme shekullore, të cilat ishin të mbuluara me pllaka guri gri që dukeshin si luspa të mëdha."

Autori tregon historinë e vendlindjes së tij, Gjirokastrës, duke përshkruar elementet tipike të qytetit, si shtëpitë, rrugët prej kalldrëmi, kështjellën, sheshin qendror, xhaminë, tregun, etj. Qyteti shtrihet në një kodër me rrugë të pjerrëta dhe kështjella qëndron si një kurorë në majë. Edhe përshkrimi i këtij qyteti është magjik. "Ky është një qytet i gurtë" ku përcaktimi "i gurtë" nuk flet vetëm për materialin, por flet simbolikisht edhe për historinë dhe qëndrueshmërinë e qytetit. Ai krahasohet me një krijesë të çuditshme. Metaforikisht, jeta në këtë

qytet gjallon brenda guaskës së gurtë, edhe pse nga jashtë duket e paimagjinueshme. Nga këndvështrimi i një djali të vogël tregohet përditshmëria normale dhe bashkëjetesa në një familje të madhe. Me personazhin kryesor zbulohen dimensione të ndryshme të qytetit. Me të drejtë kritiku Enzensberger e cilëson paraqitjen e qytetit në këtë vepër si të stilizuar mjeshtërisht, ku individualizmi i rafinuar ndërthuret me përgjithësimin, duke krijuar një botë poetike që del edhe përtej emërtimeve lokale (krahaso: Enzensberger: 1988).

“Ky ishte një qytet i pjerrët, ndoshta më i pjerrëti në botë, që i kishte thyer të gjitha ligjet e arkitekturës dhe të urbanistikës. Nga shkaku i pjerrësisë së madhe ndodhte që në nivelin e çatisë së njëres shtëpi gjendeshin themelet e tjetrës, dhe me siguri ky ishte i vetmi vend në botë ku njeriu, po të rrëzohej në anë të rrugës, në vend që të binte në hendek, mund të binte mbi çatinë e ndonjë shtëpie të lartë. Këtë gjë më mirë se kushdo e dinin pijanecët. Ishte me të vërtetë një qytet shumë i çuditshëm. Ti mund të ecje rrugës dhe po të doje, mund të zgjatje pak krahun dhe ta vije kapelën tënde mbi majën e një minareje. Shumë gjëra këtu ishin të pabesueshme dhe shumë gjëra ishin si në ëndrra.”²

Shembulli i mësipërm fokusohet në mënyrën se si është ndërtuar qyteti në shpat mali që, sipas Myftarajt, argumentohet me faktin që gjirokastritët ishin rebelë ndaj pushtuesve osmanë dhe donin të mbroheshin nga ndëshkimi në rast rebelimi³. Teksti lë kështu një dëshmi të shkruar për këtë qytezë, si në lidhje me arkitekturën e qytetit ashtu edhe me faktet historike që e kanë formësuar. Autori e lë procesin e përshkrimit të hapur, në mënyrë që të mundësohet edhe imagjinata individuale e lexuesit. Imazhi i qytetit krijon njëfarë magjepsjeje. Ai krijon një tablo imagjinare të qytetit jo vetëm përmes gjuhës figurative, por më tepër për shkak të shembujve të zgjedhur mbi bazën e të cilave ndërton metaforat, duke theksuar një elemente krejt të veçanta në arkitekturën e këtij qyteti. Ky lloj stilizimi e nxit imagjinatën dhe kuriozitetin e lexuesit në mënyrë të jashtëzakonshme, duke e kthyer tekstin në një referencë gjeografike të dëshiruar për t’u

² Ismail Kadare: «Kronikë në gur», «Naim Frashëri», Tiranë, 1978, fq. 3-4.

³ Myftaraj K. (2008), Gjyqi intelektual i Kadaresë, cit. Shkupi press, dt. 23 nëntor 2012.

vizituar. Ky është një fragment, i cili është kthyer në simbol të qytetit dhe citohet edhe në udhëzuesit turistike për Shqipërinë të shkruar nga të huajt.

“Ismail Kadare, shkrimtari më i rëndësishëm bashkëkohor shqiptar dhe i përmendur vazhdimisht si kandidat për çmimin Nobel, vjen nga peizazhi i thyer në jug të vendit. Ai lindi në Gjirokastrë, një qytet prej guri, i kapur pas shkëmbinjsh pothuajse vertikalë. Çdo shtëpi duket si një kështjellë më vete, me mure të trasha dhe çati të rënda të bëra me gurë me shtresa, shpesh me një oborr dhe cisternën e vet. Mbi to ngrihet një kështjellë madhështore shkëmbore, një fortesë kolosale që dominon luginën e madhe të lumit të Drinos dhe shpatet përballë maleve⁴” (përkthim i autores së artikullit).

Kur arkitektët, filozofët apo historianët e kulturës flasin për zhvillimin e vendbanimeve urbane sot, shpesh dëgjojmë që qyteti të humbasë fytyrën e tij apo edhe të zhduket. Përcaktime të tilla dhe të ngjashme përpiqen të pasqyrojnë në mënyrë kritike ndryshimin aktual dinamik të qytetit. Jo rrallë, ndryshimet urbanistike dhe arkitektoore shoqërohen me dëme të pariparueshme apo me ndërprerjen e vazhdimësisë historike. Një konstatim i tillë, shpesh, ka qenë i dhimbshëm për banorët e qyteteve evropiane në shekullin e 20-të. Një gjë e ngjashme mund të thuhet edhe për pjesën e re të qytetit të Gjirokastrës, ndonëse pjesa e vjetër, ajo që Kadareja e përshkruan mjeshhtërisht, po e ruan funksionin e ruajtjes së trashëgimisë kulturore.

“Në pjesën veriore të lagjes kalonte rruga e kalasë, që lidhte lagjet e sipërme të qytetit me qendrën. Rruga ishte shumë lart në krahasim me nivelin e çatisë së dy shtëpive të vetme të lagjes dhe njëherë një kamion që u rrëzua, dëmtoi rëndë hajatin e shtëpisë së babazotit. Nganjëherë qëllonte që rrëzohej ndonjë i pirë dhe çatia pikonte një javë rresht⁵” – përshkruan Kadare.

Nëse, sot, qyteti ka pësuar ndryshime dhe nëse aty ku dikur qëndronin vetëm ato dy shtëpi gjenden tashmë disa të tilla, apo edhe plot ndërtesa të tjera, atëherë fytyra e vjetër e qytetit ka mbetur e fiksuar

⁴ FAZ dt. 28.03.2008.

⁵ Ismail Kadare: «Kronikë në gur», «Naim Frashëri», Tiranë, 1978.

në faqet e këtij libri. Për shumë njerëz që e kanë përjetuar qytetin siç e përshkruan Kadare, vetë romani do të shërbejë si një “vend kujtese”, duke përcjellë një pjesë të trashëgimisë sonë kulturore. Me librin si “vend kujtese, imazhi i vjetër i një qyteti nuk humbet. Dhe cilido që dëshiron t’u tregojë fëmijëve apo pasardhësve për të shkuarën, mund të përdorë librin për të ilustruar shumë mirë historinë e vet.

Duke iu kthyer Nora-s, “entiteti qytet”, pra Gjirokastra në veprën “Kronikë në gur” do të ishte një element i një natyre “materiale”, i cili merr funksionin e “vendit të kujtesës”. Si element të një natyre “jo materiale” do të marrim “jetën nën diktaturën e komunizmit në Shqipëri” të trajtuar në dy vepra me tematikë të ngjashme, “Rrëfime nga vendet e harruara” e autores Besa Myftiu dhe “Vendi ku nuk vdiset kurrë” e autores Ornella Vorpsi.

Nëse do të bëjmë një analizë të tipologjisë së tematikave në veprat e shkruara pas viteve nëntëdhjetë do të identifikonim kthimin në vitet e fëmijërisë tek një sërë autorësh. Këtu spikatin edhe dy romanet e lartpërmendura. Këto vepra kanë të njëjtën sfond kohor, vitet e regjimit të Enver Hoxhës, sikurse edhe ngjarjet zhvillohen në të njëjtin vend gjeografik, në qytetin e Tiranës. Të dyja këto romane kanë elemente autobiografike. Shkrimtarja Besa Myftiu eksploron “vendet e harruara” të fëmijërisë së saj duke i kthyer përmes letërsisë në vende kujtese. Autorja përshkruan botën e zhdukur të fëmijërisë së saj në vitet 1960 dhe 1970. Vajza rritet në një lagje në Tiranë, ku jeton me familjen, fqinjët dhe miqtë e saj dhe vëzhgon me detaje gjithçka përreth. Nga këndvështrimi i një vajze të vogël, si alter egoja e saj, autorja tregon për familjen, anëtarët e së cilës zhvillojnë strategjitë e tyre përballë represionit shtetëror të regjimit të kohës. Koha, regjimi, ngjarjet kanë lënë gjurmë të thella tek njerëzit sikurse edhe tek qyteti.

“SHTËPIA IME ka vendosur të vrasë veten. E lumtur në kohën e mbretit Zog, guximtare gjatë Luftës Nacional-Çlirimtare, optimiste në periudhën e komunizmit, ajo është zhytur në melankoli të thellë që prej dhjetë vjetësh. Në fillim i morën një copë të vogël nga kopshti për të ndërtuar një dhomëz ku do të vendoseshin dy makinat e shtypshkronjës së tim vëllai. U desh të pritej fiku gjethegjërë... Mbi trungun e tij të rrafshuar, muratorët vendosën pllakat ngjyrë gri të dyshemesë. Nga dritaret e katit të parë Shtëpia vështronte me hidhërim këtë përzgjatje

të shëmtuar të saj, bërë prej betoni me cilësi të ulët; në netët me shi, lot të mëdhenj i rrëshqisnin përgjatë fasadës.⁶

Nëse do të analizonim fragmentin e mësipërm, fokusi i autores është i ndarë midis “materiales”, që në këtë rast do të ishte shtëpia, dhe “jo materiales”, që përfshin ndryshimet në planin historik, ekonomik dhe social që ka pësuar shoqëria shqiptare përgjatë shekullit të njëzetë. Për sa i përket entitetit “qytet” evidentohen ndryshime urbane që do të përshkruheshin si ngushtim i hapësirës së gjelbër, betonizim i qytetit etj., elemente këto që përcillen jo pozitivisht në shoqëri. Nëse do të flisnim për trashëgiminë kulturore, më tepër se sa në planin material ato evidentohen në planin historik dhe social. Në këtë kuptim, “lumturia” në kohën e mbretit Zog, “guximi” i shfaqur gjatë Luftës Nacional-Çlirimtare, optimizmi në periudhën e komunizmit dhe melankolia në periudhën kaotike të ndërrimit të sistemit do të shërbenin si entitete “jo materiale” që do ta shënjonin këtë roman si “vend kujtese”.

“Shqipëria është vendi ku askush nuk vdes”, kështu fillon romani i Ornela Vorpsit, i cili tregon për vendin ndoshta më ekzotik në Evropë në atë kohë, mbushur me bunkerë dhe me një parti që kontrollonte gjithçka dhe këdo. Koha duket sikur ka ndalur për më shumë se gjysmë shekulli. Me një perspektivë krejt origjinale Vorpsi kërkon të memorizojë në fjalën e shkruar fëmijërinë e tyre dhe jetën nën regjimin totalitar. Jo gjithçka që përshkruajnë këta autorë e kanë përjetuar vetë, por gjithçka ka ndodhur realisht, siç thekson Ornela Vorpsi në intervistën e dhënë për ORF1:

“Thjesht doja të tregoja përditshmërinë e një shqiptari që jetonte në shtetin totalitar të Enver Hoxhës. Deri vonë, letërsinë në Shqipëri e bënin vetëm njerëz të mbrojtur nga partia. Njerëzit e dënuar nuk kishin zë në këtë vend dhe unë isha një person i tillë”.

Duke ndërthurur mjeshtërisht zhgënjimin dhe talljen, secila prej këtyre autoreve evokon një botë të vetën, atë të një shtëpie, të një familjeje, të një rruge dhe të banorëve të saj në Shqipërinë e Enver Hoxhës, ku urrejtja dhe dashuria janë shumë pranë njëra-tjetrës.

⁶ Myftiu B. (2010) Rrëfime nga vendet e haruara, kreu 3, Duda, Tiranë.

⁷ ORF 1, Eine Kindheit im Hoxha-Regime, dt. 08.04.2017.

Përmes autobiografive të tyre, ato sjellin njëkohësisht tablo të jetës së përditshme në diktaturë. Kjo nuk është vetëm bota e secilës prej tyre, por e gjithë shoqërisë shqiptare të atyre viteve, prandaj me të drejtë kritika ndërkombëtare i ka shoqëruar botimet e këtyre romaneve në gjuhë të huaja me tituj si *Përditshmëria në diktaturën shqiptare*⁸ apo *Një fëmijëri në regjimin e Hoxhës*⁹.

Është interesant fakti që përshkrimet e Myftiut dhe Vorpsit vijnë nga pozita të një distancimi jo vetëm kohor por edhe vendor e gjuhësor. Të dyja autorët i kthehen fëmijërisë në Tiranën e viteve të komunizmit pas më shumë se një dekade, e shkruajnë veprën në periudhën kur janë në mërgim dhe gjuha në të cilën e shkruajnë nuk është gjuha e nënës, por gjuha e vendit ku kanë mërguar. Kjo do të kërkonte një analizë më të thelluar, gjithsesi relevant për ne është fakti që këto vepra qëndrojnë si “vende kujtese” ku ne shohim vetveten, të huajt mësojnë më shumë rreth nesh, ndërsa të rinjtë gjejnë të rrëfyer me një gjuhë të lehtë e të këndshme histori të një epoke të hidhur të vendit të tyre.

BIBLIOGRAFIA

Referime artikujsh

- Nora P. (1989), *Between Memory and History: Les Lieux de Mémoire* në No. 26, Special Issue: Memory and Counter-Memory (Spring, 1989), f. 7-24.
- *Frankfurter Allgemeine Zeitung*, dt. 28.03.2008.
- Enzensberger U. (1988), *Vaterland und Heldenmut* në *Die Zeit* dt. 18.11.1988.
- Myftaraj K. (2008), *Gjyqi intelektual i Kadaresë*, cit. Shkupi press, dt. 23 nëntor 2012.
- Magenau J. (2022) *Alltag in der albanischen Diktatur* në Deutschlandfunk Kultur dt. 14.06.2022.
- ORF 1, *Eine Kindheit im Hoxha-Regime*, dt. 08.04.2017.

Referime librash

Kadare I. (1978) *Kronikë në gur*, Naim Frashëri, Tiranë.
Kadare I. (1999) *Chronik in Stein*, dtv, München.
Myftiu B. (2010) *Rrëfime nga vendet e harruara*, Dudaj, Tiranë.
Myftiu B. (2007) *Confessions des lieux disparus*, L’aube, Paris.
Vorpsi O. (2007) *“Das ewige Leben der Albaner”*, Zsolnay Verlag, Wien.

⁸ Magenau J. (2022) *Alltag in der albanischen Diktatur* në Deutschlandfunk Kultur dt. 14.06.2022.

⁹ ORF 1, *Eine Kindheit im Hoxha-Regime*, dt. 08.04.2017.

POTENCIALI I HAPËSIRËS GJEOGRAFIKE SHQIPTARE PËR INTEGRIM NË ITINERARET KULTURORE TË KËSHILLIT TË EVROPËS

Prof. asoc. Dr. ROMEO HANXHARI

Fakulteti i i Historisë dhe i Filologjisë
Universiteti i Tiranës
romeo.hanxhari@Af.edu.al

Prof. Dr. SOKOL AXHEMI

Fakulteti i i Historisë dhe i Filologjisë
Universiteti i Tiranës
sokol.axhemi@Af.edu.al

Abstract

The Cultural Routes of the Council of Europe have been launched by the Council of Europe in 1987, and they demonstrate, “by means of a **journey through space and time**, how the heritage of the **different countries and cultures** of Europe contributes to a **shared and living cultural heritage**”. These routes aim the use of the common European heritage for a sustainable local development. In this paper we will explore the state of art of integration of the Albania’s territory to the Cultural Routes of the Council of Europe. Albania has important potential to be part of at least 9 out of the 48 such cultural routes, but institutional bodies of the country are member, very formally, at only two of them: this is an unacceptable situation. Our study group is undertaking the initiative to lead public local bodies to be recognize the local potential, and to be part of the Cultural Routes of the Council of Europe, which are an excellent tool for marketing. As a methodological parallelism approach, in the paper we also represent our previous proposition for a Literature Thematic Park Kadare’ in Gjirokastra, which can be used as an alternative and creative way of local development.

Keywords: sustainable development, cultural routes, geographical potential, local resources.

Qëllimi kryesor i krijimit të itinerareve kulturore është zhvillimi i qëndrueshëm i territorit. Parakusht për këtë është zbulimi i territorit, eksplorimi i burimeve të tij. Parimi bazë i punës është se “...studiuesit duhet të zbulojnë atë çka territori është, duke përdorur të gjitha lentet që të tjerët i kanë nënvlerësuar deri më tani. Më tej, duke e njohur, në territor ne mundemi dhe duhet të përdorim zgjuarsin dhe kështu të krijojmë zhvillim” (Rullani, 2003).

1. Zhvillimi i qëndrueshëm dhe itineraret kulturore si instrumente zhvillimi lokal

«Zhvillimi i qëndrueshëm» është proces zhvillimor që zbatohet me instrumente të mençura territoriale, një prej të cilave është edhe ai i «itinerareve kulturore». Por «zhvillimi i qëndrueshëm» keqkuptohet, dhe kjo vjen për shkak se ekspertë të fushave të ndryshme i japin përparësi njërit prej komponentëve të atij koncepti: ekonomik, social, mjedisor. Në fakt, konceptimi më i drejtë është mënyra e veprimit që garanton zhvillim ekonomik nëpërmjet mbajtjes së cilësisë së mjedisit dhe nëpërmjet rritjes së mirëqenies së përgjithshme shoqërore. Mënyra më e drejtë e zhvillimit të një territori është përdorimi i kujdesshëm dhe krijues i të gjitha shtresëzimeve fizike dhe humane të një territori, të krijuara gjatë evolucionit të tij gjeografik natyror dhe historik. Në këtë kuadër teorik, “itineraret kulturore” shihen si instrumente të zhvillimit të qëndrueshëm të territorit. Itinerari, virtual ose fizik, është në fakt një program përdorimi që lidh vende të ndryshme dhe shërbime të ndryshme që mund të përfshinin aktorë të ndryshëm, i cili jep impulse të qëndrueshme ndaj zhvillimit lokal kapilar në territor. Zhvillimi lokal kapilar është një mënyrë zhvillimi që e shpërndan përfitimin ekonomik te sa më shumë pjesëtarë të komunitetit të një territori, dhe që siguron kështu ripërtëritjen e vazhdueshme të ofertës së vetë territorit. Në një kuptim metaforik, “territori vazhdon të vetërritet kulturalisht dhe të vetëofrohet ekonomikisht” në një mënyrë të qëndrueshme, në favor të të gjithë komunitetit, natyrisht mbi bazën e kontributit mbi bazë meritokracie. Itineraret kulturore janë një oportunitet për të zhvilluar territorin. Kjo realizohet jo thjesht nëpërmjet promovimit të territorit duke përdorur markën (brand) Evropiane “Itineraret e Këshillit të Evropës”.

2. Baza teorike dhe zbatuese e përdorimit të brandit “Itineraret Kulturore të Këshillit të Evropës”

Territori merr impulse duke përdorur markën (fig. 1) e itinerarit përkatës për të marketuar vlerat e veta. Janë pikërisht këto mënyrat nëpërmjet të cilave në territor shfaqet mençuri, sepse një territor i mençur është ai që shet vetveten dhe burimet e veta duke përdorur emrin e një brandi të konsoliduar.



Fig. 1. Logoja “rrugët e ullirit”, një nga itineraret e Këshillit të Evropës.

Markat e itinerareve të Këshillit të Evropës janë një rrugë e shtruar për të krijuar ekonomi nëpërmjet kreativitetit. Madje, aq e forte është kjo markë (brand) sa që ajo mund të krijojë edhe risi ekonomike. Për shembull, integrimi në itinerarin “rrugët e ullirit” ka krijuar një trend të ri dhe një lloj të ri turizmi: i tillë është termi “turizmi i ullinjve” (fig. 2). Nga ana tjetër, impulset për industrinë e shërbimeve mund të jenë të shumta: produkte turistike, produkte agro-industriale, kulinari, restorante, etj., (fig. 3) me emrin e markës “rrugët e ullinjve” dhe me emërtime simbol që rrjedhin prej këtij itinerari. Baza ekziston, dhe mjafton të përdoret nga ekspertët e strategjive të marketingut dhe prodhimit.

SI TA BËJMË TRASHËGIMINË TONË KULTURORE TË FLASË? – KREATIVITET DHE NDËRMJETËSIM NË NJOHJEN E TRASHËGIMISË KULTURORE”




Fig 2. Mediat e konsiderojnë të lindur llojin e ri të “turizmit të ullinjve” (2022)



Fig. 3: mënyra e përdorimit në Greqi të markës së itinerarit për të krijuar ekonomi lokale

3. Eksplorime të itinerareve kulturore dhe parqeve tematike në Shqipëri

Raste të promovimit mbi bazën e markave të njohura të konsoliduara të marketimit mund të identifikohen shumë edhe në Shqipëri. Në një rast analog studimi për itinerarin “Rrugët e Shkrimtarëve” të Këshillit të Evropës, ne si grup studimor kemi sugjeruar qysh në vitin 2010 krijimin e Parkut Tematik “Kadare” në Gjirokastrë (6). Këtë ide dhe studim po e rielaborojmë edhe aktualisht duke kërkuar edhe mbështetjen e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Të frymëzuara nga Itinerari i Shkrimtarëve i Këshillit të Evropës, dhe nga propozimi ynë për “Parkun Tematik Kadare”, kemi sugjeruar disa marka territoriale ekonomike për të komunikuar potencialin: “Dylbitë e Anesë” si një trupë shoqëruese e turistëve nëpër vendet e rëndësishme të veprës së Kadaresë. “Kafeja e Sokakëve” si një markë kafenesh në Qafën e Pazarit dhe në gjithë qytetin, që pranon të ketë brandin e Itinerarit dhe Parkut Letrar. Marka e restoranteve “Kronikë në ...pjetë”, si një mjedis kulinar që promovon traditën gjirokastrite duke krijuar lidhje marketingu me veprën e Kadaresë.

“Sokaku i të Marrëve” (fig. 4) si një markë teatroshe të vogla në shtëpi apo rrugica karakteristike, të cilat do të performojnë çdo ditë pjesë të veprave të Kadaresë në mjedise urbane tradicionale.

“Bujtina e gjeniut” si një markë e një serie bujtinash të destinuara për të pritur vizitorët dhe për t’i futur plotësisht në atmosferën e veprës letrare dhe famës së saj, gjatë një qëndrimi disa-orësh apo edhe disaditor.



Fig. 4 Sokaku i të marrëve në Gjirokastrë, si toponim i promovuar në veprat e Kadaresë, dhe që për këtë shkak ka bazën që të shndërrohet në një nga markat e territorit.

Situata e Shqipërisë në raport me anëtarësimin formal në itineraret e Këshilli të Evropës s’është aspak e mirë. Shqipëria ka anëtarësim formal vetëm në 2 itinerare, dhe të pakonfirmuar në 3 të tilla. Por, në

çdo rast këto anëtarësime janë pa asnjë feedback për territorin dhe ekonominë lokale. Potenciali i Shqipërisë është që të jetë anëtare në të paktën 9 itinerare. Për të qenë pjesë e Itinerareve të Këshillit të Evropës nuk mjafton vetëm të kesh dëshirën apo idenë për t’u bërë partner, por duhet të kuptosh që ky instrument është një mundësi e jashtëzakonshme për të eksploruar nën një dritë të re territorin, për të komunikuar në një mënyrë të re potencialin e zbuluar, dhe për të zhvilluar territorin. Pra duhet të ndërhysh në territor me investime shumë të vogla por inteligjente, të cilat nxjerrin në pah elementet, duke i lidhur ata me Itinerarin përkatës të Këshillit të Evropës, dhe pra duke i vendosur në kontekst të kulturës së përbashkët Evropiane së cilës i përkasim.

4. Potenciale shqiptare për integrim në “Itineraret kulturore të Këshillit të Evropës”

Nëse shqyrtojmë vetëm disa nga itineraret e Këshilli të Evropës, itinerari “Rrugët e Fenikasve” është itinerari i konceptuar për të risjellë trashëgiminë e përbashkët të lidhur me Fenikasit. Në Shqipëri, anëtarësimi është aq formal dhe qesharak, sa që anëtar i këtij itinerari nuk është as ndonjë bashki, dhe as ndonjë ministri apo universitet, dhe as ndonjë shoqatë biznesi turistik, por është një shkollë 9-vjeçare jo-publike. Kjo është tërësisht joproduktive.

Ndërkohë, potenciali i Shqipërisë për këtë itinerar është interesant. Autorët antikë përmendin që Fenikasit, nëpërmjet gjurmës që më vonë do të quhej Egnatia, erdhën në ndihmë të Enkelejve, vendndodhja e të cilëve është përreth liqenit të Pogradecit. Rrjedhimisht, Bashkia e Pogradecit duhet të ishte bërë pjesë e këtij itinerari të Këshillit të Evropës për të komunikuar më mirë territorin dhe burimet e veta, dhe për ta përdorur këtë markë të gatshme për marketing territorial. Universiteti i Korçës do të duhej të ishte bërë promotor i këtij anëtarësimi dhe të planifikonte/propozonte ndërhyrje në territor në këtë drejtim, por tashmë ne si grup i Universitetit të Tiranës do të bëhemi promotorë.

Po ashtu, si reminishencë e lidhur me praninë e fenikasëve në Ilirinë e Jugut disa autorë e mbajnë edhe emrin e qytetit Foinike të shtetit antik të Epirit, në Delvinë të Shqipërisë së sotme. Rrjedhimisht, Bashkia e Delvinës duhet të ishte bërë pjesë e këtij itinerari të Këshillit

të Evropës për të komunikuar më mirë territorin dhe burimet e veta, dhe për ta përdorur këtë markë të gatshme marketing territorial. Filiali i Universitetit të Tiranës në Sarandë duhej të ishte bërë promotor i këtij anëtarësimi dhe të planifikonte ndërhyrje, por tashmë këtë rol do ta marrim ne si grup kërkimor i Universitetit të Tiranës.

Itinerari Atrium është itinerari i krijuar duke ndjekur gjurmët në territor dhe përjetimet sociale të lidhura me to, të ndërtimeve simbol të diktaturave. Prania në territor nëpërmjet gjurmëve edhe arkitekturore por jo vetëm, në Shqipëri është e shprehur në të gjithë vendin për disa periudha si, periudha e diktaturës fashiste italiane, dhe periudha e diktaturës komuniste. Cilët partnerë do të duhej të ishin pjesë e itinerarit Atrium? Bashkia e Tiranës duhet të ishte partnere me disa itinerare për këto periudha të ndryshme, me qëllimin për të komunikuar më mirë territorin e vet. Bashkia e Kukësit duhet të ishte partner me itinerarin e qytetit të ri të Kukësit dhe me qytetin e vjetër të përmbytur pa rimbursim nga Diktatura komuniste. Bashkia e Sarandës duhet të ishte partner me portin Porto Eda të konceptuar gjatë diktaturës fashiste. Ne si grup kërkimor i Universitetit të Tiranës do të jemi të gatshëm ta luajmë këtë rol nxitës dhe organizues.

Itinerari “Rrugët e Ullirit” është itinerari i konceptuar për të rijetësuar traditën mesdhetare të mënyrës së jetesës të lidhur me kulturën e ullirit. Në këtë itinerar nuk ka asnjë partner shqiptar, dhe kjo është e patolerueshme për këtë traditë të lashtë shqiptare.




Fig. 5. Harta e shtrirjes së kulturës së ullirit në rajonin e Mesdheut, ku territori i Shqipërisë identifikohet si një qendër dytësore e përhapjes drejt Mesdheut perëndimor

Shqipëria sigurisht që është areal, dhe madje cilësohet si “qendër sekondare” e përhapjes së kulturës fillestare të ullirit 6000 vjet më parë drejt Mesdheut perëndimor (fig. 5). Ulliri tek ne nuk është vetëm bujqësi: ulliri është histori, është identitet territorial, është mënyrë jetese, është gastronomi, është turizëm, është zhvillim lokal. Nëse ka nevojë të argumentohet se pse territore dhe institucione të Shqipërisë duhet të bëhen anëtare të këtij itinerari, mund të gjenden shumë argumente, mes të cilave mund të renditen: i) Pema e ullirit asociohet si indikator i mesdhetarizimit, dhe në Shqipëri kultivohet në mbi 40% të territorit, përkatësisht në Ultësirën perëndimore dhe Krahinën Malore Jugore; ii) Në Shqipëri gjenden individë të species së Ullirit ende produktive, që janë datuar si 2500 dhe 3000 vjeçare; iii) Në Shqipëri ka gjurmë ende të paprekura të tarracave tradicionale antike mesdhetare me kulturën e ullirit; iv) Në Shqipëri ne përfetojmë ende rregullin skënderbejan të mbjelljes së 25 pemëve të ullirit si taksë për çdo çift të sapomartuarish.

Si përfundim, mund të thuhet se në Shqipëri ka shumë Bashki/shoqata/dhoma tregtie që mund dhe duhet të ishin pjesë e itinerarit “rrugët e ullirit” të Këshillit të Evropës. Këtë mision tashmë do të ofrohet ta kryejë grupi kërkimor i Universitetit të Tiranës mbi itineraret e Këshillit të Evropës.

BIBLIOGRAFIA

AXHEMI Sokol (2008), Gjeografia Sociale, Tirane 2008

AXHEMI Sokol (2009), “Hapësira socio-gjeografike e qarkut të Shkodrës. Tendenca dhe perspektiva”, Revista “Studime Albanologjike”, 2009, nr. 4

AXHEMI Sokol (2011), “Hapësira socio-gjeografike e Kelmendit në këndvështrimin e zhvillimit të qëndrueshëm”. Revista “Studime Albanologjike” Nr.4, Tirane.

AXHEMI Sokol (2015), “Evolucioni i hapësirës socio-gjeografike të Korçës gjatë periudhës së tranzicionit”. Revista “Buletini i shkencave shoqërore”, Universiteti i Shkodrës, Shkodër

AXHEMI Sokol (2019), “Tendenca të zhvillimit të popullsisë dhe elementeve social të saj në hapësirën ndërkufitare Shqipëri-Mal i Zi”. Revista “Studime Gjeografike” Nr. 22, FHF-UT, Tiranë

HANXHARI Romeo (2009), “Parqet tematike si instrument i valorizimit të territorit. Projekt-ideja për parkun letrar ‘Kadare’”, Revista “Studime

- Albanologjike", f. 490-501, ISBN:978-99943-50-53-7, Sh.B. "Arbëria", Tiranë.
- HANXHARI Romeo (2003) "Emergjenca dhe shinat e një zhvillimi të qëndrueshëm të turizmit në Shqipëri", 2003, "Studime gjeografike nr. 16", Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
- HANXHARI Romeo(2011), "Politikat e mjedisit. Niveli global dhe niveli lokal. Analizë teorike dhe raste studimi", Tiranë, ISBN 978-9928-4045-6-5.
- HANXHARI Romeo (2002) "Tourism sustainability and local realities in Albania", - Internatioal Conference "Sustainable Tourism in Albania: a National Plan for alternative tourism" , July 2002, Botuar në proceedings.
- HANXHARI Romeo (2012), "Environmental sustainability of the religious pilgrimage in Albania", "Sustainable Religious Tourism, Commandments, Obstacles & Challenges", Lecce, Edizioni Esperidi, faqe 55-63. ISBN: 978-88-97895-01-5.
- HANXHARI Romeo (2003), "Sustainable developpment and public participation – Case studies in energy, tourism and protected areas in Albania", International Conference "Environmental Policies , instruments and methodologies", December 2003.
- HANXHARI Romeo; YZEIRI Eqerem (2011) "Burimet e territorit të zonës malore të bregut. Parku Tematik i Valanidhit" dhe "itinerari i Edward Lear" si instrument zhvillimor i saj", Studime Albanologjike, f. 515-533, Tirana.
- HANXHARI Romeo; YZEIRI, Eqerem, (2013) "Zhvillimi i qëndrueshëm` në Shqipëri midis dy konferencave të Rio de Janeiros 1992- 2012: nocioni, strategjitë, veprimet", Studime AlbanologJIKE, F. 40-49, ISBN 2304-3828, Tirana.

Referencat sitografike:

<https://www.coe.int/en/web/cultural-routes>

<https://www.aeneasroute.org/>

<https://www.coe.int/en/web/cultural-routes/the-european-route-of-jewish-heritage>

<https://www.coe.int/en/web/cultural-routes/the-routes-of-the-olive-tree>

<https://www.coe.int/en/web/cultural-routes/atrium-architecture-of-totalitarian-regimes-of-the-20th-century>

NDËRTIMET E FORTIFIKUARA TË LUFTËS SË FTOHTË - POTENCIAL I PEIZAZHIT HISTORIK DHE ATRAKSION TURISTIK

Dr. Mimoza PUTO

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja
Universiteti i Tiranës
.puto@unitir.edu.al

Dr. EDLIRA ÇAUSHI

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja
Universiteti i Tiranës
edlira.caushi@unitir.edu.al

Dr. SILVANA NINI

Qendra e Studimeve dhe
Publikimeve për Arbëreshët
silvana.nini@unitir.edu.al

Prof. Dr. ANASTASI PRODANI

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja
Universiteti i Tiranës
anastasi.prodani@unitir.edu.al

Abstract

This article aims to offer reachable touristic itineraries by classifying and proposing specific areas of Cold War military heritage as cultural landscapes which bear witness of the past history of communist period in Albania. Over the past years, the communist regime built thousands of fortifications to defend itself from an imaginary attack by the imperialist and revisionist enemies which in fact never happened. Most of these structures built of concrete, iron and steel commonly known as bunkers are still part of the natural landscapes, while there are other hundreds of hidden underground tunnels, some of them as antinuclear shelters. These unique relics which some specialists classify as “Cold War military architecture” are huge engineer and construction works and represent at the same time a valuable heritage, related to the history of the communist dictatorship in Albania, which

nowadays need be exploited for touristic purposes. Although many of them were destroyed, a good part of them still exist and are an integral part of terrain they were built on. Many bunkers are covered by the vegetation,

others are engulfed by the sea, some were transformed into garbage dump sites, cereal storage places or farm animal houses, others were used as car repair shops, and others were used as bars and restaurants or even churches. The foreign tourists as well as the specialists of cultural heritage show a great interest for these Works and visits to such sites are a way to learn about the past history enjoying at the same time the natural landscape.

Keywords: military heritage, communism, historical landscape, fortifications, touristic attraction

Shpesh diskutimet lidhur me ndërtimet e fortifikuara të luftës së Sftohtë risjellin për reflektim pyetjen, nëse mund të konsiderohet kjo pjesë e së kaluarës, trashëgimi?

Jemi të ndërgjegjshëm se trashëgimia është përzgjedhje e sendeve dhe mendimeve, e shprehjeve që trashëgojmë dhe që na lidhin me kohët dhe jetët para nesh. Ajo është pjesë madhështore dhe unike e së kaluarës, duke mbartur vlera estetike, kulturore, artistike, arkitektonike, historike apo shpirtërore. Duhet konsideruar fakti që koncepti për trashëgiminë sot është zgjeruar, madje edhe në vendet e dhimbjes dhe traumës. Siç thekson David Lowenthal shkruan “Çdo trashëgimi është e çmuar. Nga [...] Hollivudi deri te Holokausti”¹.

Lowenthal shpjegon se e kaluara mund të na pasurojë dhe varfërojë, dhe njerëzit mund ta përqafojnë ose ta shmangin atë. E kaluara mund të ketë përfitime, por edhe frikë dhe të meta. Ndonjëherë njerëzit mund të ndjejnë nostalgji për fëmijërinë dhe jetën e hershme, në të cilën ata përqafojnë të kaluarën e imagjinuar. Për të tjerë, “për të duruar jetën e tanishme ne mund të duam të harrojmë ose të fshijmë një trashëgimi të keqe ose traumatike. Një trashëgimi e lavdishme gjithashtu mund të pushtojë, epërsia e saj e shuan edhe vullnetin për ta rivalizuar atë”².

Në rastet kur diktatura lë pas mbetjet fizike, a është e mundur që edhe komuniteti ta ndjejë këtë trashëgimi si pjesë të identitetit të tij, diçka për të cilën duhet të jetë përgjegjëse ta ruajë dhe ta përdori si burim?

¹ Lowenthal, D. (1996), *Possessed by the past: the heritage crusade and the spoils of history*, New York: Free Press, f.161

² Lowenthal, D. (1998), *The Heritage Crusade and the Spoils of History*, Cambridge University Press, xiii.

Trashëgimia të cilën po shqyrtojmë, është konsideruar nga specialistët si një trashëgimi e vështirë, duke vlerësuar lidhjen e saj me periudhën komuniste, dhe arsyen e krijimit të saj.

Kujtimi i ngjarjeve traumatike e mban të shkuarën në të tashmen citon Lowenthal. Ai shpjegon se humbja është po aq trashëgimi sa fitorja, sepse “edhe mjerimi krijon lidhje të qëndrueshme”³.

Një alternativë, ose një mënyrë e mos trajtimit të trashëgimisë së vështirë, është thjesht ta injorosh atë, qoftë fizikisht ashtu dhe nga ana shoqërore, duke e lenë të bjerë e të degradojë. Ndodh, që në informacionet dhe në itineraret turistike që ofrohen kjo trashëgimi thjesht injorohet. Interesant është rasti i konceptit të nazistëve për trashëgiminë, ku evidentohet problematika e braktisjes së ndërtesave derisa të shndërrohen në gërmadha, sepse Hitleri dhe Speer kishin shprehur dëshirën që këto tipologji arkitekture, të mbeten në formën e rrënojave romantike. Në atë rast, restaurimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave do të ruante fuqinë e tyre origjinale, që nga ana tjetër, do ishte dhe qëllimi që ka vetë ndërtesa për të komunikuar.

“Të neglizhosh trashëgiminë është një mëkat i rëndë, ta kërkosht atë është një detyrë kombëtare” do të shprehej Lowenthal⁴.

Në publikimin “Places of pain and shame - ballafaqimi me “trashëgiminë e vështirë”⁵ studiues nga disiplina të ndryshme prezantojnë të kaluarat e vështira në vende të ndryshme të botës, analizojnë këto të kaluara dhe duke vlerësuar nëse konsiderohen si trashëgimi që ia vlen të ruhet në mënyra të ndryshme, apo nëse bëjnë pjesë tek ato elemente të së shkuarës që janë harruar qëllimisht⁶.

Kujtimi i ngjarjeve traumatike e mban të shkuarën në të tashmen. Lowenthal shpjegon se humbja është po aq trashëgimi sa fitorja, sepse edhe mjerimi nga ana tjetër krijon lidhje të qëndrueshme”⁷.

³ Lowenthal, D. (1998), *The Heritage Crusade and the Spoils of History*, Cambridge University Press, f.74.

⁴ Lowenthal, D. (1998), *The Heritage Crusade and the Spoils of History*, Cambridge University Press, xiii.

⁵ Logan, W. & Reeves, K. (eds.) (2008) *Places of pain and shame: dealing with "difficult heritage"* Abingdon: Routledge

⁶ Myhrberg K. (2011), *Heritage from the Communist Period in Albania*, University of Gothenburg, f. 1-82.

⁷ Lowenthal, D. (1998), *The Heritage Crusade and the Spoils of History*, Cambridge University Press, f.74.

Sipas Light, në studimin e tij: *An Unwanted Past*, ai shprehet se nuk ka pothuajse asnjë interes për të kujtuar trashëgiminë e socializmit në Rumani dhe për të interpretuar atë për turistët. Vetë Muri i Berlinit, Shtëpia e Popullit në Bukuresht, apo parku i statujave në Budapest janë shembuj të ndërtesave dhe vendeve të lidhura me regjimet e mëparshme të cilat tashmë janë kthyer në atraksione të njohura turistike. Light shkruan se këto lloj tërheqjesh dhe interpretimesh të trashëgimisë komuniste shpesh prezantohen dhe promovohen nga aktorë të huaj por edhe për konsumatorët e huaj, ndërsa vetë vendet ish-komuniste kanë pak ndikim në mënyrën se si interpretohet kjo trashëgimi⁸.

Nga ana tjetër specialistët e Trashëgimisë Kulturore të Norvegjisë shprehen të shqetësuar pasi mbetjet fizike të ndërtimeve të fortifikuara të Luftës së Dytë Botërore dhe Luftës së Ftohtë⁹, janë humbur ose janë në prag të zhdukjes duke çuar në humbjen e njohurive për fushat e betejës ushtarake dhe ideologjike në peizazhet e konfliktit¹⁰.

Po çfarë ndodh me institucionet dhe organizatat në vendet e Europës lidhur me iniciativat që përfshijnë këtë trashëgimi?

ICOMOS (International Council on Monuments and Sites) që është organizata këshillimore e UNESCO-s, prej vitesh ka një komitet shkencor ndërkombëtar që quhet ICOFORT International Scientific Committee on Fortifications and Military Heritage. Këtu përfshihet dhe promovohet trashëgimia ushtarake e të gjitha kohërave, duke përfshirë edhe atë ushtarake të shekullit XX dhe të luftës së ftohtë¹¹.

FORTE CULTURA e.V. (ish European Fortress Tourism and Fortress Marketing Network e.V.) është Rrjeti i Monumenteve të Fortifikuara të shtigjeve kulturore- FORTE CULTURA®. Për herë të parë, shtigjet kulturore- FORTE CULTURA prezanton ofertat e pasura turistike të Monumenteve të Fortifikuara në të gjithë Evropën, duke vendosur fokusin në turizmin kulturor dhe të bazuar në një

⁸ Light, D. (2000), "An unwanted past: Contemporary tourism and the heritage of communism in Romania" në *International Journal of Heritage Studies*, f. 161, 147

⁹ Luciani R. (editor 2018) *Military Heritage from 20th Century, Preservation, Reuse and Management*, Icofort Norway 2018, f.1-134

¹⁰ Hesjedal A. (2018) "From garbage to heritage? Two land defence lines in Arctic Norway: the Lyngen line (WW2) and the Frøy line (Cold War)" në *Military Heritage from 20th Century Preservation, Reuse and Management*, Icofort Norway f. 32-39

¹¹ <https://www.icofort.org/konsultuarnë> 1.12.2022

numër të konsiderueshëm aktivitete. Rrjeti ofron një gamë të gjerë instrumentesh marketingu modern dhe aktivitete të synuara, të përshtatura në mënyrë specifike për nevojat e monumenteve të fortifikuara. Është aplikuar gjithashtu që monumentet pjesëmarrëse të kenë një prani të gjerë në tregjet ndërkombëtare të turizmit¹².

Po çfarë ndodh sot me ndërtimet e Luftës së Ftohtë në Shqipëri? Fortifikimet e epokës komuniste në Shqipëri, që për popullin shqiptar janë pjesë e memories kolektive të periudhës më të errët të historisë së tyre, po kthehen gjithnjë e më tepër në atraksione turistike duke ngjallur kureshtjen e miliona turistëve të huaj që vizitojnë çdo vit Shqipërinë.

Ato janë pjesë e listës së prodhimeve “Made in Albania”. Këto fortifikime, që në gjuhën popullore njihen me emrin bunkerë, janë simbole të Luftës së Ftohtë, dhe fryt i paranojës së diktatorit stalinist Enver Hoxha, që i ndërtoi ato për të mbrojtur vendin nga sulmet e Fuqive imperialiste apo revizioniste që synonin të pushtonin vendin e “vetëm socialist në botë”.

Ndërsa këto sulme mbetën imagjinare pasi nuk ndodhën kurrë, fortifikimet ishin objekte konkrete që u ndërtuan në mënyrë masive pas daljes së Shqipërisë nga Traktati ushtarak i Varshavës dhe pushtimit sovjetik të Çekosllovakisë në vitin 1968. Duke e shpallur mbrojtjen “detyrë mbi detyrat”, u ndërtuan mijëra bunkerë në të gjithë territorin e vendit. Sikurse shihet dhe nga




Fig.1 Harta e shpërndarjes së ndërtimeve të fortifikuara (D.Veizaj, Gj. Islami, A. Maliqari)]

harta, (fig. 1) më të pranishëm ishin përgjatë kufirit tokësor dhe zonës bregdetare perëndimore nga ku mendohej se do të vinte dhe agresori i huaj si dhe përreth kryeqytetit, Tiranë, ku ndodheshin institucionet kryesore të vendit.

Sipas terminologjisë ushtarake, fortifikimet ishin të tipologjive të ndryshme. Qendrat e zjarrit kishin përmasa më të vogla dhe ishin të

¹² <https://www.forte-cultura.eu/en/konsultuarnë> 2.12.2022

destinuara për përdorim nga këmbësoria, kurse pikat e zjarrit shërbejnë për të vendosur artilerinë brenda tyre duke përfshirë dhe topat e kalibrave të mëdhenj.

Si qendrat e zjarrit, ashtu dhe pikat e zjarrit, ishin struktura të forta të ndërtuara me beton, hekur e shufra çeliku të cilësisë së lartë, duke krijuar një shtresë me një trashësi që mund të arrinte deri në dy metra.

Po ashtu, u ndërtuan dhe tunele të nëndheshme për të strehuar popullsinë, udhëheqjen e lartë të partisë në pushtet dhe atë lokale si dhe armatimet ushtarake në kohë lufte duke përfshirë makina, avionë dhe nëndetëse.

Disa prej këtyre tuneleve u ndërtuan për t'u rezistuar sulmeve bërthamore të armikut.

Ndërtimi dhe vendosja e tyre në terrene të vështira malore ka kushtuar jetë njerëzish, përveçse rrënoi dhe ekonominë e vendit më të varfër të Europës, që “ndërtonte socializmin me forcat e veta” (fig. 2, fig. 3, fig. 4).




Fig.2 Qendër zjarri në liqenin e Pogradecit (foto: M. Puto)



Fig.3. Pikë zjarri në bregdetin e Tales, Lezhë (foto: E. Çaushi)



Fig.4. Bunk Art 1, vendstrehimi antibërthamor, Salla e Kuvendit Popullor (foto: A. Prodani)

Sipas shtypit spanjoll, gjatë diktaturës së Enver Hoxhës, “i cili ndaloi motelet dhe hotelet private, ato ishin gjithashtu vende të përzgjedhura nga çiftet e reja për të bërë dashuri dhe shumë shqiptarë e patën zanafillën e jetës së tyre në këto vende aspak romantike”¹³.

Pas rënies së komunizmit dhe hapjes së vendit drejt një sistemi demokratik në fillim të viteve 1990, bunkerët e humbën vlerën e tyre si

¹³ <https://www.laopiniondemurcia.es/cultura/2009/07/11/bunkeres-albania-atraccion-turistica-extranjeros-32907221.html>, konsultuar mw 25 janar 2022.

objekte ushtarake mbrojtëse dhe u kthyen në relike të kohës së kaluar, kur Shqipëria ishte kthyer në një nga vendet më të militarizuara të planetit. Shkatërrimi i tyre ishte i pamundur për shkak të kostos së lartë. Duke qenë struktura të forta ato ishin ndër të paktat objekte shtetërore që i rezistuan shkatërrimit masiv të atyre viteve në ndryshim nga fabrikat, uzinat, vreshtat e pemëtoret që i kujtonin popullsisë gjurmët e sistemit kolektivist socialist. Shkatërrimi i shumicës prej tyre do të vinte më vonë në mënyrë graduale dhe të padukshme nga ajo pjesë e popullsisë që kishte mbetur e varfër dhe me mjete primitive shkallmonte betonin për të nxjerrë hekurin për ta shitur në treg për skrap në këmbim të një fitimi minimal për të siguruar mbijetesën. Megjithatë, gjenden ende fortifikime në funksionin e tyre fillestar, që, duke i evidentuar si itinerare të veçanta në internet apo në forma të tjera, do të ngjallnin kuriozitetin e turistëve, si diçka unike e këtij vendi.

Në funksion të turizmit do të shërbenin, po ashtu, dhe ata bunkerë apo tunele, destinacioni i të cilëve ka ndryshuar nga ai fillestar duke iu përshtatur nevojave të popullsisë lokale. Këtu do të përmendim si rast unikal shndërrimin e një bunkerit në një kishë të vogël në kodrën ku shtrihet fshati Lin, në buzë të liqenit të Ohrit, pranë qytetit të Pogradecit. Banorët e këtij fshati kishin ndërtuar në majë të kodrës një kishë të vogël kushtuar Shën Nikollës, zot i ujërave dhe protektor i marinarëve dhe i peshkatarëve. Por në 1967, si shumica e vendeve të kultit, kjo kishë u prish nga regjimi komunist, i cili e shpalli vendin e parë ateist në botë dhe ndërtoi në këtë vend të shenjtë një bunker ku rrinin ushtarë të armatosur që kontrollonin vijën ndarëse të kufirit me ish Jugosllavinë në mënyrë që asnjë të mos arratisëj. Me ardhjen e demokracisë dhe lirisë së praktikave fetare, banorët e kthyen bunkerin në kishë duke vendosur brenda ikona dhe ku ndezin qirin për t’i kërkuar plotësimin e dëshirave Shën Nikollës. (fig. 5)

Në disa vende të tjera, pikat e zjarrit janë kthyer në restorante,



Fig.5. Banore të fshatit Lin, duke ndezur qiri në kishën bunker të shën Nikollës. (foto M. Puto)

ku shërbehet peshk apo ushqim tjetër tradicional. Jo më pak interesante janë dhe ata bunkerë që i ndeshim sidomos në veri të vendit të shndërruar në stalla të vogla për rritjen e derrave të cilët ndihen më të sigurt se dhe vet pronarët e tyre që i rrisin. Në Fushë Labino turistët mund të vizitojnë një fabrikë të prodhimit të konservave, më e madhja në vend, e cila eksporton prodhimet e saj dhe jashtë vendit, dhe ndodhet brenda një tuneli të fortifikuar ushtarak.




Fig. 6. Itinerare me tipologji të ndryshme fortifikimesh (autorët)

Një destinacion mbresëlënës është dhe bunkeri që ndodhet në Koplik të Malësisë së Madhe, pranë liqenit të Shkodrës, një qytet transit për vizitorët që hyjnë në Shqipëri nga Mali i Zi, i cili është kthyer në një sallon pikturash dhe bërje tatuazhesh për të rinjtë. Po ashtu, turistët do të shijonin me shumë ëndje dhe do ta kujtonin si diçka unike pirjen e një shishe dhallë të baxho-bunker Meshinit, ndanë rrugës nacionale Tepelenë-Këlcyre. Të tjerë mund të marrin shërbim të plotë me kamera dhe fotografi të bunkeri i Xhikes që ndodhet në rrugën pranë lokalitetit të Maliqit, në afërsi të qytetit të Korçës. Shumë të tjerë, si ata që ndodhen pranë fshatit piktoresk të Tushemishtit, janë pikturuar duke u kthyer në dekore të natyrës së bukur shqiptare.

Aktualisht më të vizituarit nga turistët vendas dhe të huaj janë dy tunelet antiatomikë që ndodhen në Tiranë, BunkArt 1 dhe BunkArt 2 si dhe Tuneli i Luftës së Ftohtë në Gjirokastrë, të cilët janë kthyer në muze. I pari, i ndërtuar në vitet 1972-1978, është tuneli më i madh antibërthamor i ndërtuar në një sipërfaqe prej rreth 2.700 metra katrorë, të shtrira në pesë kate, ku nuk mungon as salla e mbledhjeve të Kuvendit me 250 deputetë. Ky tunel i ndodhur pranë malit të Dajtit do të strehonte Shtabin e Ushtrisë në rast lufte dhe ku një hapësirë e veçantë i kushtojë komandantit të përgjithshëm të Ushtrisë, Enver Hoxha, dhe një ambient tjetër kryeministrit të asaj kohe, Mehmet Shehu. Më pak madhështor është tuneli antibërthamor që ndodhet pranë Ministrisë së Brendshme i kthyer më 2016-ën në një muze të

viktimave të diktaturës komuniste. Tuneli që ndodhet në qendrën historike të Gjirokastrës, nën kalanë e qytetit të shpallur Pasuri Kulturore e Unesco-s, është një tjetër labirinth i fshehtë i nëndheshëm i krijuar për të garantuar punën normale të autoritete lokale në rast sulmi ushtarak nga Greqia fqinje.

Edhe pse një pjesë e tuneleve janë kthyer në muze, është e nevojshme të shtohen itineraret për ti njohur vizitorët e huaj dhe ata vendas e sidomos nxënësit e shkollave me trashëgiminë ushtarake të Luftës së Ftohtë. Kjo edhe për shkak se është venë re nga turet turistike që ka një kërkesë të veçantë për vizitat me në fokus trashëgiminë e fortifikimeve ushtarake të luftës së ftohtë edhe në Shqipëri. Po ashtu, këto iniciativa kanë qenë të pakta dhe të ndërmarra nga individë të veçantë, dhe nuk kanë qenë projekte të mirëfillta të institucioneve. Kjo trashëgimi ka filluar rreth viteve 2012 pikërisht me krijimin e pavijonit në MHK¹⁴.

Ky studim ka për qëllim hulumtimin e këtyre fortifikimeve e më tej synon të japi rezultat në dy drejtime:

-Propozimin e itinerareve përgjatë rrjetit rrugor të vendit.

-Propozim për vënien në mbrojtje të disa tipologjive të këtyre ndërtimeve.

Për këtë kërkohet një studim i mirëfilltë i lidhur ngushtë me analizën e gjendjes së këtyre ndërtimeve në terren, si dhe analizën e informacionit lidhur me funksionin e secilës.

Propozimi i një itinerari konkret vjen me disa fortifikime të tipologjive të ndryshme që lidhin Shqipërinë qendrore (Tiranën) me pjesën jug-lindore deri në kufirin me Maqedoninë:

Bunkart, 1 (Tiranë), - Postbllok (Tiranë) – Tuneli i kthyer në fabrikë të përpunimit të peshkut (Fushë-Labinot), pikë zjarri në hyrje të Librazhdit – Kisha bunker e shën Nikolla në Lin, - qendër zjarri në Tushemisht pranë kufirit me Maqedoninë e Veriut – Bunkeri i Xhikes, pikë zjarri pranë Maliqit në rrugën nacionale Pogradec-Korçë (fig. 6)

Një qasje tjetër konkrete lidhet me propozimin për vënien në mbrojtje të tre tipologjive të ndryshme dhe me një shpërndarje territoriale veri-qendër jug:

¹⁴ Iacono F. (2018), “Revolution and counter-revolution; or why it is difficult to have a heritage of communism and what can we do about it”, në *International Journal of Heritage Studies*, Vol. 25, No. 5, 507–521

1. Bunkart 1 (tuneli më i madh antiatomik i Shqipërisë në atë kohë)

2. Kompleksi i Tales (Pikë zjarri kundërajrore)

3. Peizazhi i fortifikuar i Luginës së Drinos

Duke qenë ky hapi i parë i një pune që tashme ka filluar, itinerareve do t'ju bashkëngjiten edhe të tjerë, ashtu sikurse edhe propozimeve për vënien në mbrojtje të tipologjive më domethënëse, si dëshmi e rëndësishme për të kuptuar më mirë të kaluarën, frymën e kohës.

Ruajtja e kësaj trashëgimie, është tregues i rëndësishëm i ndërgjegjësimit tonë lidhur me të kaluarën.

BIBLIOGRAFIA

LOWENTHAL, D. (1996), *Possessed by the past: the heritage crusade and the spoils of history*, New York: Free Press

LOWENTHAL, D. (1998), *The Heritage Crusade and the Spoils of History*, Cambridge University Press.

LOWENTHAL, D. (1985), *The Past is a Foreign Country*, Cambridge University Press, 1985 M11

EDITED BY LOGAN W. & REEVES K. (2009), *Places of Pain and Shame, Dealing with 'Difficult Heritage'*, Routledge.

MYHRBERG, K. (2011), *Heritage from the Communist Period in Albania*, University of Gothenburg.

LIGHT, D. (2000), "An unwanted past: Contemporary tourism and the heritage of communism in Romania" në *International Journal of Heritage Studies*

IACONO, F. (2018): "Revolution and counter-revolution; or why it is difficult to have a heritage of communism and what can we do about it", në *International Journal of Heritage Studies*.

HESJEDAL, A. (2018), "From garbage to heritage? Two land defence lines in Arctic Norway: the Lyngen line (WW2) and the Frøy line (Cold War)", në *Military Heritage from 20th Century Preservation, Reuse and Management, Icofort Norway*.

LUCIANI, R. (editor 2018) *Military Heritage from 20th Century, Preservation, Reuse and Management, Icofort Norway* 2018, f.1-134

Faqe web

ICOFORT web page <https://www.icofort.org/> 1.12.2022

FORTE CULTURA web page <https://www.forte-cultura.eu/en/> 2.12.2022

<https://www.laopiniondemurcia.es/cultura/2009/07/11/bunkeres-albania-atraccion-turistica-extranjeros-32907221.html>, konsultuar më 15.01.2022.

Figurat:

Fig. 1. Harta e shpërndarjes së ndërtimeve të fortifikuara (Denada Veizaj, Gjergj Islami, Andrea Maliqari)

Fig. 2. Qendër zjarri në liqenin e Pogradecit (foto: Puto)

Fig. 3. Pikë zjarri në bregdetin e Tales, Lezhë (foto : Edlira Çaushi)

Fig. 4. Bunk Art 1, vendstrehimi antibërthamor, Salla e Kuvendit Popullor (foto: Anastasi Prodani)

Fig. 5. Banore të fshatit Lin, duke ndezur qiri në kishën bunker të shën Nikollës. (foto Puto)

Fig. 6. Itinerare me tipologji të ndryshme fortifikimesh (autoret)

SHQIPËRIA NË UDHËRRËFYESIT TURISTIK HARTUAR NË GJUHËN GJERMANE

Dr. MIGENA SEJDINI

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja
Universiteti i Tiranës
migena.sejdini@unitir.edu.al

ABSTRACT

Albania in the German travel guides

Geographical location, climatic conditions and diverse relief create favorable conditions for the development of the tourism sector in a small Mediterranean country like Albania. For decades, communist Albania had closed its doors to foreign tourists, so the fall of the Iron Curtain paved the way for accumulated curiosity about the small country on the Adriatic coast.

Over the years, German tourists have shown a special interest in visiting Albania to see the natural beauties and sights, learn about the traditions and culture, and experience Albanian hospitality and generosity. There are many who report on their experiences in various media and even recommend Albania as an idyllic travel destination in some aspects. The fact that 13 travel guides about Albania were published in the period 2018 - 2022 alone proves this great interest. But how is Albania presented in the printed and online guidebooks? How are they built? What topics are covered? Is there enough information on both coastal and mountain tourism as well as cultural tourism? Is ecotourism also a priority? The aim of this thesis is to provide answers to these and other questions by analyzing various German-language travel guides.

Keywords: Travelguides, tourismsector, Albania, Germantourist in Albania, guidebooks

Pozicioni gjeografik, kushtet klimaterike, relievi i larmishëm dhe mikpritja si një vlerë kulturore dalluese i krijojnë një vendi

mesdhetar të vogël si Shqipëria kushte favorizuese për të zhvilluar sektorin e turizmit. Ky sektor shihet jo vetëm si një kontribut i rëndësishëm që çon përpara ekonominë e vendit, (kujtojmë këtu që në vitin 2017 kontributi i drejtpërdrejtë i turizmit në Produktin e Brendshëm Bruto ishte 8.5%, ndërsa duke shtuar dhe efektet indirekte ky kontribut shkon në 26,2%, sipas të dhënave të strategjisë kombëtare të turizmit)¹, por edhe si një mundësi për të bërë të njohura dhe promovuar vlerat natyrore dhe kulturore dhe për të përmirësuar imazhin e Shqipërisë në arenën ndërkombëtare, ku jo rrallë herë lidhet me fenomene si kriminaliteti apo gjakmarrrja.

Në një raportim të Fondacionit “Konrad Adenauer” zhvillimi i turizmit në Shqipëri ka nisur të tërheqë vëmendjen e qeverisë Shqiptare që në mesin e viteve 2000². Në të vërtetë turizmi në Shqipëri edhe për shkak të faktorëve të ndryshëm ekonomikë, shoqërorë e politikë nuk ka mundur të gjejë rrugën e zhvillimit, ndonëse potenciali nuk i ka munguar. Për dekada të tëra ky zhvillim u pengua nga izolimi dhe mbyllja e Shqipërisë komuniste, e cila gjatë kësaj periudhe vizitohej rrallëherë nga pak grupe turistike. Bëhej fjalë për turistë që vinin kryesisht nga vende të Evropës Lindore, me të cilët qeveria e atëhershme shihte një farë afrimi ideologjik. Por edhe këta turiste bënë lëvizje të përcaktuara dhe të kontrolluara, kryesisht në plazhin e Durrësit dhe në kryeqytetin e vendit. Ndërsa ata turistë perëndimorë që kishin zgjedhur të kalonin pushimet në ishullin e Korfuzit, kishin mundësi të drejtonin dylbitë nga toka shqiptare, për të shuar disi apo nxitur edhe më shumë kureshtjen e tyre për këtë vend të izoluar vetëm dy milje larg. Pas ’90 Shqipëria nisi të frekuentohej nga vizitorë të huaj, numri i të cilëve rritet me kalimin e viteve, duke bërë që dhe sektori i turizmit të shihej si potencial ekonomik.

Interes gjithnjë e në rritje për të vizituar vendin tonë kanë shfaqur edhe turistët nga Gjermania dhe vende të tjera gjermanishtfolëse. Bazuar në buletinet statistikore të hyrjeve vjetore të shtetasve të huaj në Shqipëri, vihet re se në harkun kohor të gjashtë viteve (2013-2019) është dyfishuar numri i shtetasve gjermanë që kanë hyrë në territorin

¹ <https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2019/06/Strategjia-Komb%C3%ABtare-e-Turizmit-2019-2023.pdf>, fq. 5

² <https://www.kas.de/de/statische-inhalte-detail/-/content/tourismus-in-albanien>

shqiptar. Në vitin 2013³ raportohen 79 925, ndërsa për vitin 2019⁴ kjo shifër shkon në 165 703 persona. Natyrisht duke qenë se në këto publikime referuar Institut të Statistikave të Republikës së Shqipërisë raportohet vetëm numri i përgjithshëm i hyrjeve nga Gjermania, pa specifikuar arsyet e vizitës së tyre në territorin tonë, nuk mund të filtrojmë numrin e saktë të vizitorëve turistikë, por kjo nuk na pengon të mendojmë që kjo rritje ka prekur edhe këtë grup vizitorësh.

Sipas një studimi të kryer nga Zyra Federale Gjermane e Statistikave⁵ mbi nivelin e çmimeve në fushën e hotelerisë dhe gastronomisë në listën e vendeve të përzgjedhura nga shtetasit gjermanë për të kaluar pushimet, publikuar në shkurt të vitit 2022, përfshihet edhe Shqipëria, çka dëshmon faktin se një pjesë e mirë e shtetasve gjermanë hyjnë për arsye turistike në Shqipëri.

Një tjetër fakt që flet për rritjen e interesit të shtetasve nga zona gjermanishtfolëse për të vizituar Shqipërinë është edhe numri gjithnjë e në rritje i botimeve informuese me karakter turistik në përgjithësi dhe udhërrëfyesve në veçanti mbi Shqipërinë hartuar në gjuhën gjermane.

Nga një kontroll platformave⁶ që ofrojnë porosinë dhe blerjen e librave në internet, bie në sy shfaqja e më shumë se trembëdhjetë titujve informues për Shqipërinë, të cilët janë publikuar nga shtëpi botuese të specializuara dhe të mirënjohura në hartimin e udhërrëfyesve, si p.sh. shtëpia botuese Trescher, Reise Know-How, Michael Müller Verlag etj.

Udhërrëfyesit përbëjnë një tipologji të veçantë letrare dhe si pjesë e gjinisë letrare të udhëtimeve (Reiseliteratur)⁷, e cila informon lexuesin duke rrëfyer, përshkruar dhe raportuar vëzhgimet, përjetimet dhe përshtypjet e udhëtarëve gjatë ndalesave në vende të ndryshme, i kanë rrënjët në antikitetin e lashtë. Vlen për t'u përmendur këtu vepra e Herodotit, ku përshkruhen jo vetëm vende e ngjarje, por edhe karakteristika të jetës kulturore të vendasve.

Udhërrëfyesit në formatin që i njohim ne sot e kanë fillesën e tyre në mesin e shekullit të 19-të⁸. Me kalimin e viteve ato kanë pësuar

³ INSTAT, Turizmi në shifra, Shqipëri, 2018. fq. 21

⁴ Buletini i turizmit, Raportim Mijor, Dhjetor 2021, fq 6

⁵ https://www.destatis.de/DE/Presse/Pressemitteilungen/2022/04/PD22_N017_61621.html

⁶ www.amazon.de; www.buecher.de

⁷ <https://www.kettererkunst.de/lexikon/reiseliteratur>.

⁸ PRETZEL U. (1995), *Die Literaturform Reiseführer im 19. Und 20. Jahrhundert. Untersuchungen am Beispiel des Rheins*, Peter Lang GmbH, Internationaler Verlag der Wissenschaften, Frankfurt

ndryshime të shpeshta duke iu përshtatur nevojave të kohës, çka e bën të vështirë gjetjen e një përkufizimi të njësuar për to. Fjalori i Akademisë së Shkencave e quan udhërrëfyesin: “Libër që përshkruan një vend, që flet për bukuritë natyrore, për historinë e tij, etj. dhe që përmban edhe të dhëna të tjera të dobishme për ata që e vizitojnë”⁹.

Ndërsa enciklopedia Brockhaus¹⁰ e vendos theksin e saj tek vizitorët, duke e përcaktuar qartë grupin e lexuesve, të cilëve udhërrëfyesit u drejtohen duke i udhëzuar, këshilluar dhe vënë në dispozicion informacione jo vetëm me interes historik e kulturor, por edhe me rëndësi praktike për lëvizjet e tyre.

Edhe pse udhërrëfyesit vazhdojnë të ruajnë fillin narrativ dhe përshkrimin e detajuar të peizazheve, funksioni kryesor i tyre mbetet përcjellja e informacioneve faktike, të sakta dhe të përditësuara, të cilat i ndihmojnë udhëtarët, jo vetëm të lëvizin dhe të sigurojnë me lehtësi shërbime në një vend të huaj, por të kuptojnë edhe më mirë botën shpirtërore dhe kulturën e njerëzve aty.

Lidhur me udhërrëfyesit e hartuar në gjuhën gjermane që kanë në fokus të tyre Shqipërinë vihet re fakti se ato jo vetëm janë të shumtë në numër, por ofrojnë dhe informacione voluminoze dhe të detajuara duke mbuluar të gjitha krahinat e vendit.

Pothuajse të gjithë shtëpitë botuese të specializuara në botimin e udhërrëfyesve kanë vendosur Shqipërinë në katalogun e botimeve të tyre, duke ofruar harta të Shqipërisë, udhërrëfyes apo reportazhe udhëtimesh përmes Shqipërisë. Ndeshim botime nga më të ndryshme, duke nisur nga “*Albanien. Unterwegs auf dem Balkan*”¹¹ nga Stefanie Rogoll, me vetëm 44 faqe, i cili më tepër se një udhërrëfyes i mirëfilltë, është një përmbledhje eksperiencash në zonat e vizituara nga autorja, e deri te “*Albanien. Reiseführer für individuelles Entdecken*”¹² nga Meike Gudweiler, me 648 faqe, të cilin shtëpia botuese e sjell të përditësuar për lexuesin e interesuar për herë të katërt. Botimi i parë është i vitit 2012, i dyti në 2014, i treti në 2018 dhe botimi i fundit ka dalë në treg me informacion plotësues dhe i përditësuar në janar të vitit 2022.

am Main, fq. 9

⁹ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (2002), *Fjalori i Shqipërisë së Sotme*, Botimet Toena, Tiranë, fq. 1399

¹⁰ Der Neue Brockhaus (1960), Allbuch in fünf Bänden und einem Atlas. Vierter Band, F.A. Brockhaus Wiesbaden, fq. 318

Udhërrëfyesit paraqesin një panoramë të plotë të të gjitha zonave të Shqipërisë, duke dhënë informacion të detajuar jo vetëm për pozitën gjeografike, por edhe për karakteristikat gjeografike të vendit, kushtet klimatike, peizazhin natyror të krahinave shqiptare, florën dhe faunën, zonat e mbrojtura dhe parqet natyrore. Me detaje përshkruhen jo vetëm zonat bregdetare, por edhe malësitë, zonat kodrinore, luginat, guvat, ujëvarat dhe kanionet shoqëruar me informacion historik. Qyteteve, atraksioneve turistike, skenës kulturore brenda tyre si dhe qendrave arkeologjike pranë tyre, u kushtohet vëmendje e veçantë.

Në udhërrëfyesit për Shqipërinë nuk gjenden vetëm përshkrime, shifra e informacion historik, por edhe informacione për gjuhën, bashkëjetesën fetare, skenën letrare, kulturore dhe muzikore¹³ të dhëna mbi ekonominë, informacione për kulinarinë shqiptare, adresa hotelesh, restorantesh, dyqanesh, lokalesh shoqëruar me rekomandime. Në këto udhërrëfyes gjenden informacion dhe rekomandime për aktivitetet të ndryshme që mund të bësh në Shqipëri, duke nisur nga noti dhe zhytjet në plazhet jugut, tek hedhjet me parashutë nga Llogaraja apo kanoe, rafting dhe kayaking në kanionet e Osumit. Pjesë e disa prej udhërrëfyesve janë bërë edhe itinerare për të kaluar nëpër zona të ndryshme në këmbë, si p.sh. Theth-Valbonë. 16 të tilla gjejmë në udhërrëfyesin e shtëpisë botuese Miachel Müller.

Të gjithë udhërrëfyesit ofrojnë një numër të konsiderueshëm fotografish, të një cilësie të lartë, ku paraqiten jo vetëm peizazhe dhe objekte të ndryshme, por edhe banorë të zonave, duke e bërë edhe më të gjallë informacionin e përcjellë.

Gjithashtu një element tjetër përbërës i udhërrëfyesve janë hartat e zonave dhe planimetritë e qyteteve.

Disa prej udhërrëfyesve ofrojnë edhe një fjalorth modest me fjalët dhe shprehjet kryesore nga jeta e përditshme, si një mundësi për të krijuar kontakte të drejtpërdrejta me vendasit.

Pjesa më e madhe e udhërrëfyesve përmes përshkrimit të qyteteve, fshatrave, krahinave dhe itinerareve si dhe këshillave të dobishme ofrojnë informacion të bollshëm për t'u orientuar në një vend të panjohur. Udhëzimet, adresat dhe rekomandimet e tyre për hotele, restorante dhe lokale ndihmojnë në organizimin e udhëtimit dhe qëndrimit. Ndërsa informacionet historike dhe kulturore duke përcjellë njohuri dhe dije, të ndihmojnë të kuptosh më mirë jetën që

zhvillohet në këto zona si dhe mentalitetin e shoqërisë së tyre. Ndërsa rekomandimet për aktivitetet që mund të zhvillohen në zona të ndryshme të Shqipërisë i japin mundësinë çdo turisti, udhëtari apo kalimtari të ndjekë pasionet e veta në këtë vend vërtet të vogël, por me një larmi interesante natyrore, historike dhe kulturore.

Krahas udhërrëfyesve klasikë, me informacione të përgjithshme, vitet e fundit janë publikuar edhe udhërrëfyes specifikë, të cilët i dedikohen një grupi të caktuar udhëtarësh apo turistësh, si p.sh. *“Albanien: Ein Archäologie- und Kunstführer von der Steinzeit bis ins 19. Jahrhundert”*¹⁴, i cili ofron një përshkrim të hollësishëm të siteve arkeologjike, ndërtesave, memorialëve historikë dhe muzeve, duke lënë jashtë objektit informacione të përgjithshme apo këshilla lidhur me hotelet dhe restorantet.

Udhërrëfyesi *“Albanien. Küstenwanderungen, Hirtenpfande und Gipfeltouren. 44 Touren”*¹⁵ u kushtohet alpinistëve dhe sportdashësve të marshimit, ecjeve të gjata dhe ngjitjeve, pasi përshkruan itinerare në 5 zona të Shqipërisë, në Tiranë, në rivierë, në luginën e Vjosës, në malin e Korabit si dhe në Alpe, duke shoqëruar itineraret me informacione të përgjithshme për zonën dhe njerëzit, këshilla, udhëzime për rreziqe të mundshme, përshkrime të lëvizjeve, harta, foto dhe të dhëna të rëndësishme për ndalesa, fjetje dhe ushqim.

Informacionet, përshkrimet, udhëzimet dhe këshillat që gjenden në këta udhërrëfyes marrin një vlerë dhe rëndësi edhe më të madhe për faktin se në pjesën më të madhe të rasteve, hartuesit e tyre janë persona që e njohin mirë Shqipërinë pasi e kanë vizituar për një kohë të gjatë atë, si në rastin e Gudweiler (Albanien. Reiseführer für individuelles Entdecken, Reise Know-How), Ralph-Taymond Braun (Albanien. Ausflüge nach Montenegro, Kosovo und Mazedonien. Michael Müller Verlag), i cili jo vetëm ka qenë shpesh në Shqipëri, por ka pasur mundësi ta vizitojë atë edhe gjatë regjimit komunist, Martina Kaspar dhe Günther Holzmann (albanien, europas neue top-destination für individualisten) ose jetojnë në Shqipëri si në rastin e arkeologut Bashkim Lahi, bashkautor i *“Albanien: Ein Archäologie- und Kunstführer von der Steinzeit bis ins 19. Jahrhundert”*.

BIBLIOGRAFIA

- Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë:
Fjalor i Shqipes së Sotme, Botimet Toena, Tiranë, 2002, fq. 1399
- BOSSE M., BOSSE-STEINWEG K. (2022), *Albanien. Küstenwanderungen, Hirtenpfande und Gipfeltouren. 44 Touren*, Rother Bergverlag, Berlin
- BRAUN R.-R. (2019), *Albanien. Ausflüge nach Montenegro, Kosovo und Mazedonien*. Michael Müller Verlag, Erlangen
- F.A. BROCKHAUS, Der Neue Brockhaus (1960), *Allbuch in fünf Bänden und einem Atlas*, Vierter Band, Wiesbaden, 1960, fq. 318
- GUTZWEILER, M. (2022), *Albanien. Reiseführer für individuelles Entdecken*, Reise Know-How Verlag Peter Rump GmbH; Bielefeld
- INSTAT, Turizmi në shifra, Shqipëri, 2018
- INSTAT, Buletini i turizmit, Raportim Mujor, Dhjetor 2021
- KASPAR M., HOLZMANN G. (2018), *albanien, europas neue top-destination für individualisten*, hobo-team.de,
- PRETZEL U. (1995) *Die Literaturform Reiseführer im 19. Und 20. Jahrhundert. Untersuchungen am Beispiel des Rheins*, Peter Lang GmbH, Internationaler Verlag der Wissenschaften, Frankfurt am Main
- ROGOLL, S. (2020) *Albanien. Unterwegs auf dem Balkan*, indipendently published
- ZINDLER C., LIPPERT A., LAHI B., KIEL M. (2018) *Albanien: Ein Archäologie- und Kunstführer von der Steinzeit bis ins 19. Jahrhundert*, Böhlau, Wien

Sitografia

- <https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2019/06/Strategjia-Komb%C3%ABtare-e-Turizmit-2019-2023.pdf>,
- <https://www.kas.de/de/statische-inhalte-detail/-/content/tourismus-in-albanien>
- https://www.destatis.de/DE/Presse/Pressemitteilungen/2022/04/PD22_N017_61621.html
- www.amazon.de
- www.buecher.de
- www.kettererkunst.de/lexikon/reiseliteratur

NGA HOMERI TE VIRGJILI, NGA BAJRONI TE KADAREA, LETËRSIA SI UDHËRRËFYES I ITINERARËVE GJEOGRAFIKE DHE KULTURORE

Prof. Dr. SAVERINA PASHO

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Universiteti i Tiranës

saverina.pasho@unitir.edu.al

ABSTRACT

Literary works have undoubtedly been the first tourist guides, long before the term tourist came into existence. The great writers were in a way the first travelers / tourists who discovered the various peoples and countries and wrote about them. More specifically, those who initiated the Grand Tour, which reached its height from the mid-18th century until the beginning of the 19th century, have the merit of shedding light on unknown or little-known civilizations, countries, and arts. This is how Lord Byron could have incited great curiosity about Albania, followed by artists and researchers who, with their impressions, produced an entire literature of travel as well as many tourists. Even today, when tourism has been highly democratized, literature continues to generate the interest of the simple tourist about the culture of the country of destination and that country's literature remains an essential guide. This is how Kadaré's work attracts a large number of tourists who do not only aim to discover the physical territory of Albania, but mostly, to get acquainted with the anthropological territory of his novels.

Keywords: literature, tourism, Kadaré's work, anthropological territory, guide

Ne e dimë se antropologjia ka kohë që merret me fiksionin dhe mitet për të shpjeguar natyrën njerëzore dhe shoqërinë, ndërsa shkencat e tjera madje edhe ato sociale nga një këndvështrim tradicional

pozitivist priren të analizojnë vetëm faktet reale, në dëm të realiteteve imagjinare apo simbolike.

Nga kjo pikëpamje, industria e turizmit shihet më shumë e lidhur me shkencat ekonomike sesa me letërsinë. Por ne dimë gjithashtu se sipas përkufizimit turizmi ndodhet në pikëpjekje të disa fushave e disiplinave.

Prej disa dhjetëvjeçarësh, turizmi ka filluar të shihet i lidhur fort jo vetëm me potencialet natyrore të vendit por edhe me kulturën dhe trashëgiminë imateriale. Turisti aktual është po aq i interesuar të zbulojë një territor fizik sa edhe një territor metafizik që lidhet me imagjinaren kolektive e praktikat kulturore të një vendi. Këtu letërsia përdoret si një mjet për të vënë në dukje, me një saktësi gati antropologjike, lidhjen ndërmjet dimensioneve të ndryshme të asaj çka quhet «territor».

Një analizë pragmatike e përdorimit të letërsisë do të çonte ashtu sikundër ka ndodhur jo radhë, në zbulimin e itinerareve turistike të kalkuara mbi itinerare letrare apo mbi arealin e imagjinare kolektive popullore. Në studimet anglo-saksone për turizmin flitet për turizëm letrar qysh prej vitit 1990, ndërsa në Francë pothuaj nuk flitet qartas për të përpara studimit të Aurore Bonniot-Mirloup, *Imaginaire des lieux et attractivité des territoires : Une entrée par le tourisme littéraire : Maisons d'écrivain, routes et sentiers littéraires*, në 2016.

Pavarësisht këtyre vërejtjeve ne e dimë se në zanafillë të zbulimeve të mëdha që më vonë janë kthyer në destinacione turistike nga më tërheqëse janë shkrimet e autorëve të ndryshëm, në formën e letërsisë fikzionale të mirëfilltë apo të letërsisë së udhëtimit, mes të cilave ka sigurisht shumë elemente dalluese e mbi të gjitha, vërtetësia : nëse letërsia e mirëfilltë ajo e fiksonit të vendos në një univers areal, e dyta është shpesh një dëshmi e vërtetë me vlerë dokumentare. Gjithsesi edhe e para nuk ka munguar të çojë drejt zbulimesh të mëdha, Le të përmendim rastin e arkeologut gjerman Heinrich Schliemann që u nis për në Turqi, në fund të shekullit 19-të me një ide eksentrike për të kërkuar Trojën antike të kënduar nga Homeri në poemat epike *Iliada* dhe *Odiseu* të shek.VIII p.e.s. Dhe ia doli. Hisarliku, në Turqi, njihet sot nga të gjithë si kuadri apo territori i epopeve homerike.

Po kështu, Ugolini mundi ta identifikonte Butrintin përmes *Eneidës* së Virgjilit.

Kjo u festua me një ngjarje të jashtëzakonshme kulturoro-turistike : kroçera virgjiliane, në 15 shtator 1930, në bordin e anijes Aquileja ku pasagjerët kishin fatin të kishin për guidë vetë Ugolinin.

Aktualisht, në Brindisi ka marrë formë një projekt i quajtur *La Rotta di Enea*, që rimerr rrugën që përshkoi Enea dhe kalon nëpër Turqi, Greqi, Shqipëri, Tunizi dhe Itali, me 21 qëndrime kryesore në vende sugjестive të qytetërimit mesdhetar

Për të kaluar në epoka më të vonshme mund të përmendnim ndikimin e madh të shkrimtarëve të huaj romantikë që ndërmorën le Grand Tour d’Orient, në njohjen e Shqipërisë. Shqipëria dhe personazhe të shquara të saj si Skënderbeu apo Pashai i Janinës do të hynin në letërsi përmes Bajronit dhe të tjerë shkrimtarë si V.Hugo apo Lamartini. Shqipëria e kënduar nga Bajroni në poemën e tij të famshme *Pelegri nazhi i Child Harold*, është sigurisht, një Shqipëri romantike e hyjnizuar, por në sajë të kësaj vepre vendi ynë u fut në itineraret e Grand Tour-it. Gjatë shekullit XIX dhe në fillimet e shekullit XX referencat bajroniane do të frymëzonin një numër të madh udhëtarësh evropianë të vizitonin Shqipërinë. Ky ndikim i madh letrar u përkthye në udhëtimet dhe veprat e shquara mbi Shqipërinë si ato të Edward Lear-it, Edith Durham-it, Isadora Duncan.

Sot, ato vazhdojnë të ndikojnë me qindra turistë që duan të ndjekin itinerarin bajronian në jug të Shqipërisë kaluar mbi kalë. Kjo bëri që në vitin 2011 Auron Tare të krijonte për herë të parë një itinerar historiko-turistik mbi kalë duke ndjekur gjurmët e lord Bajronit përmes luginës së Drinos dhe vargmaleve të Lunxhërisë, në jug të Shqipërisë.

Turizmi letrar është një aspekt i turizmit kulturor, i cili është zhvilluar shumë këto vitet e fundit meqë kultura sikundër thotë Françoise Luchini, është bërë «njëkohësisht aspiratë e përligjur e më të thjeshtit midis nesh dhe një instrument aktual për zhvillimin shoqëror dhe ekonomik të qyteteve tona».¹

Karakteristika e turizmit letrar është se ai ofron për turistin një territor përmes letërsisë. Kështu vendet mund të kthehen në mbartës të një kulture, të një identitetit dhe një historie duke tërhequr turistin vendas apo të huaj edhe për vlerat e trashëgimisë imateriale. Paralelisht, qytetet dhe peizazhet janë tradicionalisht burime të

¹ Françoise Lucchini, *La culture au service des villes*, Paris, Anthropos, 2002, p. 1.

letërsisë së udhëtimeve apo poemave që i këndojnë bukurisë së tyre. Përshkrimet, metaforat, imazhet romaneske të këtyre vendeve tërheqin vazhdimisht vëmendjen e turistëve që interesohen jo vetëm për territorin fizik por edhe për legjendat apo historitë që ndërtojnë një territor shpirtëror dhe ndonjëherë është e çuditshme të konstatosh se si «disa pelegrinazhe letrare përcaktojnë lëvizje të popullsisë dhe një aktivitet ekonomik po aq të rëndësishëm sa pelegrinazhet fetare» (rasti i qytetit të Gjirokastrës).

Ka dy mënyra se si një autor apo një vepër letrare përdoren për të promovuar turizmin kulturor. I pari dhe më i thjeshti është ai që ndjek gjurmët e një autori, vendlindjen e tij, shtëpinë që zakonisht kthehet në muze i hapur për publikun ose në bibliotekë për qytetin. Të tilla në rastin e Kadaresë kemi dy: shtëpinë muze të Gjirokastrës, e cila u rindërtua sipas arkitekturës së saj të dikurshme dhe atë të Tiranës, në rrugën e Dibrës, e cila përmban edhe një bibliotekë modeste të shkrimtarit si dhe dorëshkrime e dokumente që jo vetëm mund të shuajnë kureshtjen e turistëve, por mund të ndihmojnë edhe studiuesit në hulumtimet e tyre.

Një mënyrë tjetër, shumë më interesante, është ajo e tërheqjes së turistëve përmes imazhit të qyteteve ashtu sikundër del nga shkrimi romanesk. Ky është një imazh sa tërheqës aq edhe i sinqertë apo i paqëllimtë, në kuptimin se autori nuk nisët nga ideja për të ndërtuar një imazh të caktuar të cilin do ta shiste sikundër bën autori i një guide, apo do ta ngarkonte me paragjykime dhe mbresa personale sikundër ndodh me letërsinë e udhëtimeve (sikundër dëshmojnë dy raste të studiuar më parë nga autorja e kësaj kumtese, përmes shkrimeve të Pouqueville-it dhe Edward Lear-it për Shqipërin)

Nga ana tjetër ekziston edhe një turizëm që ndjek gjurmët e autorit në një vepër, ku turisti është i prirur të shkojë për të vizituar dhe rigjetur vende, peizazhe që kanë qenë dekor apo vendngjarje të romaneve të tij të preferuar.

Zhvendosja fizike, udhëtimi në peizazhet, vendet, ndërtesat e cituara në një vepër letrare, mundësojnë një qasje më ndjesore, më të rrokshme nga shqisat nga çka mund të imagjinohet përmes leximit. Ky lloj poroziteti midis territorit real dhe atij të veprës ndonjëherë është një argument marketingu ndonëse nuk përmendet turisti si i tillë. Në fakt, është thjesht një udhëtar (kalimtari siç shkruhet në *Kronikë në gur*)

i cili është kaq i zhytur në faqet e romanit sa vetë vendet dhe peizazhet nisin e transformohen.

Shpesh disa qytete bëhen kaq mbresëlënëse vetëm në saje të një vepre letrare saqë kjo e fundit bëhet pjesë e trashëgimisë dhe e identitetit të qytetit dhe citohet si referencë në fletëpalosjet dhe guidat turistike siç ndodh për shembull me Gjirokastrën që përveçse citohet si qyteti i gurtë, shtohet gjithashtu se është vendlindja ose qyteti për të cilin Kadarea shkruan në romanin «Kronikë në gur» dhe vendet e përmendura në roman si *Qafa e Pazarit, Sokaku i të marrëve, fusha e dikurshme e aviacionit, avioni i rrëzuar dhe sidomos Kështjella* janë itinerare të pashmangshme dhe të frymëzuara drejtpërsëdrejti nga romani. Le të citojmë një pasazh që në hyrje të romanit për të kuptuar se si mund të shërbejë shkrimi romanesk si një kartolinë për qytetin dhe se si mund të ngjallë admirimin e një lexuesi-turist potencial:

«Ky ishte një qytet i pjerrët, ndoshta më i pjerrëti në botë që kishte thyer të gjitha ligjet e urbanistikës. Nga shkaku i pjerrësisë së madhe ndodhte që në nivelin e pullazit të njëres shtëpi gjendeshin themelet e tjetrës, dhe me siguri, ky ishte vendi i vetëm në botë ku kalimtari po të rrëzohej, në vend që të shembej në gropën ndanë udhe, mund të binte në pullazin e ndonjë shtëpie të lartë.» (Kadare, I., 2000, f.14)

Ose

«Ishte me të vërtetë një qytet shumë befasues, Ti mund të ecje rrugës dhe po të doje, mund të zgjatje pak krahun e të vije kësulën tënde mbi majën e një minareje». (Idem)

Nuk besoj se ndonjë reklamë promovuese do të ngjallte më shumë interes e më shumë kureshtje për Gjirokastrën sesa këto pasazhe që hapin romanin “Kronikë në gur.”

Në rastin e shkrimit romanesk, kartolina e qytetit të përshkruar nga autori është larg qasjes së letërsisë së udhëtimeve dhe për më tepër është shumë herë më magjepsëse pasi aty hyn fuqia e figuracionit letrar si dhe ngarkesa e tramës dhe e përjetimit të autorit. Kështu letërsia përdoret si një mjet për të vënë në dukje me saktësi antropologjike lidhjen midis dimensioneve të ndryshme që mund t’i quajmë «territore». Në këtë kuptim kemi atë përfitim që antropologët e quajnë çështje territoriale çka nënkupton një shumësi dimensionesh nga ai individ-

ual te më kolektivi me të gjitha qasjet psikoanalitike, historike, fetare, politike, etj.

Kështu përmes romanit, apo në mënyrë më të specifikuar romanit të Kadaresë “Prilli i thyer” që do të na shërbejë për të ilustruar analizën tonë, ne do të realizojmë një eksplorim sistematik të nocionit të territorit në të gjitha kuptimet e tij. Tani nuk jemi aq në një territor fizik (ndonëse edhe ky nuk mungon) sesa në një territor metafizik e areal. Në fakt, autori na përgatit për këtë gjë ndërsa shkruan:

“Malësorët e vërtetë janë aty në Rrafsh, i kishte thënë ai një natë, duke bërë me dorë në një drejtim që më tepër tregonte lartësinë qiellore, sesa ndonjë pikë të horizontit, thua se Rrafshi verior ndodhej në qiell e jo në tokë”. (Kadare, I., 2003, f.64)

Territori fizik është ai i Mirditës, Oroshit dhe Bjeshkëve të Namuna. Këto të fundit ndonëse përbëjnë një territor fizik material e real mbeten ende të papërcaktuara mirë gjeografikisht në roman.

Sipas Fjalorit enciklopedik shqiptar të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (1985) Bjeshkët e Namuna njëjtësohen si “kuriz malor në Alpet Shqiptare, rrethi Shkodrës...”

Në një reportazh të saj, me titull “Në malet e malsorëve” (“Dans les montagnes des malissores”), botuar më 9 qershor 1924 në *Journal de Genève*, Noëlle Roger, pasi flet për malet në brigjet e Liqenit të Shkodrës e të Drinit dhe për malet e Mirditës, shkruan se këto mbështesin një “labirint të pafund vargmalesh e luginash të egra, i cili në hartat e paraluftës mban emrin e Bjeshkëve të Nëmura” (në origjinalin frëngjisht *Monts Maudits*). Roger i vendos “Bjeshkët e Nemuna” në veri të Drinit.

Mungesa e saktësisë gjeografike, nuk e zbeh aspak magjepsjen. Edhe në këtë roman kemi diçka që ngjason shumë me një ftesë për të vizituar këtë territor apo pothuajse me një spot publicitar të vjetër dhe të kthyer pas në kohë:

Ja një citim kinse i bërë në një gazetë të asaj periudhe :

“Një befasim i këndshëm: Shkrimtari Besian Vorpsi me gruan e tij të re, Dianën, vendosën ta bëjnë muajin e mjaltit në Rrafshin e Veriut”. (Kadare, I., 2003, f.60)

Por Rrafshi është ende territori i Kullave dhe Alpeve. Alpet vazhdojnë të jenë një atraksion turistik i rëndësishëm në Shqipëri dhe *Kullat* përmenden në çdo guidë turistike për Shqipërinë, vendase apo të huaj.

“...në Alpe ishte ende ftohtë dhe kullat epike ishin të gurta.” (Idem f.61)

Zona veriore është padyshim një destinacion shumë tërheqës për turistët e huaj, jo vetëm për bukuritë natyrore por edhe për ngarkesën emocionale, simbolikën dhe eposin që mbart ky vend i mbushur me legjenda.

Mirëdita që është territori fizik i romanit “Prilli i thyer” është gjithashtu nga një qasje antropologjike territori i gjakmarrjes, i besës, që ende ngjall kureshtje për turistët dhe figuron në guidat turistike qoftë edhe si një rekomandim i frymëzuar nga stereotipet se sipas një tradite të vjetër të rregulluar me një ligj tradicional si kanuni është e rrezikshme t’i fyesh apo ngacmosh shqiptarëve gruan apo motrën.

Por është interesante të konstatojmë në rrjetet sociale se shumë turistë vendas pyesin për vendndodhjen e Oroshit, nëse aty ka mbetje të kullës së ngujimit, kisha të vjetra, etj. Këto kureshti që kërkohen në këtë territor kanë të bëjnë me orientimin nga leximi i veprës së Kadaresë ashtu sikundër aluzionet në këtë roman i drejtojnë turistët drejt një vendi ku mund të gesh sigurisht ndërtesat karakteristike kullat e gurta dhe kisha të vjetra, dhe për këto të fundit turisti nuk do të mbetet i zhgënjyer sepse në Mirditë do të gjejë Kishën e Manastirit të Rubikut, një monument kulture i kategorisë së parë që daton në shek XII-XIII.

Ajo që ka rëndësi është se leximi i një vepre romaneske ka një forcë evokative më të madhe se sa një guidë turistike dhe mund ta drejtojë lexuesin drejt zbulimit të vendeve dhe kulturave të ndryshme. Prandaj themi se letërsia mbetet një udhërrëfyes i pashmangshëm në zbulimin e itinerareve turistike ashtu sikundër këto të fundit janë frymëzuese për shumë autorë dhe ushqejnë pareshtur letërsinë e më specifikisht letërsinë e udhëtimeve.

BIBLIOGRAFIA

Referime artikujsh

GARGANO OLIMPIA (2021) : Le voyage en Albanie d'Isadora Duncan, entre autobiographie et fiction romanesque, in Loxias <http://revel.unice.fr/loxias/index.html?id=6864>

HEINICH, N. (2002). Les dimensions du territoire dans un roman d'Ismaïl Kadaré. Sociologie et sociétés, 34 (2), 207–218. <https://doi.org/10.7202/008139ar>

Referime librash

LEAR, EDWARD, (2008), *Edward Lear në Shqipëri: Ditar udhëtimesh 1848-1849*, Tiranë, Botime Plejad

POUQUEVILLE, F.-C.-H.-L., (1826), *Voyage de la Grèce*. Paris : Firmin Didot Père et Fils.

ELIAS, NORBERT (1973), *La civilisation des mœurs*, Paris, Calmann-Lévy

RAMA, LUAN, 2005, *Santa Quaranta: gërsheti i prerë i Isadora Dulkanit*, Tirana, Argeta,

KADARE, ISMAIL, (2000), *Kronikë në gur*, Tiranë, Botime Onufri

KADARE, ISMAIL, (2003), *Prilli i thyer*, Tiranë, Botime Onufri.

GJUHA SI NJË E MIRË KULTURORE THEMELTARE PËR TRASHËGIMINË

Dr. ELSA SKËNDERI

Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë
Universiteti i Tiranës
elsa.skenderi@unitir.edu.al

Msc. ANXHELA LEPURI

anxhela.lepuri@Af.edu.al
Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë
Universiteti i Tiranës

ABSTRACT

The present paper aims to analyse the concept of language as a cultural asset. Language is the central tool for preserving identity, but also for the authenticity and the survival of a culture. Languages are inherent parts of the cultural and intellectual world and as such, the disappearance of a language is not simply the disappearance of a linguistic code in and of itself, but the disappearance of a world view and cultural universe. Language, in addition to being a means of communication, also shapes and reinforces identity, it communicates culture and many of the inheritors consider it an irreplaceable sign of identity. Taking back some concepts of the philosophy of language and ethnolinguistics, in this study will be argued the role of language in general and heritage languages in particular, as cultural assets for the preservation and transmission of cultural heritage from generation to generation, especially in the context of the developments that have brought globalism.

Keywords: ethnolinguistics, ethnolinguistic vitality, cultural heritage, heritage language.

1. Gjuha dhe këndvështrimi për botën

Gjuha është mjeti qendror për komunikimin dhe përfaqësimin e një sërë aspekteve botëkuptimore, përfshirë këtu edhe kulturore të një komuniteti të caktuar folësish. Ajo është po ashtu thelbësore për identitetin,

autenticitetin dhe mbijetesën e një kulture të caktuar. Prej kohësh është pranuar fakti që gjuhët diktojnë mënyrën tonë të të parit të botës, qëndrim që është konsoliduar nën ombrellën e determinizmit linguistik, njohur ndryshe edhe me emrin hipoteza e Sapir-Whorf-it, hipotezë sipas së cilës struktura gjuhësore *determinon* këndvështrimin për botën.

Përkundër qasjes së gjuhësisë autonome¹, qasja sociolinguistike i mëshon faktit që gjuha nuk mund të studiohet në mënyrë të pavarur nga shoqëria në të cilën ajo gjëllin. (Shih Newman 1987, 105). Në të njëjtën hulli nga perspektiva e teorisë kritike Watson-Gegeo dhe Gegeo (1999), theksojnë se gjuha është qendrore për mënyrat kulturore të të menduarit: “gjuha është themelore për identitetin, autenticitetin, mbijetesën kulturore për proceset e të menduarit dhe të mësuarit të njerëzve” (25).

Gjuhët janë pjesë themeltare e trashëgimisë kulturore dhe intelektuale ku është depozituar gjithë universi botëkuptimor e kulturor i njerëzimit. Në këtë pikëpamje gjuha duhet konsideruar si e mirë kulturore. Çdo gjuhë si e mirë kulturore gëzon funksion të dyfishtë, funksionin instrumental dhe funksionin simbolik. Gjuha kryen funksionin instrumental teksa shërben si mjet komunikimi për komunitetin e folësve, ndërsa funksion simbolik, teksa shërben si “emblemë grupi, simbol dhe pikëtakim psiko-social” (Edward 2009, 55). Gjuhët, duke u sendërtuar si konstrukte sociale, shenjojnë identitetin kolektiv të një grupi të ngushtë brenda komunitetit, por edhe më tej identitetin e gjithë kombit.

[europe-at-the](https://european-council.europa.eu/media/1680a80ab8/attachment/data/file/1680a80ab8)

⁹ <https://rm.coe.int/booklet-for-member-states-eng-2023-def/1680a80ab8>

sinergji ndërmjet autoriteteve kombëtare, rajonale dhe lokale dhe një gamë të gjerë shoqatash dhe aktorësh socio-ekonomikë.

Në vitin 2022, numërohen 48 Itinerare Kulturore të Këshillit të Evropës, me tema shumë të ndryshme që ilustrojnë kujtesën, historinë dhe trashëgiminë evropiane dhe kontribuojnë në një interpretim të diversitetit të Evropës së sotme.

Programi Rrugët Kulturore të Këshillit të Evropës u lançua në vitin 1987 për të demonstruar, nëpërmjet udhëtimeve nëpër hapësirë dhe kohë, se si trashëgimia e vendeve të ndryshme në Evropë kontribuon në një trashëgimi kulturore të përbashkët. Programi vepron si një kanal për dialogun ndërkulturor dhe promovon njohuri dhe kuptim më të mirë të identitetit kulturor evropian, duke ruajtur dhe përmirësuar trashëgiminë natyrore dhe kulturore si burim i zhvillimit kulturor, social dhe lokal.

Në vitin 2010, u krijua Marrëveshja e Pjeshme e Zgjeruar për Rrugët Kulturore (EPA) e Këshillit të Evropës për të forcuar programin politikisht dhe financiarisht. EPA, bazuar në kriteret e përcaktuara nga Rezoluta e Komitetit të Ministrave CM/Res (2013) 67, jep certifikatën “Itinerar Kulturor i Këshillit të Evropës” gjatë takimeve të Bordit të saj Drejtues. Çdo vit në vjeshtë, gjatë një Forumi Vjetor Këshillimor, Shtetet anëtare të EPA-s dhe Itineraret Kulturore, si dhe organizatat ndërkombëtare, organizatat joqeveritare dhe ekspertët ndërkombëtarë takohen për të diskutuar çështjet dhe tendencat aktuale dhe për të eksploruar praktikat më të mira.

Misionet dhe përfitimet e Marrëveshjes së Pjeshme të Zgjeruar për Rrugët Kulturore janë: a) promovimi i identitetit dhe qytetarisë evropiane; b) rritja e ndërgjegjësimit për trashëgiminë, edukimin, rrjetëzimin, turizmin ndërkufitar cilësor dhe të qëndrueshëm dhe aktivitete të tjera të ngjashme; c) forcimi i dimensionit demokratik të shkëmbimit kulturor dhe turizmit nëpërmjet përfshirjes së rrjeteve dhe shoqatave bazë, autoriteteve lokale dhe rajonale, universiteteve dhe organizatave profesionale; ç) certifikimi i Itinerareve të reja Kulturore dhe vlerësimi i itinerareve aktuale. d) këshillimi dhe asistenca për ekspertët lidhur me zhvillimin, zbatimin, vlerësimin dhe promovimin e Rrugëve Kulturore në shtetet anëtare (dokumentet e hartës së vendeve, raportet tematike); dh) organizimi i një Forumi Vjetor Këshillimor mbi Rrugët Kulturore për një temë apo çështje

kyçe me anë të të cilit mbështet rrjetëzimin dhe shkëmbimet ndërmjet shteteve anëtare, organizatave ndërkombëtare si Organizata Botërore e Turizmit (UNWTO), Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (UNESCO), Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), institucionet evropiane, rrugët kulturore, operatorët dhe palët e tjera kyçe të interesit; e) mbështetje politike për Rrugët Kulturore dhe kandidatët për certifikim; ë) zhvillimi i metodave dhe standardeve të reja në lidhje me Itineraret Kulturore dhe turizmin në përgjigje të sfidave të shoqërive moderne; f) organizimi i trajnimeve për shtetet anëtare, palët e interesuara kombëtare dhe rajonale dhe operatorët e Itinerareve Kulturore; g) centralizimi dhe maksimizimi i komunikimit dhe dukshmërisë në programin e Itinerareve Kulturore, aktivitetet dhe arritjet e tij; gj) rritja e financimit dhe mundësive për anëtarësimin në Itineraret Kulturore përmes një etikete të fortë certifikimi cilësor.

Rrugët kulturore vlerësohen rregullisht nga EPA dhe certifikohen nga Këshilli i Evropës bazuar në përputhje me disa kritere. Ato duhet: a) të përfshijnë një temë që është përfaqësuese e vlerave evropiane dhe e përbashkët për të paktën tre vende në Evropë; b) të jenë subjekt i kërkimit shkencor ndërkombëtar, multidisiplinor; c) të përmirësojnë kujtesën, historinë dhe trashëgiminë evropiane dhe të kontribuojnë në interpretimin e diversitetit të sotëm të Evropës; ç) të mbështesin shkëmbimet kulturore dhe arsimore për të rinjtë; d) të zhvillojnë projekte shembullore dhe inovative në fushën e turizmit kulturor dhe zhvillimit të qëndrueshëm kulturor; dh) të zhvillojnë produkte dhe shërbime turistike që synojnë grupe të ndryshme.

Programi Itineraret Kulturore të Këshillit të Evropës është një mjet për të ruajtur dhe vlerësuar trashëgiminë kulturore në të gjithë Evropën. Programi mund të shihet si plotësues i nismave të tjera të dedikuara për promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore, si Lista e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s dhe Etiketa e Trashëgimisë Evropiane. Në mënyrë të veçantë, programi Itinerare Kulturore përfshin parimet e mëposhtme: a) një fokus në destinacionet më pak të njohura, që mundëson një zhvillim më të ekuilibruar lokal dhe rajonal, pasi 90% e Rrugëve Kulturore, që përshkojnë 47 shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, janë zona rurale; b) përfshirja e vendeve të shumta, e cila ofron më shumë mundësi për zhvillimin e grupeve evropiane të

turizmit kulturor dhe angazhimin e një numri të madh të aktorëve lokalë; c) një natyrë vërtet transnacionale; secila rrugë ka anëtarë në të paktën tre vende, gjë që nxjerr në pah vlerat e përbashkëta evropiane; d) një theks në një qasje nga poshtë-lart për menaxhimin kulturor, pasi Rugët Kulturore iniciohen dhe menaxhohen nga rrjete të përbëra nga aktorë të ndryshëm publikë dhe privatë, në vend të qeverive.

Rugët Kulturore të Këshillit të Evropës janë rrjete evropiane me status ligjor (në formën e një shoqate ose një federate) dhe për këtë arsye ato funksionojnë si organizata të menaxhuara në mënyrë të pavarur dhe mund të aplikojnë për financim nga një sërë programesh evropiane dhe rajonale.

Rugët Kulturore të Këshillit të Evropës luajnë një rol të rëndësishëm për: i. zhvillimin e qëndrueshëm të OKB-së, si krijimi i mundësive më të mira për arsim dhe mësim, ndërmarrja e veprimeve për të luftuar ndryshimet klimatike, promovimi i konsumit dhe prodhimit të përgjegjshëm dhe ndërtimi i komuniteteve më të qëndrueshme në të gjithë Evropën; ii. zhvillimi i grupimeve në nivel lokal, rajonal, kombëtar dhe evropian, duke përfshirë operatorët kulturorë, ofruesit e shërbimeve turistike, institucionet kërkimore, organizatat joqeveritare dhe autoritetet publike; iii. angazhimin e komunitetit duke krijuar ekosisteme të forta lokale në të cilat partnerët mund të marrin pjesë në mënyrë aktive në ofrimin dhe zhvillimin e përvojave autentike kulturore; iv. ngritja e kapaciteteve dhe transferimi i njohurive, falë trajnimeve dhe rrjeteve universitare evropiane; v. diversifikimi i ofertës turistike duke zbatuar produkte të reja turistike, duke krijuar shikueshmëri shtesë për vendet e largëta dhe duke zgjatur sezonin turistik; vi. nxitja e krijimtarisë kulturore dhe sipërmarrjes dhe krijimi i ofertave unike kulturore për të bërë më atraktive sitet e trashëgimisë duke eksploruar potencialin ekonomik të turizmit kulturor. Turizmi është aktiviteti i tretë më i madh ekonomik në Evropë; mallrat dhe shërbimet turistike përbëjnë 10% të produktit të brendshëm bruto të Evropës, ndërsa 12% e punësimit lokal është i lidhur me shërbimet turistike.

2. Itinerare në të cilat bën pjesë Shqipëria

Në Itineraret Kulturore të Këshillit të Evropës, Shqipëria është anëtare e katër itinerareve, që përshkojnë shtete të ndryshme në 3 kontinente dhe që synojnë promovimin e të shkuarës historike, kulturore dhe arkitekturore. Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar më datë 2 Shkurt 2022 projektligjin për “Marrëveshjen e pjesshme të zgjeruar për rrugët kulturore, miratuar me rezolutën CM/RES (2013) 66”.

Rrugët në të cilat Shqipëria është pjesë janë përmendur si më poshtë:

Itinerari e Eneas, 2021, është një itinerar arkeologjik që nis nga Turqia dhe lidh pesë vende evropiane dhe mesdhetare nëpërmjet legendës së Eneas. Gjatë shekujve, rrëfimi i Eneas është bërë një trashëgimi e përbashkët kulturore që bashkon vende dhe qytetërime të ndryshme mesdhetare dhe është subjekt i pikturave, mozaikëve, skulpturave dhe veprave të panumërta arti. Duke filluar nga zonat arkeologjike të Trojës dhe Antandros (Turqi) dhe duke përfunduar në Romë (Itali), itinerari bashkon një sërë peizazhesh rurale, zona natyrore dhe zona arkeologjike, disa prej të cilave janë të njohura dhe të regjistruara në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s. Situata aktuale. Itinerari e Eneas u ofron udhëtarëve të sotëm perspektivën e një zbulimi aventuresk të trashëgimisë së përbashkët arkeologjike dhe kulturore evropiane. Duke udhëtuar përgjatë Itinerarit të Eneas, vizitorët mund të eksplorojnë destinacione jashtë pistave përmes alternativave të qëndrueshme të udhëtimit, duke filluar nga turizmi detar, i natyrës dhe i peizazhit deri tek ecja dhe turnetë me guida.

ATRIUM, 2003, Arkitektura e regjimeve totalitare të shekullit të 20-të në kujtesën urbane të Evropës (2014). Regjimet totalitare që karakterizuan pjesën më të madhe të Evropës në dekadat qendrore të shekullit të njëzetë patën një ndikim të rëndësishëm në peizazhin urban. Këto regjime themeluan dhe rindërtuan qytete, shpesh duke përdorur projektet më të avancuara arkitekturore dhe urbanistike të kohës. Sot, ndërsa Evropa demokratike i kundërshton me vendosmëri këto regjime totalitare, trashëgimia e tyre arkitekturore mbetet në rrugët tona si një trashëgimi e pakëndshme por e patjetërsueshme. Nëpërmjet rrugës Kulturore ATRIUM eksplorohej kompleksiteti sociologjik, ideologjik dhe gjeografik të historisë së këtyre regjimeve,

parë përmes këndvështrimit të peizazheve urbane të qyteteve të ndryshme. Udhëtari mund të gjejë informacion të detajuar rreth vendeve të ndryshme online të mbështetur nga burime të tilla si fotografi dhe imazhe, video, skedarë audio dhe dëshmi të dhëna me gojë.

Itinerari i Ullinjve, 2014, (Itinerar kulturor i Këshillit të Evropës i certifikuar në vitin 2005), prania e pemës së ullirit ka shënuar jo vetëm peizazhin, por edhe jetën e përditshme të popujve mesdhetarë. Itineraret e Pemës së Ullirit përsërisin gjurmët e Qytetërimit të Ullirit, nga Greqia në vendet euro-mesdhetare. Shtetet që përfshihen në të janë: Shqipëria, Algjeria, Kroacia, Franca, Greqia, Italia, Libani, Mali i Zi, Maroku, Portugalia, Republika e Maqedonisë së Veriut, Sllovenia, Spanja, Tunizia, Turqia. Udhëtari sot mund të prekë qytetërimin e pemës së ullirit dhe të vlerësojë peizazhin, produktet dhe traditat e tij. Ka itinerare të ndryshme kulturore që përshkojnë vendet e Evropës Jugore dhe Afrikës Veriore, nga Ballkani në Peloponez në Greqi, deri në rajonin e Meknes në Marok. Ka edhe itinerare nga deti, për të nënvizuar lidhjen e rëndësishme detare mes qyteteve portuale të Mesdheut. Aktivitete të ndryshme në lidhje me pemën e ullirit organizohen përgjatë itinerareve, me ekspozita, koncerte dhe degustime.

Itinerari i Fenikasve (2003) i referohet rrugëve të mëdha të lundrimit, të cilat, nga shekulli i 12-të para Krishtit, u përdorën nga fenikasit, lundëtarë dhe tregtarë të mëdhenj, për tregti dhe komunikim në të gjithë Mesdheun. Në kohët e lashta, përmes këtyre rrugëve, fenikasit dhe qytetërimet e tjera të mëdha të Mesdheut kontribuan në lindjen e një komuniteti kulturor mesdhetar. Qytetet e Mesdheut dikur ishin vendndalimi i udhëtarëve të Itinerarit të Fenikasve, që përdoreshin për të shkëmbyer njohuri dhe përvoja. Në këtë kuptim, përvoja e udhëtimit sot, përgjatë Itinerarit të Fenikasve synon ti tregojë udhëtarit rrugët tona të përbashkëta, duke lidhur vendet në tre kontinente dhe mbi 100 qytete që kanë origjinën nga qytetërimet e lashta të Mesdheut.

Këto itinerare të përbashkëta, sigurojnë promovimin, shkëmbimin kulturor por edhe thithjen e fondeve, si dhe përmirësimin e plotë të infrastrukturës që përshkojnë duke sjellë zhvillimin e komuniteteve në këto zona.

3. Sugjerime të Itinerareve në të cilët mund të përfshihet Shqipëria

Itinerari Evropian i Trashëgimisë Hebraike

Si pjesë integrale e qytetërimit evropian, populli hebre ka dhënë dhe jep një kontribut unik dhe të qëndrueshëm në zhvillimin e tij përgjatë mijëvjeçarëve deri më sot. Programi Itineraret Kulturore është një mënyrë inovative dhe emocionuese për të sjellë këtë histori të jashtëzakonshme në vëmendjen e një publiku më të gjerë. Trashëgimia hebraike evropiane është gjerësisht e pranishme në të gjithë Evropën. Shembuj të dukshëm përfshijnë vendet arkeologjike, sinagogat dhe varrezat historike, banjat rituale, lagjet hebraike, monumentet dhe memorialët. Për më tepër, disa arkiva dhe biblioteka, si dhe muze të specializuar kushtuar studimit të jetës hebraike, përfshihen në rrugë. Ky itinerar nxit kuptimin dhe vlerësimin e artefakteve fetare dhe të përditshme, si dhe njohjen e rolit thelbësor të luajtur nga populli hebre në historinë evropiane.

Nga fundi i shekullit të XII p.e.s. shumë ilirë u shpërngulën nga gadishulli Ilirik dhe zunë vend në Azinë e Vogël. Ndër këto fise përmenden Pelesët, të cilët u vendosën në bregdetin jugor të Sirisë, prej nga mendohet se edhe vendi mund të ketë marrë emrin Palestinë. Autorë të tjerë, si Zaharia Majani, për shembull, thotë se “është përcaktuar që filistinët i përkasin trungut ilir”. Emrin e këtij populli e gjejmë nën emërtime të ndryshme në perëndim, por gjithmonë duke u mbështetur në prejardhjen ilire. Historianët Meillet dhe Kohen përmendin se në Epir (Iliri) ka ekzistuar dikur qyteti Paleiste – Palasa e sotme në Himarë të Vlorës.

Emigrimet e ndërsjellta iliro-hebraike kanë lënë gjurmë të shumta tek njëri-tjetri. Në një hartë të vjetër të Izraelit gjenden të fiksuara emra ilirë. Po kështu, në Dhiatën e Vjetër ka emra filistinë. Edhe hebrenjtë e lashtë kanë lënë gjurmë në Iliri. Emrat Finiq ose Jerikon nuk janë të rastit. Dijetarët e kohës mendojnë se këto emra përkojnë me emratë lidhur historikisht me Izraelin, për shembull, Finiq nga Fonikë e lashtë, Jerikoja me Jerikon e Biblës, Palasa me Palestinën.

Sa më sipër, duke vlerësuar dhe trashëgiminë arkeologjike në të gjithë territorin e Shqipërisë por më së shumti në rajonin e jugut me sinagogën e Onhezmit (Sarandë), e ndërtuar në shek. V, e cila është nga më të vjetrat në Ballkan, mendojmë se kjo do të ishte një pikënisje

për ta përfshirë dhe Shqipërinë në Itineraret Evropiane të Trashëgimisë Hebraike.

Por Shqipëria mund të jetë pjesë e shumë itinerareve të tjera si Itinerari Iter Vitis Route. Gjithashtu mund të kërkohet certifikimi për itinerare të reja si: Itinerari i vendeve të Evropës ku ka jetuar Nënë Tereza, Rruga Egnatia, Rruga e dytë Egnatia, Republika e Venecias Serenissima¹⁰, Skënderbeu dhe marrëdhënia e tij me vendet e Evropës, me Papën dhe Selinë e Shenjtë, me Kurorën e Aragonës etj¹¹.

4.

Sikurse është përmendur edhe më sipër Itineraret Kulturore të Këshillit të Evropës u krijuan në vitin 1987 për të përfaqësuar vlerat evropiane, për të qenë manifestimi i idesë “të bashkuar në diversitet”. Megjithatë, trashëgimia kulturore evropiane dhe jo vetëm vuan nga mungesa e njohjes nga publikut i gjerë dhe në këtë kontekst lind pyetja nëse kjo njohje mund të fillojë nga ndërgjegjësimi i të rinjve?

Pasi jemi përpjekur të përcaktojmë nëpërmjet këtij punimi se çfarë është trashëgimia evropiane dhe cilët janë Itineraret Kulturore të Këshillit të Evropës (duke përfshirë edhe ato ku bën pjesë Shqipëria) do të mundohemi të japim një panoramë se si e shohin evropianët shkëmbimin kulturor, cilat janë disa nga mënyrat nëpërmjet të cilave mund të realizojmë një informim të popullatës e sidomos të të rinjve mbi Itineraret dhe trashëgiminë Kulturore, si mund ta përmirësojmë bashkëpunimin ndërmjet vendeve etj.

Duke ju referuar Raportit Eurobarometrit 466¹² mbi kulturën evropiane, të realizuar në vitin 2017, të anketuarve iu kërkua mendimi i tyre nëse: a) Kultura dhe shkëmbimet kulturore duhet të kenë një vend shumë të rëndësishëm në BE, në mënyrë që qytetarët nga shtete të ndryshme anëtare të mësojnë më shumë nga njëri-tjetri dhe të ndjehen më evropianë; b) Kultura dhe shkëmbimet kulturore mund të luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e mirëkuptimit dhe tolerancës më të madhe në botë, edhe kur ka konflikte ose tensione.

Nga rezultatet vihet re se 84% pajtohen me mendimin se kultura dhe shkëmbimet kulturore duhet të kenë një vend shumë të rëndësishëm

¹⁰ https://it.wikipedia.org/wiki/Repubblica_di_Venezia

¹¹ <http://asa.edu.al/site/?p=4425>

¹² https://data.europa.eu/data/datasets/s2150_88_1_466_eng?locale=en

në BE në mënyrë që qytetarët nga shtete të ndryshme anëtare mund të mësojnë më shumë nga njëri-tjetri dhe të ndjehen më evropianë. Ndërsa pothuajse 82% pajtohen se kultura dhe shkëmbimet kulturore mund të luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e mirëkuptimit dhe tolerancës më të madhe në botë, edhe aty ku ka konflikte ose tensione. Nëse këto shifra do t'i krahasojmë me anketimin e 2007-ës ka pasur një rënie prej 6% nga ata që pajtohet me pyetjen e parë dhe një rënie prej 5 % me pyetjen e dytë. Edhe pse nga ky anketim rezulton se me shume se $\frac{3}{4}$ e të anketuarve në çdo shtet anëtar të BE-së janë dakord se kultura dhe shkëmbimet kulturore duhet të zënë një vend kryesor përsëri duhet të tregojmë kujdes në mënyrë që këto shifra mos të ndjekin një trend në zbritje.

Disa nga metodat më të mira që duhen ndjekur në nivel akademik dhe në kërkimin shkencor për të përmirësuar shifrat e anketimit të ardhshëm:

- Përmirësimi i kurrikulës universitare;
- Përdorimi i rrjeteve sociale - janë një realitet në shoqëritë globale dhe kanë fuqinë të ndikojnë në të gjitha aktivitetet njerëzore, sidomos në fushën e kulturës dhe arsimit;
- Pjesëmarrja e studentëve në programet Erasmus+.

Përfundime

Kur është fjala për hulumtimin shkencor, në filozofinë e historisë bëhet qysh në krye një dallim: qëllimi i çdo hulumtimi të tillë është, nga njëra anë, të njohurit, nga tjetra, të kuptuarit e fenomeneve. E njohim një fenomen atëherë kur ia përftojmë shëmbëlltyrën në mendjen tonë; e kuptojmë atë fenomen atëherë kur përftojmë shkakun e shfaqjes së tij të veçantë të të ekzistuarit.¹³

Rëndësia e njohjes së Itinerareve Kulturore të Këshillit të Evropës për vendin tonë është themelore. Me anë të këtyre itinerareve kemi mundësinë të vëmë në dukje vlerat kulturore, pasuritë materiale dhe jo materiale të vendit tonë. Nëpërmjet tyre ne shprehim afërsinë tonë gjeografikisht por edhe kulturalisht me Evropën. Si rrjedhojë, promovimi i itinerareve të reja për vendin tonë është thelbësore në

¹³ Plasari A. (2000), *Fenomeni Voskopojë*

momentin kur Shqipëria synon anëtarësimin e saj të plotë në strukturat e BE-së.

Mënyrat e promovimit variojnë dhe duhet të diversifikohen vazhdimisht me qëllim që të jenë efikase. Një promovim i mirë, sjell fryte në kohën e duhur.

BIBLIOGRAFIA

Bakiu V., *Manaxhimi i turizmit*, Botimet Erik, fq. 87

Bakiu V. (2011), *Ekonomia e Turizmit*, Botimet Erik, fq. 381-382

SITOGRAFIA

<https://en.wikipedia.org/wiki/Albania>

<https://www.treccani.it/enciclopedia/repubblica-di-venezia/>

https://it.wikipedia.org/wiki/Repubblica_di_Venezia

<http://asa.edu.al/site/?p=4425>

<https://www.un.org/en/about-us/main-bodies>

<https://www.un.org/securitycouncil/>

<https://rm.coe.int/booklet-for-member-states-eng-2023-def/1680a80ab8>

<https://www.un.org/pga/76/2022/02/14/reception-on-the-occasion-of-the-beginning-of-albanias-term-at-the-security-council/>

<https://www.coe.int/en/web/cultural-routes/-/albania-lebanon-and-north-macedonia-welcomed-as-new-member-states-of-the-enlarged-partial-agreement-on-cultural-routes-of-the-council-of-europe-at-the>

<https://tradingeconomics.com/albania/surface-area-sq-km-wb-data.html>

https://data.europa.eu/data/datasets/s2150_88_1_466_eng?locale=en

RUAJTJA E TRADITAVE KULTURORE TEK GRUPET BILINGUALE – RASTI I EMIGRANTËVE SHQIPTARË NË GJERMANI

Prof. asoc. Dr. JONIDA BUSHI (GJUZI)

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Universiteti i Tiranës

jonida.bushi@unitir.edu.al

Prof.asoc. Dr. EMA KRISTO

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Universiteti i Tiranës

ema.kristo@unitir.edu.al

ABSTRACT

Learning a second or even third language does not consist only of learning a foreign vocabulary or communicating with a group that does not speak your language. Bilingualism or multilingualism is today the most efficient way to connect the new generation in whatever society this generation lives and integrates. The preservation and cultivation of identity is realized through language and culture. Many families leave their country and create a new life in another country. Their children grow up between two different cultures, that of the “parents’ home culture” and that of the new country. Most children grow up with two languages. Our interest in this article is in the study of how knowledge of culture facilitates the process of learning and teaching a language. How and to what extent are cultural traditions preserved in bilingual groups? We will specifically focus on the case of children of Albanian immigrants in Germany. How are the Albanian language and traditions preserved in these groups? In Europe in particular, the topic of integration and emigration of people from third countries and the intercultural education that is inevitably related to them is increasingly being discussed. Multiculturalism is creating an exchange between different cultures and thus strengthening the coexistence of a society. Intercultural education and the promotion of bilingualism are playing an increasingly important

role. Intercultural education goes beyond the promotion of bilingualism and is also related to the transmission of values, customs, traditions and religion.

Keywords: Bilingualism, multilingualism, intercultural education, culture, learning and teaching a language

Mësimi i një gjuhe të dytë apo edhe të tretë, nuk konsiston vetëm në të mësuarit e një fjalori të huaj apo komunikimin me një grup që nuk flet gjuhën tënde. Bilinguizmi apo multilinguizmi është sot mënyra më efikase për përgatitjen e brezit të ri në çfarëdo shoqërie që ky brez jeton dhe integrohet. Ruajtja dhe kultivimi i identitetit bëhet, përveç gjuhës, edhe përmes kulturës. Shumë familje largohen nga vendi i tyre dhe krijojnë një jetë të re në një vend tjetër. Fëmijët e tyre rriten mes dy kulturave të ndryshme, asaj të “kulturës së shtëpisë së prindërve” dhe asaj të vendit të ri. Shumica e këtyre fëmijëve rriten me dy gjuhë. Interesi ynë në këtë artikull qëndron në hulumtimin se si njohja e kulturës lehtëson procesin e nxënies dhe mësimin të një gjuhe. Si dhe sa ruhen traditat kulturore në grupet bilinguale? Do të fokusohemi konkretisht tek rasti i fëmijëve të emigrantëve shqiptarë në Gjermani. Si ruhen gjuha dhe traditat shqiptare në këto grupe?

Në Evropë në veçanti, tema e integritit dhe emigrimit të njerëzve nga vendet e treta dhe edukimi ndërkulturor që lidhet pashmangshmërisht me to po diskutohet gjithnjë më shumë. Multikulturalizmi po krijon një shkëmbim midis kulturave të ndryshme dhe në këtë mënyrë forcon bashkëjetesën e një shoqërie. Edukimi ndërkulturor dhe promovimi i dygjuhësisë po luajnë një rol gjithnjë e në rritje. Edukimi ndërkulturor shkon përtej promovimit të dygjuhësisë dhe lidhet gjithashtu me transmetimin e vlerave, zakoneve, traditave dhe fesë.

Në Gjermani jeton dhe punon gjenerata e dytë e emigrantëve shqiptarë të cilët kanë migruar apo kanë shkuar në vitet e 90-të si punëtorë.¹ Duke marrë për bazë se gjuha është mjet komunikimi

¹ Diaspora në Gjermani: Shqiptarët nga Kosova dhe viset e tjera shqiptare emigruan në Gjermani pas vitit 1971, me heqjen e vizave dalëse nga ish Jugosllavia. Pas vitit 1990 drejt Gjermanisë migruan dhjetëra mijëra shqiptarë nga Shqipëria. Numri i emigrantëve shqiptarë në Gjermani ka ndryshuar me ritme të tjera nga ato të Italisë, Greqisë dhe ShBA-ve. Gjatë viteve 1990 – 1994 ky numër rritej me rreth 10 % në vit. Më pas norma vjetore e rritjes u zvogëlua në mënyrë konstante duke arritur në rreth 1 % përgjatë periudhës 2010 – 2014. Vetëm pas vitit 2015, numri i emigrantëve shqiptarë në Gjermani filloi të rritej me një normë vjetore prej rreth 35 %, duke e kthyer këtë vend si destinacionin kryesor të tyre. Kjo ka bërë që pesha që zënë emigrantët shqiptarë në Gjermani

dhe karakterizohet me përdorimin e simboleve arbitrare të folura ose të shkruara me një kuptim të caktuar, atëherë shtrohet pyetja si qëndron situata me gjuhën amtare shqipe te këta fëmijë të cilët janë lindur, rritur dhe shkolluar në Gjermani, me një kulturë dhe me një gjuhë tjetër të dytë? Çfarë nënkuptojmë me termin gjuhë amtare? Sa të sigurt dhe kompetent ndihen fëmijët e emigrantëve tanë jashtë vendit me theks të veçantë, ata që jetojnë dhe punojnë në Gjermani, gjatë përdorimit të gjuhës amtare shqipe dhe asaj gjermane?

Fëmijët e ardhur apo ata që lindin në Gjermani kanë të drejtën të mësojnë dhe flasin “gjuhën e tyre të nënës”. Në rastin e të ardhurve nga Shqipëria, fëmijët me prindër shqiptarë mund të mësojnë shqip, një mundësi kjo e krijuar ligjërisht nga disa lande përkatëse nëpër shkollat fillore dhe tetëvjeçare. Mësimi i gjuhës shqipe, i cili është jo i detyrueshëm, por thjesht një mësim mbi baza vullnetare, është i shtrirë pothuajse në të gjithë Gjermaninë. Shkollat e para të mësimi plotësues në gjuhën shqipe në Gjermani janë hapur në vitet 70 me ardhjen e emigrantëve të parë nga Ish Jugosllavija.²

Një rol të madh në drejtim të tërheqjes së fëmijëve me prejardhje shqiptare drejt mësimi të gjuhës amtare, ka luajtur *Këshilli i Arsimitarëve të Shqipes në Gjermani*. Ky organ profesional me përvojë tashmë gati 30 vjeçare ka si qëllim të bashkojë të gjithë mësuesit shqiptarë nga ana profesionale dhe të koordinojë bashkëpunimin me Institucionet përkatëse në Shqipëri dhe Kosovë. Në Mësimin e *Gjuhës së Prejardhjes*³ siç quhet sot, nxënësit mësojnë gjuhën, kulturën dhe traditat e vendit të origjinës. Programet mësimore janë të përcaktuara sipas kompetencave të mësimi të gjuhës amtare në bazë të standardeve evropiane. Mbi këtë koncept janë hartuar edhe kurrikulat e gjuhës shqipe, që janë të zbatuara në programet dhe tekstet mësimore. Krahës mësimi të gjuhës shqipe, mësuesit janë edhe aktivistë të jashtëzakonshëm në ruajtjen e traditës dhe kulturës kombëtare shqiptare, duke krijuar një urë lidhëse mes dy vendeve, Gjermani-Shqipëri. Në shumë aktivitete nuk mungojnë veshjet e bukura me kostumet kombëtare të vajzave valltare që shfaqen në çdo festë apo aktivitet kulturor. Përvetësimi i

në numrin gjithsej të emigrantëve të katërfishohet nga 1,3 % në 4,2 %. (<http://www.instat.gov.al/media/7848/diaspora-ne-shifra-2020.pdf>) (f.17)

² <https://sot.com.al/opinione/migracioni-ne-gjermani-dhe-sfidat-e-femijeveshqiptar>

³ *Herkunftsspracheunterricht*

gjuhës amtare mbetet një nga sfidat më të mëdha për fëmijët shqiptarë, pasi ai është i rëndësishëm edhe për statusin social të individit. Njohja e gjuhës shqipe do të thotë jo vetëm njohja e vendit të origjinës, por edhe ruajtja e lidhjeve familjare, ruajtja e kulturës dhe traditave.

Kielhöfer/Jonekeit theksojnë se rrallëherë një person i flet të dyja gjuhët, pra gjuhën amtare dhe gjuhën e huaj (të vendit ku jeton) në mënyrë të barabartë. Në shumicën e rasteve ka një çekuilibër midis dy gjuhëve. Prandaj, bëhet një dallim midis “gjuhës së fortë” dhe “të dobët”.⁴ Zhvillimi i *gjuhës së dobët* dhe *të fortë* varet nga shumë faktorë dhe karakterizohet nga një rrjet marrëdhëniesh shkak-pasojë. Faktorë të tillë përfshijnë mënyrën se si përdoret një gjuhë dhe intensiteti me të cilin përdoret ajo. Po aq e rëndësishme janë koha e mësimi dhe praktika e mëvonshme në atë gjuhë. Nuk duhen lënë pas dore gjithashtu arsyet emocionale, sociale dhe personale. Klasifikimi i gjuhës *së fortë* dhe *të dobët* bazohet në një model të thjeshtë shpjegues: në përgjithësi, gjuha e zotëruar më mirë është *gjuha e fortë*. Prandaj, kjo gjuhë preferohet dhe për këtë arsye flitet më shpesh. Anasjelltas, *gjuha e dobët* përdoret më rrallë, kështu që praktikohet më pak.⁵ Por në fakt, dallimi midis *gjuhës së fortë* dhe *të dobët* është i paqartë. Sepse personi dygjuhësh rrallë ka një zgjedhje të lirë të gjuhës. Faktorët specifikë të situatës shpesh përcaktojnë zgjedhjen e gjuhës, të tilla si takimi me miqtë e vjetër të shkollës ose aftësia për të komunikuar shpejt në një situatë të caktuar. Një çështje që nuk duhet neglizhuar është kuadri kulturor në të cilin rriten fëmijët dygjuhësh. Ndërgjegjësimi për gjuhën përkatëse krijohet vetëm nëpërmjet përkatësisë kulturore. Më pas varet nga forca e rrënjëve kulturore nëse kjo gjuhë do t’u kalohet brezave të mëpasshëm apo do të shmanget.⁶ Në rastin e njerëzve dygjuhësh, mund të bëhet një klasifikim sipas përkatësisë kulturore dhe identitetit të tyre. Mund të thuhet se personat dygjuhësh, që identifikohen me të dy grupet kulturore dhe gjuhën e tyre, pranojnë gjithashtu si anëtarë të plotë në të dy grupet. Në këto raste, të dyja gjuhët zakonisht zotërohen njësoj mirë. Në dygjuhësinë monokulturore, të dyja gjuhët fliten mirë, por identiteti shfaqet vetëm me një grup kulturor. Grupi i përkatësisë jokulturore vërehet më së shumti te fëmijët e emigrantëve.

⁴ Kielhöfer/Jonekeit 1998: 11f

⁵ Kielhöfer/Jonekeit 1998: 12f

⁶ krh. Luchtenberg 1995: 61f

Grupi i përzgjedhur (kampioni)

Grupi i përzgjedhur për këtë punim përbëhet nga persona të cilët janë bilingualë në gjuhët shqip dhe gjermanisht. Janë përjashtuar nga ky grup personat të cilët nuk kanë prejardhje shqiptare edhe pse mund ta kenë mësuar gjuhën nëpërmjet kontakteve me shqiptarët si dhe personat që nuk janë shqiptarë, megjithëse mund të jenë martuar me shqiptarë. Pra kampioni apo grupi i përzgjedhur përbëhet nga popullsia e thjeshtë shqiptare.

Metodologjia e përdorur në studim është gërshtimi i metodologjisë sasiore dhe cilësore. Kampionimi i përdorur është një ndërthurje e kampionimit të qëllimshëm dhe atij në formë orteku. Personat bilingual të këtij studimi kanë referuar persona të tjerëpobilingual. Për mbledhjen e të dhënave janë përdorur si instrument pyetësorët e strukturuar dhe intervistat gjysmë të strukturuar.

Metodat e përdorura për mbledhjen e të dhënave

Bazën kryesore për të mbledhur të dhëna e përbëjnë intervistat. Ato ndahen në: *intervista në grup* dhe *intervista individuale*. Intervistat në grup kishin si qëllim të konstatonin ruajtjen e kulturës, traditave, dokeve dhe zakoneve shqiptare. Instrumenti më thelbësor në këtë punim është intervistat individuale e organizuar me bazë pyetësorin. Pyetjet e pyetësorit janë të standartizuara dhe kjo lehtësoi që shumë përfundime të paraqiten në formë tabelare. Takimet me shqiptarët bilingualë na u mundësuan nëpërmjet kontakteve të shumta personale. Intervistat në grup u organizuan jo vetëm në shtëpitë e shqiptarëve të atjeshëm, por edhe në vende publike si kafene apo në ndonjë shoqatë shqiptare. Me anë të intervistave në grup morëm informacione të hollësishme mbi organizimin social dhe aktivitetet kulturore të popullsisë shqiptare së atjeshme. Intervistat individuale morën më shumë kohë dhe përbëjnë edhe bazën e këtij punimi. Vizitat janë bërë në lande të ndryshme të Gjermanisë dhe puna në terren ka zgjatur rreth një muaj.

Intervistat

Në anketim morën pjesë 80 persona bilingual nga qyteti i Mynihut në landin e Bavarisë, Hamburgut, Dyseldorfit dhe Berlinit, të cilët i përkasin grupmoshës 14-19 vjeç. Të gjithë të intervistuarit flasin shqip dhe gjermanisht. Pyetësorët përbëhen nga dy pjesë. Të intervistuarve iu dha mundësia të bënin intervistën në gjermanisht ose në shqip. Në pjesën e parë të intervistave qëllimi ishte të identifikohet sfondi dygjuhësor i të intervistuarve dhe në pjesën e dytë u shtruan pyetjet që kanë të bëjnë me identitetin kulturor të tyre.


Në lidhje me përdorimin e gjuhës u formuluan tre hipotezat e mëposhtme:

Hipoteza 1: Të rinjtë mendojnë shpesh në gjuhën shqipe kur komunikojnë me të rinj të tjerë shqiptarë ose me prindërit e tyre.


Hipoteza 2: Të rinjtë flasin gjermanisht shumë më shpesh kur komunikojnë me të rinj gjermane apo në shkollë.

Hipoteza 3: Të rinjtë preferojnë shumë më shpesh gjuhën gjermane kur diskutojnë tema të rëndësishme për adoleshencën e tyre.


Pyetja 1: Në cilën gjuhë mendoni?




Pyetja 2: Kur flisni me prindërit tuaj, mendoni në gjermanisht apo në shqip?




Pyetja 3: Kur flisni me vëllezërit e motrat ose me të rinjtë që flasin shqip mendoni në gjermanisht apo në shqip?




Pyetja 4: Në cilën gjuhë ëndërroni?



Pyetja 5: A është e rëndësishme njohja e mirë e gjuhës shqipe për të ardhmen tuaj?




Pyetja 6: Kur flisni me të rinj gjermanë, mendoni në gjermanisht apo në shqip?




SI TA BËJMË TRASHËGIMINË TONË KULTURORE TË FLASË? – KREATIVITET DHE NDËRMJETËSIM NË NJOHJEN E TRASHËGIMISË KULTURORE”


Pyetja 7: Kur flisni me mësuesit, mendoni në gjermanisht apo në shqip?




Pyetja 8. Dy gjuhë, dy kultura - a është ky problem për ju?




Pyetja 9: Sa mirë mund të shkruani në shqip?




Pyetja 10. Sa mirë mund t’i lexoni dhe kuptoni tekstet shqipe?




Pyetja 11: Në cilën gjuhë shani apo qortoni?




Pyetja 12: Në cilën gjuhë luteni?



Pyetje 13: Sa ju pëlqen të flisni shqip?




Pyetja 14. A është e rëndësishme njohja e mirë e gjuhës shqipe për të ardhmen tuaj?




SI TA BËJMË TRASHËGIMINË TONË KULTURORE TË FLASË? – KREATIVITET
DHE NDËRMJETËSIM NË NJOHJEN E TRASHËGIMISË KULTURORE”


Pyetja 15. Në cilën gjuhë ndiheni më të sigurt?




Pyetja 16. Sa drejt flisni shqip? (Gramatika, fjalori, zhargon)



Pyetja 17. Sa saktë flisni gjermanisht? (Gramatika, fjalori, gjuha e folur, gjermanishtja standarde)



Pyetja 18. Sa mirë mund të shkruani në shqip?



Përmbajtja e përgjigjeve të pyetjeve të mësipërme paraqitet si më poshtë:

Në lidhje me pyetjet që kanë të bëjnë me “besimin gjuhësor”, të rinjtë deklarojnë dukshëm se ndihen më të sigurt në gjuhën gjermane.

Në lidhje me pyetjet që kanë të bëjnë me saktësinë gjuhësore të intervistuarit arritën në një vetëvlerësim mesatarisht më të mirë të aftësive të tyre të folurit në të katër nënfushat (gramatika, fjalori, gjuha bisedore, gjermanishtja standarde) në gjuhën gjermane.

Në lidhje me grupin e pyetjeve “Cilësia e të shkruarit në shqip” dhe “Cilësia e leximit dhe të kuptuarit në gjermanisht”, mesatarisht të intervistuarit dhanë një vetëvlerësim më të mirë për njohuritë në gjuhën gjermane.

Përvetësimi i njohurive si në gjuhën gjermane ashtu edhe në atë shqipe zhvillohet tek fëmijët apo të rinjtë nëpërmjet ndërveprimeve, pra në formën e shkëmbimit të akteve gjuhësore nëpërmjet përdorimit të vazhdueshëm të dy gjuhëve shqip dhe gjermanisht. Fëmijët/Të rinjtë bilingualë e kanë të vështirë të mësojnë gjuhën shqipe, sepse mundësitë jashtëshkollore për kontaktin me gjuhën shqipe për ta vështirë se ekzistojnë dhe për rrjedhojë përdorimi i gjuhës amtare është jashtëzakonisht i vogël. Pavarësisht mundësive të pakta, interesi dhe dëshira e fëmijëve të flasin gjuhën amtare dhe të ndjekin *Mësimin Plotësues të Gjuhës Shqipe* është i madh. Qëllimi është që fëmijët shqiptarë në Gjermani të lexojnë dhe shkruajnë një gjuhë të standarteve dhe nivele të larta, që jo vetëm ta kuptojnë, por edhe ta flasin bukur dhe rrjedhshëm gjuhën e nënës.


Rezultatet e pyetësorëve treguan se shumica e personave bilingualë kanë një gjuhë ‘të fortë’ dhe ‘të dobët’. Ky dominim gjuhësor mund të zhvendoset gjatë rrjedhës së jetës. Nëse, për shembull, shqipja është përvetësuar si gjuhë e origjinës në familje, kjo gjuhë është mbizotëruese në fëmijërinë e hershme. Sa më gjatë që fëmija të shkojë në shkollë, aq më shumë rritet ndikimi i gjermanishtes, pasi fëmija ndeshet me gjuhën gjermane në çdo hap, jo vetëm në shkollë, por edhe në jetën e përditshme. Fëmijët dhe të rinjtë dygjuhësh demonstrojnë një nivel të lartë të aftësisë së gjuhës së folur në gjuhën e tyre amtare, por shpesh shfaqin dobësi në të shkruar. E rëndësishme është që familjet emigrante të vazhdojnë të përdorin gjuhën shqipe në shtëpi si gjuhë

familjare, sepse familja është shpesh i vetmi kontakt i qëndrueshëm me gjuhën e origjinës.


Mësimet në gjuhën amtare janë gjithashtu shumë të dobishme. Fëmijët shkollohen në gjuhën e tyre amtare, mësojnë të shkruajnë e të lexojnë dhe ta përdorin gjuhën në një kontekst më të gjerë jashtë familjes. Njerëzit që rriten duke folur dy ose më shumë gjuhë, mund të kuptojnë më lehtë në kultura të ndryshme, të vlerësojnë gjuhët dhe traditat e tjera dhe kështu të kontribuojnë në një shoqëri kozmopolite. Nëse të dyja gjuhët promovohen në përputhje me rrethanat, ka perspektiva më të gjera profesionale dhe kapital më të madh kulturor.

Pjesa e dytë e intervistave ka të bëjë me ruajtjen e dukurive tradicionale shqiptare, me kodet e të qenit shqiptar. Pyetjet janë të hapura dhe qëllimi është të tregohet se çfarë lidhjesh kulturore kanë mbajtur familjet emigrante me vendin e tyre. Disa prej pyetjeve në këtë pjesë:


Pyetje 1. Cilat tradita shqiptare njihni?




Pyetje 2. Cilat festa popullore shqiptare festoni?




Pyetje 3. A njihni valle dhe këngë popullore shqiptare?




Pyetje 4. Nëse po, cilat?



Pyetje 5. A lexoni përralla shqiptare?




Pyetje 6. A i njihni ritet fetare shqiptare?




SI TA BËJMË TRASHËGIMINË TONË KULTURORE TË FLASË? – KREATIVITET
DHE NDËRMJETËSIM NË NJOHJEN E TRASHËGIMISË KULTURORE”


Pyetje 7. Kur dëgjoni muzikë, më së shumti dëgjoni muzikë nga vende të ndryshme apo muzikë shqiptare?




Pyetje 8. A ju edukuan prindërit sipas traditave shqiptare?



Pyetje 9. Cilat veshje tradicionale shqiptare njihni?



Pyetje 10. Cilat objekte tradicionale shqiptare njihni?



Gjatë intervistave në grup u konstatua se *festat, ritet dhe veprimtaritë kulturore janë* tregues i rëndësishëm i ruajtjes së identitetit. Nga shqiptarët në qytete të ndryshme të Gjermanisë festohen festa të shumta si festat e nëntorit, festa e ditës së verës etj. Dasmat dhe vdekjet bëhen sipas traditës shqiptare, aty ku komunitetet shqiptare janë më të mëdha.

Shoqata të shumta kulturore, të krijuara në Gjermani kanë emërtime shqiptare. Këto shoqëri kulturore, zhvillojnë aktivitete të shumta, të cilat shpesh i zhvillojnë në bashkëpunim me njëra tjetrën, si në Europë, Amerikë apo në vendet e Lindjes. Është vërejtur se në disa familje mbahet simboli i shqiponjës, përkrenarja e Skënderbeut, punime artistike të kalave shqiptare (Krujë, Berat, Gjirokastër etj), si dhe shumë simbole të hershme, figura të mitologjisë shqiptare, që zbukurojnë veglat muzikore popullore. Të tilla elemente kulturore flasin për lidhje me atdheun, psikologjinë dhe traditën e të parëve tanë. Jo në pak familje janë edhe simbole fetare, sipas përkatësisë. Një pjesë e këtyre simboleve janë punuar nga vetë emigrantët, por edhe janë marrë nga vendi i origjinës së tyre, në raste festash, përkujtimeve, apo vizitave në vendin e origjinës.

Traditat nëpërmjet shkollimit dhe takimeve – Emigrantët e rinj kanë shqetësimin e mësimin të gjuhës shqipe dhe kulturës sonë kombëtare. Siç e përmendëm në fillim të artikullit, në Gjermani po funksionojnë shumë shkolla për mësimin e gjuhës shqipe. Orët e mësimin me fëmijët e shqiptarëve janë vërtetë shumë interesante. Sipas të dhënave nga të

intervistuarit, fëmijët interesohen për çdo gjë që lidhet me atdheun. Përveç orëve të mësimit të gjuhës, mësuesit u tregojnë fëmijëve për bukuritë e atdheut. Ata u tregojnë atyre legjenda e tregime të bukura, të cilat ata vetë i kanë mësuar në atdhe ose në familjet e tyre. Është si një lloj stafete që gjeneratat e shqiptarëve në Gjermani ia pasojnë njëri-tjetrit. Objektet e marra me vete, shumë nga emigrantët i ruajnë si të shenjta. Fëmijët e tyre, sipas bisedave me emigrantët, donin të dinin si është ndërtuar furka e gjyshes, qebapi i kafes etj, objekte të marra me vete nga vendlindja.

Në vendet ku janë, shqiptarët kanë dëshmuar si komunitet që aspiron dhe punon për t'u integruar në shoqërinë pritëse, dhe që ruan vlera të mëdha nga origjina e tyre. Dukuritë tradicionale shqiptare, festat, tregimet dhe legjendat nga viset tona, psikologjia e ndihmës, e shoqërimit etj, janë kode të të qenit shqiptar. Shkollimi i fëmijëve në Perëndim, duke përdorur edhe gjuhën shqipe, është shenjë e mirë për ruajtjen e identitetit.

Përfundime

Ky artikull pasqyron lidhjen midis identitetit dhe gjuhës në rastin e shumëgjuhësisë së lidhur me emigracionin si pjesë e një studimi empirik. Rezultatet e hulumtimit tregojnë qartë se ekziston një lidhje e ngushtë midis gjuhës dhe identitetit dhe se të dyja ndikojnë njëra-tjetrën. Nga kjo rrjedh supozimi se çdo gjuhë e sapomësuar kontribuon në identitetin e një individi dhe bën që identiteti gjuhësor i emigrantëve të përjetohet si kompleks dhe i koduar shumëfish. Dygjuhësia dhe shumëgjuhësia e personave do të thotë që ata ndiejnë se i përkasin disa botëve gjuhësore dhe kulturore dhe pak a shumë identifikohen me të gjitha. Ata e bashkojnë këtë diversitet brenda vetes dhe për këtë arsye shfaqen si individë urë që kanë arritur të formojnë një identitet hibrid, multikulturor. Identiteti i tyre multikulturor shprehet, ndër të tjera, me ndryshimin e gjuhëve, gjë që shënon pozicionin e tyre në raport me bashkëbiseduesit e ndryshëm dhe përkatësinë e tyre në grupe të ndryshme.

Të rinjtë fitojnë njohuri si të gjermanishtes ashtu edhe të shqipes me anë të ndërveprimeve, pra në formën e një shkëmbimi procesor të veprimeve gjuhësore nëpërmjet përdorimit të vazhdueshëm të dy gjuhëve shqip dhe gjermanisht.

U paraqitën tre hipoteza në lidhje me aspektin gjuhësor:

Hipoteza 1: Të rinjtë mendojnë shpesh në gjuhën shqipe kur komunikojnë me të rinj të tjerë shqiptarë ose me prindërit e tyre.

Hipoteza 2: Të rinjtë flasin gjermanisht shumë më shpesh kur komunikojnë me të rinj gjermane apo në shkollë.

Hipoteza 3: Të rinjtë preferojnë shumë më shpesh gjuhën gjermane kur diskutojnë tema të rëndësishme për adoleshencën e tyre.

Këto tre hipoteza u vërtetuan bazuar në përgjigjet e dhëna nga të intervistuarit.

Meqenëse të rinjtë sasinë më të madhe të kohës e kalojnë në një ambient gjermanishtfolës, ata kanë më shumë mundësi për trajnim dhe zgjerim gjuhësor në gjuhën gjermane se sa në gjuhën shqipe. Si rrjedhim ata kanë më shumë siguri në gjuhën gjermane. Gjuhën shqipe ata e përdorin më shumë jashtë shkollës, në familje dhe në komunikim me bashkëmoshatarë ose të rriturit shqiptarë.

Përsa i përket ruajtjes së identiteti kulturor gjatë intervistave u konstatua se festat, ritet dhe veprimtaritë kulturore janë tregues i rëndësishëm i ruajtjes së identitetit shqiptar. Nga shqiptarët në Gjermani festohen festa të shumta shqiptare, njihen objekte dhe veshje tradicionale si dhe rite të caktuara fetare.

BIBLIOGRAFIA

- KIELHÖFER, BERND/JONEKEIT, SYLVIE (1998): Zweisprachige Kindererziehung, 10. Auflage, Verlag Stauffenburg, Tübingen.
- LUCHTENBERG, SIGRID (1995): Interkulturelle sprachliche Bildung. Zur Bedeutung von Zwei- und Mehrsprachigkeit für Schule und Unterricht. Münster u.a.: Waxmann.
- NIEKE, WOLFGANG (1991): Situation ausländischer Kinder und Jugendlicher in der Bundesrepublik Deutschland: Vorschule, Schule, Berufsausbildung, Freizeit und Kriminalität. In: Lajios, K. (Hrsg.): Die zweite und dritte Ausländergeneration. Ihre Situation und Zukunft in der Bundesrepublik Deutschland. Opladen: Leske+Budrich.

SITOGRAFIA:

- <https://sot.com.al/opinione/migracioni-ne-gjermani-dhe-sfidat-e-femijeveshqiptar>
- <http://www.instat.gov.al/media/7848/diaspora-ne-shifra-2020.pdf>

TRASHËGIMIA ARKITEKTURORE: KULTURA E MEMORIES DHE KULTURA E IDENTITETIT: RUAJTJA DHE MBROJTJA E PEISAZHIT TË QYTETIT

Prof. Dr. ELIDA MIRAJ

Universiteti Europian i Tiranës

miraj.lida@gmail.com

ABSTRACT

The preservation and protection of the historical and urban landscape of the city, as part of the preservation and protection of the architectural and cultural heritage, is related to Memory, which in the individual image of the Seychelles is the Collective Reality. Preservation and Protection of the City Landscape, including Architectural Heritage, it is evidence of human attention towards changes in time of a certain place. However, Cultural Heritage, in general and Architectural Heritage in particular, also includes the Concept of the Spirit of the Country, without which the heritage would be dead. Both the light and the air around an architectural work are part of the materials with which it is composed. Built heritage is not only a high artistic achievement, but also the daily work of craftsmen. With the changes of time, these structures have a cultural significance. As we enjoy this heritage, we must ensure that it is preserved so that it can be passed on to our descendants.

Keywords: Cultural Heritage, Architectural Heritage, City Landscape, Spirit of the Country.

Rruajtja dhe Mbrojtja e peizazhit historik e urban të qytetit, si pjesë e Rruajtjes dhe mbrojtjes së trashëgimisë arkitekturore e kulturore, është e lidhur me Memorien, e cila në përfytyrimin individual të secilit është Realiteti Kolektiv.



Fig. 1, Mozaik me një skenë banketi, ku perëndesha Mnemosyne (personifikim i memories), ka vendosur dorën e saj mbrapa kokës së një mashkulli, gjë që në kuptimin mitologjik duket sikur në mënyrë simbolike i shton atij memorien. Antioch, Shtëpia e Mnemosynës, Shekulli i Dytë-Tretë pas Krishtit.

Etimologjikisht memoria i referohet Mnemosynës,¹ perëndeshës Titane të memories e kujtesës, shpikëses së gjuhëve e fjalëve dhe perëndeshës së kohës.

Perëndesha Mnemosynë personifikonte memorizimin, që ishte i domosdoshëm dhe përpara hyrjes së shkrimit, për të ruajtur jo vetëm pjesët e historisë, por edhe sagat e miteve të lashta.

Hesiodi, poeti dhe mendimtari i madh i antikitetit grek, në periudhën ndërmjet viteve 750 - 650 para Kr., e përshkruan Mnemosynën si personin që dinte:

‘gjithçka që kishte ndodhur, gjithçka që po ndodhte dhe gjithçka që do të ndodhte’².

¹ Mnemosyne, sipas legjendës ishte Nëna e Musave, burim nga i cili ka lindur e gjithë kultura e arti njerëzor, historia dhe burimet shkencore. Pa memorie, kujtesa do të ishte e pamundur. Mnemosyne ishte perëndesha e njohjes në kohë dhe e dijeve. Memoria është edhe burimi e baza e poezisë. Shih Martin Heidegger, *What Is Called Thinking?* (përkthyer në anglisht nga J. Glenn Gray) (New York 1976) 11. Heidegger shton që ‘kjo është arësyeja që poezia është uji që kohë pas kohe kthehet mbrapsh drejt burimit, drejt mendimit të së shkuarës.’ (Ibid.) (‘Thinking-back’ translates *An-denken*, commemorative thought.)

² Hesiod, *Theogony*, 32 & 38. Shih edhe Günther Zuntz, *Persephone* (Cambridge 1971).

Memoria është konsideruar gjithnjë si një kapacitet i qenieve njerëzore për të kujtuar ngjarje, procese dhe objekte të kohëve të shkuara, “mënyrën nga e cila gjërat kujtohen, kapacitetin e rikthimit e rijetimit të mendimeve apo ndodhive të së shkuarës, të konsideruara si të qëndrueshme në ndërgjegjen e një individi ose edhe të një grupi.”

Memoria humbet karakteristikat e saj me daljen e filozofisë platonike dhe me vëmendjen ndaj rigrumbullimit të dijeve të së shkuarës, që trashëgojnë të gjithë njerëzit. Me Aristotelin paradigma pasiviste e memories është e stabilizuar dhe kjo situatë është e dukshme pak a shumë si gjatë periudhës së Rilindjes ashtu edhe gjatë Kohëve Moderne, kur memoria ishte e lidhur me idenë e një lloji regjistrimi matematikor.

Ruajtja apo Mbrojtja e Arkitekturës është pjesë e një marrëdhënieje jetësore që ka në qeniet njerëzore me transformimin konstant të një vendi të caktuar dhe kthimin e tij në një banesë ku ata vetë mund të jetojnë.

Për pasojë performanca e Arkitekturës nuk është e fokusuar vetëm në faktin që të mendohet për të dhe që të ndërtohet, por kryesisht në atë që të jetohe brenda saj.

Ky proces historikisht është bërë në shumë mënyra: Si fillim, ai duhet të ketë qenë një aktivitet i pandërgjegjshëm, por që pas vitesh eksperience apo gabimesh si edhe në bazë të kujtesës së situatave të ndryshme jetësore, dijet rreth këtij aktiviteti filluan që të zgjerohen dhe që të ndërgjegjësohen.

‘...kurdo që ne kujtojmë dhe në cilëndo mënyrë që kujtojmë, ne marrim një të shkuar të ndryshme çdo kohë. duke kujtuar krijohet një diferencë e madhe në mënyrën se si ne i referohemi së shkuarës. Dhe ne e shohim të shkuarën si të ndryshme në çdo kohë.’³

Arkitektura, si një nga format e veçanta të artit, vendoset e para në radhët e Artit, sipas principeve bazë. Hapësirat e saj shtrihen në natyrën e jashtme inorganike, të cilat reflektohen në mendjet njerëzore, si një botë e jashtme artistike⁴.

Hegeli thotë gjithashtu se: Marrëdhënia ndërmjet formës dhe shpirtit, është baza e artit dhe më pas përcakton në mënyrë dialektike kategoritë e artit dhe tiparet e tyre të veçanta:

³ Edward S. Casey, Remembering, a phenomenological study , 2nd ed. (2000).

⁴ Georg Wilhelm Friedrich Hegel, Lectures on Aesthetics (Berlin 1820).

Arti Simbolik - një ndarje e plotë ndërmjet formës dhe shpirtit;

Arti Klasik - sjell së bashku formën edhe shpirtin;

Arti Romantik - arrin në një korrespondencë të plotë ndërmjet formës dhe shpirtit dhe, është në fakt, niveli më i lartë i arritjes artistike.

Sipas Hegelit, arkitektura është simbolike, skulptura është klasike dhe piktura, muzika e poezia janë romantike⁵.

Cesare Brandi argumenton se Arkitektura nuk është si piktura, sepse Arkitektura ka lindur nga nevoja!⁶

Ruajtja dhe Mbrojtja e Peizazhit të Qytetit, duke përfshirë Trashëgiminë Arkitekturore, është një evidence e vëmendjes njerëzore drejt ndryshimeve në kohë të një vendi të caktuar.

Si është e lidhur memoria dhe, në mënyrë të veçantë memoria kolektive, me vëmendjen për ruajtjen e mbrojtjen e saj? Si projektohen drejt të ardhmes memoriet kolektive?

Çështjet ose pyetjet kryesore të zhvillimit të kësaj konkurrence konsideratash janë:

Si është e konceptuar Arkitektura me ndryshimin e kohës, dhe më shumë, si është themeluar ruajtja e mbrojtja e trashëgimisë arkitekturore në lidhje me kohën dhe vendin e qenieve njerëzore?

Problemi filozofik i marrëdhënies së ekzistencës së shoqërisë njerëzore në lidhje me vendin dhe kohën ku kjo shoqëri jeton, është shumë më i gjerë se sa limitimi kohor që kemi në këtë prezantim. A mundet që arkitekti të reflektojë vlerat predominuese shoqërore dhe, sipas mjedisit, t'i përshtatë ato në përputhje me mënyrën se si njerëzit realisht jetojnë?

